

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

GJENDJA E ARSIMIT NË VEND – SFIDAT DHE PERSPEKTIVAT

(Tribunë shkencore – 07.03.2020, Shkup)

30



Shkup, 2020

Boton:
INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIR TËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

Vëllimi 30 – 2020
Biblioteka: **SCUPI**

Për botuesin:
Dr. Skender Asani

Kryeredaktore:
Mr. Laura Papraniku Bejtullau

Këshilli redaktues:
Dr. Sefer Tahiri
Dr. Minir Ademi
Dr. Demush Bajrami
Mr. Isamet Bakiu

Copyright©ITSHKSH, 2020
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për botuesin.

ISBN: 978–608–4897–15–6

www.itsh.edu.mk

Ky botim financohet nga:



INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

GJENDJA E ARSIMIT
NË VEND – SFIDAT
DHE PERSPEKTIVAT

(Tribunë shkencore – 07.03.2020, Shkup)

30

SCUPI
Shkup, 2020

PËRMBAJTJA:

Laura PAPANIKU BEJTULLAU: FJALA HYRËSE	7
DR. Skender ASANI: FJALË PËRSHËNDETËSE E DREJTORIT TË ITSHKSH-SË.....	9
Safet NEZIRI: FJALË PËRSHËNDETËSE E PËRFAQËSUESIT TË MASH-IT	12
DR. Ylber SELA: FJALË PËRSHËNDETËSE E DREJTORIT TË AGJENCISË PËR ZBATIMIN E GJUHËS SHQIPE	15
Nuhi DARDHISHTA: FJALË PËRSHËNDETËSE E KRYETARIT TË LIDHJES SË ARSIMTARËVE SHQIPTARË “NAIM FRASHËRI”	17
KUMTESAT	21
Xheladin MURATI: CILËSIA E ARSIMIT, SFIDË PËR NXËNËSIT DHE MËSUESIT	23
Lulzim MEHMEDI: SFIDAT E ARSIMI FILLOR NË MAQEDONINË E VERIUT DHE QASJET PËR BASHKËKOHËSIMIN E TIJ	37
Abdurauf PRUTHI: SFIDAT NË ARSIMIN SIPËROR NË RMV GJATË 30 VITEVE TË FUNDIT	60
Avzi MUSTAFA: METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES NË UNIVERSITET – NË UDHËKRYQ	69
Demush BAJRAMI: VEPRIMTARIA INSTITUCIONALE E STRUKTURAVE UNIVERSITARE, E INTEGRUAR NË STRATEGJINË E ARSIMIT TË LARTË.....	81
Ajten HAJDARI – QAMILI: SHKAQET QË E PRISHIN CILËSINË E SISTEMIT ARSIMOR	99

Avni AVDIU: ME SLOGANIN “ <i>REFORMA NË ARSIM</i> ” – PREJ UTOPISË DREJT REALITETIT TË MUNDSHËM.....	116
Tahir ZAJAZI: ZGJIDHJE ALTERNATIVE E TEJKALIMIT TË GJENDJES SË ARSIMIT NË VEND.....	129
Minir ADEMI: VLERËSIMI SI SFIDË NË PROCESIN EDUKATIVO–ARSIMOR	148
Isamet BAKIU: RËNDËSIA E ARSIMIT NË NDËRTIMIN E DEMOKRACISË NË MAQEDONINË E VERIUT – SFIDAT NGA PIKËPAMJA E MËSUESIT	158
Hasan JASHARI: E ARDHMJA E ARSIMIT TË LARTË NË KUSHTE TË GLOBALIZIMIT.....	173
Laura PAPRANIKU BEJTULLAU: VIZIONI I ELITAVE PËR ARSIMIN DHE POZITA E MËSIMDHËNËSVE NË PERIUDHA TË NDRYSHME.....	187
TRIBUNA SHKENCORE PËRMES FOTOGRAFIVE.....	207

FJALA HYRËSE



*Laura Papraniku Bejtullau,
Kryeredaktore*

Arsimimi është padyshim vlera më universale që ka prodhuar njerëzimi përgjatë gjithë historisë së tij, ndërsa roli i mësimdhënësve është dhe do të mbetet çelësi që determinon zhvillimin e një shoqërie të caktuar. Pa transmetimin e dijeve të nevojshme; pa aftësimin e të rinjve me kompetenca dhe shkathhtësitë e nevojshme për të përballuar sfidat jetësore; si dhe pa caktimin e profesioneve të së ardhmes jo vetëm që nuk mund të planifikohet përparimi i shoqërisë por rrezikojmë të shndërrohemi në turma që veprojnë me instinkte dhe në ndikim e euforisë së masave.

Fatkeqësisht, edhe sot e kësaj dite nuk mungojnë rastet e popujve dhe kombeve të pa denjë për të udhëhequr me të tashmen dhe të pa aftë për të projektuar të ardhmen. Kjo, sepse kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë probleme me krijimin e sistemet arsimore funksionale, me prodhimin e elitave si dhe me ndërtimin e institucioneve – pa angazhimin e të cilëve është e pa mundur të përcaktohen rrugët e përparimit të një shoqërie.

Në vijën logjike të këtij konstatimi edhe detyra e mësimdhënësve, më tepër se sa një profesion merr vlerën e një mision tejet fisnik. Që vlerësime të këtilla të mos ngelen vetëm epitete dhe fjalë të mëdha, që thuhën rëndomë nëpër manifestime dhe organizime të rastit, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqipëtarëve – Shkup, vendosi që diskutimin mbi gjenden e arsim në vend ta vendos në nivelet e debatit shkencor. Me drejtorin dr. Skender Asanin dhe Këshillin shkencor të ITSHKSH-së vendosëm që shënimin e 133 vjetorit të Ditës së mësuesit ta bëjmë përmes organizmit të *Tribunës shkencore “Gjendja e arsimit në vend, sfidat dhe perspektivat”*.

Ekspertët e fushës, profesorët universitar dhe njohësit e çështjeve arsimore, të cilët u angazhuan dhe bashkëpunuan për mbarëvajtjen e punimeve të kësaj tribune, janë padyshim në meritoret e këtij organizimi. Tribuna, i përmbushi të gjitha pritshmëritë tona si për nga interesimi dhe kërkëria me të cilat u ndoqën kumtesat ashtu edhe për debatin që prodhuan kumtesat në fjalë. Suksesi dhe jehona pozitive, na ka inkurajuar që organizimin e debateve shkencore për Ditën e 7 Marsit ta kthejmë në aktivitet tradicional të ITSHKSH-së dhe njëkohësisht të risim shkallën e pretendimeve organizative. Synojmë që vitin e ardhshëm, organizimin për shënimin e 7 Marsit – Ditës së arsimit shqip, ta ngjisin në nivelin e Konferencës shkencore.

Historia e zhvillimit të arsimit shqip është njëra prej kapitujve më të lavdishëm të gjithë historisë sonë kombëtare, sepse të gjitha luftërat për lirinë e shqiptarëve ishin në të njëjtën kohë edhe luftëra për gjuhën dhe shkollat shqipe. Të vetëdijshëm për përgjegjësin e madhe që bart organizimi i ngjarjeve dedikuar arsimit shqip, jemi optimist se do t’ia dalim t’i realizojmë me sukses sfidat dhe detyrat që ia kemi caktuar vetes.

FJALË PËRSHËNDETËSE E DREJTORIT TË ITSHKSH-SË, DR. SKENDER ASANI



I nderuar drejtor i AZGJ-së, z. Sela;

I nderuar përfaqësues i MASH-it, z. Neziri;

I nderuar kryetar i LASH-it, z. Dardhishta;

Shumë të respektuar profesorë, ekspertë dhe njohës të çështjeve arsimore;

Të dashur mësime të mësimdhënës, përfaqësues të mediave...

7 Marsi është padyshim njëra prej datave më të spikatura jo vetëm të arsimit por të gjithë historisë sonë mbarë kombëtare. Kjo datë shënon kurorëzimin me sukses të përpjekjeve shekullore për hapjen

e shkollave kombëtare shqiptare, që ishte dhe mbetet njërit prej idealeve më unifikuese kombëtare.

Ajo, padyshim se ka në vetvete edhe gjithë sakrificën popullore dhe angazhimin patriotik të intelektualëve tanë, të cilat kulmuan gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Elitat politike dhe kulturore të asaj kohe u bashkuan si kurrë më parë në kauzën për çlirimin nga pushtimi osman dhe për identifikimin e shqiptarëve me kombet e zhvilluara të Evropës. Bashkëveprimin dhe unifikimin e të gjitha forcave (politike, luftarake, arsimore, kulturore dhe ekonomike) e shihnin si rrugën e vetme për jetësimin e idealeve për pavarësimin politik e kulturor të shqiptarëve. Si e tillë, historia e zhvillimit të shkollave shqipe paraqet një vlerë të veçantë, ashtu sikurse ka zënë edhe një vend të posaçëm në tërësinë e vlerave të trashëgimisë sonë kulturore të cilat duhet të studiohen dhe të proklamohen me qëllim që të nxirren mësim nga e kaluara jonë e lavdishme.

Historia na mëson se të gjitha lëvizjet përparimtare kombëtare janë rezultat i bashkëveprimit të lëvizjeve politike me lëvizjet arsimore e kulturore. Shpallja e Pavarësisë në Vlorë (1912) u parapri nga dy momente madhore të karakterit arsimor e kulturor: nga unifikimi i alfabetit të gjuhës shqipe në Manastir, në vitin 1908 dhe nga hapja e shkollave të para kombëtare në Korçë, në vitin 1887. Mirëpo, të gjitha këto ngjarje, të cilat vulosën fatin e qenësisë shqiptare, janë produkt i Rilindjes sonë kombëtare e cila kishte marrë formë me organizimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, në vitin 1878, ku gjithashtu elitat politike dhe arsimore të kohës ishin bërë tok.

Në të njëjtat premisa, historia përsëritet edhe në kohërat moderne. Konkretisht, me themelimin e Universitetit të Tetovës, në vitin 1994, kemi përsëri bashkëveprimin e lëvizjeve arsimore dhe

kulturore me lëvizjet (partitë) politike të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut. Kështu ka ndodhur edhe me themelimin e Universitetit të Prishtinës (1969) kur elitat arsimore dhe politike u bënë bashkë në qëllimin për të sjellë një rilindje të re. Është shumë e rëndësishme të nënvizohen këto fakte pasi kohëve të fundit ka një shpërndarje bashkëveprimi mes elitave politike dhe atyre arsimore. Shqiptarët në përgjithësi kanë nevojë për një rilindje moderne, e cila do të nxitet nga një lëvizje të re iluministe (arsimore – kulturore) dhe që do të jetë promotor i të gjitha zhvillimeve dhe sytimeve për ti rendisin shqiptarët në mesin e kombeve të përparuara.

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve do të vazhdojë të kontribuojë në promovimin dhe sendërtimin e vlerave të mirëfillta. Shpresojmë që kjo Tribunë shkencore të cilën e organizojmë sot, për herë të parë dedikuar ditës së 7 Marsit, të mos jetë e fundit, por një ngjarje e cila do të kthehet në aktivitet tradicional të ITSHKSH-së dhe që do të jetë pjesë e përvitshme e Kalendarit tonë të punës.

Për fund, në emrin tim dhe të punësuarve në Institut më lejoni t'ju falënderoj sinqerisht për prezencën tuaj në këtë aktivitet dedikuar Ditës së 7 Marsit. Shpresoj se aktivitetet dedikuar kësaj date nuk do të na mungojnë as në të ardhmen.

Gëzuar 7 Marsin të gjithë mësimdhënësve!

FJALË PËRSHËNDETËSE E PËRFAQËSUESIT TË MASH-IT, SAFET NEZIRI



I nderuar drejtor i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve, dr. Skender Asani;

Të nderuar akademikë, punëtorë shkencë, të pranishëm tjerë

7 Marsi – Dita e Mësuesit, është një ngjarje me shumë rëndësi kulturore dhe kombëtare në të gjitha trojet e banuara me shqiptarë, duke përfshirë edhe mërgatën tonë. Është e pakontestueshme se arsimit, kultura, historia dhe gjuha janë shpirti i një kombi. Për të ruajtur arsimin, kulturën, shkencën dhe artin e kombit tonë u flijuan shumë veprimtarë.

Para vitit 1887 janë hapur dhe janë bërë përpjekje të hapen shkolla shqipe, si ajo e Kurbinit (1632) e Perdhanës (1638) e Blinishit (1639), e Janjevës (1665), Akademia e Voskopojës (1750) dhe shkolla tjera. Por, pavarësisht kësaj, në kalendarin e historisë e kulturës shqipe hapja e shkollës së vashave në Korçës – 7 Marsi I vitit 1887 është caktuar si dita e arsimit shqip. Mësonjëtorja e Korçës, kishte kuadrot e parë të mendimit patriotik shqiptarë, mësuesit Petro Nini Laurasi e Naci Nuçin apo edhe drejtorin e parë të saj Pandeli Sotiri, motrat Sevasti e Parashqevi Qiriazia.

Puna e mësuesit është një punë me vlerë, por edhe shumë e ndjeshme, sepse lidhet drejtpërdrejt me moshat e reja, me ardhmërinë e një populli të tërë. Puna e mësuesit është e shenjtë, veçanërisht kur mësuesi e ushtron profesionin e tij me nder, përkushtim dhe shumë përgjegjësi. Me kontributin e shumë gjeneratave të arsimitarëve dhe sot veteranëve të arsimit janë hapur shumë dritare të ardhmërisë dhe presim që me kontributin e mësimeve të tanishëm por edhe të atyre që do të vinë, të vazhdohet të hapen edhe shume dritare të tjera të dijes, edukatës dhe arsimit shqip.

Sot, këtu në Shkup, në këtë Institut i cili është vatra e gjuhës, kulturës dhe historisë kombëtare, po mbahet tribunë kushtuar kësaj date të rëndësishme kombëtare, për të ritheksuar dhe përkujtuar se mësuesit shqiptarë në çdo kohë dhe në çdo krahinë kanë qenë jo thjeshtë profesionist të arsimit, por në radhë të parë patriotë, njerëz të emancipuar, propagandues të shqiptarizmit, idealistë të përбетuar, humanistë dhe artistë të fushave të ndryshme. Prandaj, çdo njeri nga ne e ka në zemër figurën e mësuesit të tij të preferuar, të cilit i falet me një respekt të përjetshëm. Çdo njeri, pavarësisht se çfarë detyre ka sot (ministër, politikan, afarist apo punëtorë) ka qenë dikur nxënës, ka pas dikur përballë Mësuesin, që nuk kursente kohën,

frymën, jetën e pasionin për t'ju dhënë dije e kulturë nxënësve gjeneratë pas gjenerate.

Më lejoni të rikujtoj se në frymën e angazhimeve për ngritjen e cilësisë, si dhe të respektit për profesionin e mësimit, Ministria e Arsimit dhe Shkencës në krye me ministrin Arbër Ademi ndërmoi disa hapa të rëndësishëm si për mbështetjen dhe stimulimin materiale të tyre ashtu edhe në drejtim të definimit të rolit të arsimtarit në procesin edukativ-arsimor. Vitin që e lamë pas, u miratua Ligji për mësimit dhe bashkëpunëtor profesional, i cili përmban në vete disa komponentë. Për herë të parë u sigurohet mundësia e avancimit në karrierë, në titujt mentor dhe këshilltar si dhe mundësia e që kjo të reflektohet në të hyra më të larta. Gjithashtu, në frymën e këtyre reformave do të pasojnë trajnimet me qëllim të përsosjes së tyre profesionale. Gjatë vitit kalendarik 2018/2019 dhe fillim të vitit 2020 kemi rritje të pagave mujore, si asnjëherë më parë me më shumë se 21%. Të gjitha këto veprime janë ndërmarrë me të vetmin qëllim: vlerësimin e punës dhe angazhimin e drejtë të mësimit dhe bashkëpunëtorëve profesional.

Në fund, më lejoni që në emrin tim, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe ministrit Arbër Ademi të gjithë arsimdashësve, mësimit dhe veteranëve të arsimit, t'ua uroj 7 Marsin Ditën e Mësimit. Tribunës shkencore i dëshiroj punë të mbarë.

Suksese dhe shëndet!

FJALË PËRSHËNDETËSE E DREJTORIT TË AGJENCISË PËR ZBATIMIN E GJUHËS SHQIPE, DR. YLBER SELA



*I nderuar drejtor i ITSHKSH-së, z. Skender Asani;
të nderuar pjesëmarrës të tribunës shkencore për shënimin e 7 Marsit,
të nderuar të pranishëm*

Që në fillim dua të theksoj se shënimi i 7 Marsit – Ditës së mësuesit është një traditë e bukur e krijuar te populli ynë. Në këtë ditë të rëndësishme të arsimit shqiptar, e kujtojmë me respekt të veçantë

veprën e çmuar të mësuesve, arsindashësve dhe atdhetarëve të shquar, të cilët punuan me përkushtim dhe bënë sakrifica të mëdha për zhvillimin e arsimit kombëtar në Maqedoninë e Veriut.

Duke e marrë parasysh këtë gjë, jemi të detyruar moralisht dhe intelektualisht që të përulemi para tyre dhe t'u shprehim mirënjohje e konsiderata të larta. Ne sot jemi vazhdimësi e tyre, jemi ruajtësit dhe kultivuesit e arsimit. Kjo sigurisht që na bën krenarë të gjithëve por edhe na inkurajon që punën tonë ta vazhdojmë me vetëdije të lartë, duke edukuar brezat e rinj dhe duke nxjerrë vlera të larta arsimore e shkencore.

Nuk ka asnjë dyshim se mësuesi është shtylla e një shoqërie, prandaj në këtë ditë duhet të reflektojmë urtësi, që vëmendja jonë të përqendrohet nga më e mira e arsimit. Në kohën e degradimit të gjërave, mësuesi, shkolla dhe arsimit nuk guxojnë të cenohen asses. Vetëm në këtë mënyrë, duke ruajtur dinjitetin e tyre, secili nga pozita e tij, mund të llogarisim se kemi kontribuar pozitivisht në ngritjen dhe sendërtimin e vlerave që i trashëguam nga të parët tanë. Prandaj, le të na shërbejë kjo ditë e rëndësishme si një apel intelektual e kombëtar për ndërgjegjësim të përgjithshëm ndaj kësaj sfere të ndejshme, sepse pa shkollën dhe arsimin nuk ka pasur dhe nuk mund të ketë perspektivë.

Uroj që Dita e Mësuesit të jetë kthesë pozitive në jetën tonë shoqërore e arsimore!

FJALË PËRSHËNDETËSE E KRYETARIT TË LIDHJES SË ARSIMTARËVE SHQIPTARË “NAIM FRASHËRI”, NUHI DARDHISHTA



Në emër të Lidhjes së Arsimitarëve Shqiptarë “Naim Frashëri” përshëndes organizatorët e këtij debati mjaft të qëlluar në ITSHKSH, veçanërisht drejtorin z. Skender Asanin dhe koordinatoren e aktivitetit znj. Laura Papraniku Bajtullaun, e cila edhe para organizimit të këtij debati është shquar si gazetare që çdo herë ka trajtuar çështje të arsimit, sidomos problemet e shkollave shqipe.

Me themelimin e LASH-it, në vitin 1990/1991 në Maqedoni filloi përmirësimi i gjendjes së arsimit shqip, i cili ishte i ngulfatur nga problemet e shumta dhe ishte thuajse i mbyllur nga të ashtuquajturat paralele të kombinuara (maqedonisht– shqip) në

shkollat e mesme. Kështu, në konkursin për regjistrimin e nxënësve në shkollat e mesme për vitin shkollor 1991/1992, për 2 500 nxënës shqiptarë që atë vit kishin mbaruar arsimin fillor (klasën VIII) në shkollat e mesme lejohej formimi vetëm i katër paraleleve shqipe e, në të cilat kishte vend vetëm për regjistrimin e 136 nxënësve. Me kërkesat e një pas njëshme të LASH-it, të mbështetura edhe nga deputetët shqiptarë, vit pas viti, deri në vitin 2000 u rit dukshëm numri i paraleleve me mësim në gjuhën shqipe. Ka qenë një proces jo i lehtë, por që i bëri bashkë nëpër protesta e peticione nxënës, prindër e mësimdhënës; intelektualë; mediume e politikanë.

Me iniciativën e LASH-it, në periudhën e viteve 1991–1993 u zbardhën të gjitha informatat e diferencimit ideopolitik të punonjësve arsimor të kryera në periudhën 1981–1989, dhe në bashkëpunim me institucionet arsimore, nisëm punësimin e serishëm të gjithë atyre që shprehën interes për një gjë të tillë. Me pjesëmarrje të anëtarësisë së LASH-it, arsimdashësve dhe popullit shqiptar arritëm të hapim edhe Universitetin e Tetovës. LASH prej vitit 1991 filloi shënimin e 7 Marsit – Ditës së mësuesit, dhe pas vitit 2003 këtë festë e zyrtarizoi Parlamenti i Maqedonisë, duke e bërë pjesë të Programit Nacional për shënimin e datave të rëndësishme historike.

Me angazhimin e LASH-it, në vitet e 90-ta u hapën shumë shkolla fillore në gjuhën shqipe, sidomos në rajonin e Shkupit dhe fshatrat e Velesit. Me kërkesat dhe presionin e LASH-it, në të gjitha institucionet arsimore dhe në Ministria e Arsimit u rit punësimi i kadrove shqiptarë, të cilët u morën dhe vazhdojnë të merren për së afërmi me përmirësimin e gjendjes të arsimit në gjuhën shqipe. Pra LASH-i në bashkëveprim me subjektet politike,

kontribuoi në kompletimin e arsimit shqip në të gjitha nivelet. Duke përcjellë në vazhdimësi rritjen e numrit të nxënësve dhe studentëve – kuptohet si diçka shumë pozitive, nuk mund të mos na brengos një dukuri tjetër – ajo e rënies së cilësisë. Prandaj, mendojmë se është emergjente ndërtimi i mekanizmave të kontrollit me qëllimi të ngritjes së cilësisë, si dhe këshillimi i vazhdueshëm ndërinstitucional më qëllim të evoluimit të procesit edukativ – arsimor, në të gjitha nivelet, pa përjashtim.

Pra, sfida kryesore dhe urgjente e të gjithë subjekteve të tanguara në procesin e arsimit, veçanërisht e politik–bërësve të arsimit është ndërtimi i mekanizmave dhe platformave arsimore që shpijnë drejt ngritjes së cilësisë. Sakaq, në shembullin e shteteve me sisteme të avancuara shkollimi, Republika e Maqedonisë së Veriut duhet të ndajë buxhet më të lartë për arsimin duke e shndërruar atë në çështje me prioritet të lartë.

KUMTESAT

XHELADIN MURATI

Ekspert i çështjeve pedagogjike

CILËSIA E ARSIMIT, SFIDË PËR NXËNËSIT DHE MËSUESIT

Abstrakt

Cilësia e arsimit është problem sfidues dhe aktual i ditëve të sotme, e cila imponon nevojën e trajtimit të vazhdueshëm saj të saj. Për më tepër së kaq, cilësia në arsim nuk duhet parë thjeshtë vetëm si çështje në kuptimin e ngushtë të fjalës por si një proces të ndërlikuar dhe të ndikuar nga shumë faktorë. Prandaj, nevoja për optimizimin e cilësisë është e domosdoshme pasi që është një element krahasimi dhe përafrim me sistemet arsimore të vendeve të zhvilluara evropiane.

Që në fillim të kumtesës jepen shënime hyrëse, si dhe shtrohen çështjet rreth premisave për cilësinë e arsimit e, që marrin përgjigjet përkatëse. Gjithashtu, janë paraqitur rezultatet e hulumtimit në lidhje me rolin e arsintarëve për ndryshimet e nevojshme në arsim me qëllim të sigurimin e cilësisë, me theks të veçantë të cilësisë së arsimit që fillon nga mësonjëtoret.

Për gjatë gjithë punës në mënyrë të qartë dhe të nënkuptueshme tregohet se është e domosdoshme të sigurohet cilësia në procesin mësimor edhe atë në të gjithë sistemin, duke filluar nga klasat e shkollave fillore. Rezultatet empirike tregojnë se për cilësinë në mësimdhënie janë të rëndësishëm shumë faktorë, por katër janë më

kryesorët edhe atë: 1) Metodologjia dhe teknikat e mësimdhënies në kontekst të përfshirje së përmbajtjeve moderne (bashkëkohore) të programit mësimor; 2) Niveli i lartë i mësimi; 3) Mësuesi nuk është faktori i vetëm për arsimin cilësor dhe 4) Cilësia nuk matet vetëm nga aspekti sasior

Fjalë kyçe: cilësi, mësonjëto, mësimdhënie, mësimnxënie

Hyrje

Arsimi dhe cilësia janë dy komponentë që integrohen në mënyrë konstante në njëra-tjetrën, duke iu shmangur, por edhe duke depërtuar në të njëjtën kohë te njëra-tjetra. Në këto raporte konstante shtrohet pyetja: *Si të sigurohet cilësia në arsim?*

Cilësia e arsimi sot dhe vite më pas solli shumë sfida kontroverse. Ekziston momenti ku mundësitë janë të lidhura me cilësinë në arsim dhe, aty përplasen madje, aty fillon roli i përgjegjësisë. Parashtrohen një sërë pyetjesh: *Pse cilësia në arsim më herret ishte në nivel? Pse nuk matej cilësia? A ndikon sot teknologjia mbi cilësinë e arsimi? A bazohet cilësia e arsimi në dituri? A shikohet cilësia e arsimi vetëm në institucione të edukimit? A solli shkollimi i mesëm i obligueshëm uljen e cilësisë? A duhet sërish të mendojmë për atë rol?*

Të gjitha këto pyetje mbështeten në kërkesën të ndryshohet filozofia e arsimi në përgjithësi. Sot një cilësi e lartë dhe një arsim i arrirë është premise e rëndësishme për të qenë të suksesshëm në karrierën profesionale. Që të përgjigjemi në këto pyetje i kemi këto premisa si orientim:

1.Premisat

A. Zhvillimi i qëndrueshëm i arsimit është kusht për cilësi në arsim.

B. Efikasiteti i arsimit nuk varet nga sasia e përmbajtjeve arsimore, por nga cilësia e tyre.

C. Dituritë vlerësohen në cilësi, kohë dhe hapësirë.

Ç. Cilësia e arsimit është pyetja më e sëmurë e sistemit dhe shoqërisë në tërësi.

D. Të krijohet cilësi në mësonjëtorë është sfidë e madhe.

Këto premisa si prioritet kryesor e kanë ngritjen e cilësisë në arsim në të gjitha nivelet e tij duke filluar që nga mësonjëtorja. Së këndejmi, në trajtimin e cilësisë në arsim nisem nga supozimi se cilësia ka qenë gjithmonë dukuri, kërkesë që është kompatible me ndryshimet në shoqëri, në mënyrë reale dhe potenciale. Ndërkaq, mësuesit dhe bartësit e procesit arsimor janë të anuar nga nevoja për cilësi, por jo gjithnjë janë angazhuar për këtë qëllim. Në këtë kontekst hipoteza e punës është: “Në mënyrë implicite cilësia në arsim fillon nga mësonjëtorja, ndërsa në mënyrë eksplicite, për shumë shkaqe nuk shprehet”. Sigurisht që cilësia në arsim luan rol të rëndësishëm në prezantimin e të arriturave, por edhe në raportet që krijohen me të tjerët. Cilësia reflekton shumë më tepër nga veprimet e tjera. Cilësia determinohet nga më shumë faktor subjektiv dhe objektiv siç janë hapësinor, didaktik, punues, programor, teknologjik, psikologjik. Në fakt cilësia nuk varet vetëm dhe ekskluzivisht nga puna e mësuesit, mësimdhënësit.



2. Qasjet dhe aspektet

Cilësia është kuptim universal dhe vlen për të gjitha sferat e prodhimit. Në sferën e arsimit vlen për qëllim kulmor. Cilësia në arsim paraqet vlerë ambicioze, jo vetëm nevojë për dallueshmëri. Ajo përcaktohet përmes shpërndarjes së fuqisë së diturive dhe potencialin e tyre me ndihmën e aftësive dhe atributet pedagogjike që të vërtetohet se ekziston në praktikë. Në këtë kontekst, me cilësi në arsim kuptojmë standard të diturive që reflektojnë sukses të lartë, ndërsa koncepti kërkon investim të zgjeruar e përmirësim të vazhdueshëm të aftësive për të njohur dhe dalluar dijen.

Sipas mendimit tonë cilësia në arsim është qëllim strategjik dhe çështje komplekse. Prandaj strategjia për sigurimin e cilësisë në arsim përfshin 5 elemente strukturore:

- vizionin dhe strategjinë për cilësinë;
- elementet kryesore që e përbëjnë cilësinë;

- qëllimet themelore dhe kryesore të cilësisë;
- ambiciet dhe mundësitë për matjen objektive të cilësisë dhe
- opsione dhe alternative për sigurimin e cilësisë.

2.1. Mësuesi, mësonjëtorja dhe cilësia

Nëse shkolla është djepi i diturive dhe edukimit, atëherë mësonjëtorja është një minifabrikë ku prodhohen dituritë. Arkitekt për cilësinë e diturive është mësuesi. Nëse e marrim si të mirëqenë konstatimin se mësonjëtorja është baza ku fillon krijimi i cilësisë, duhet bërë kujdes që puna dhe aktiviteti që zhvillohet aty të kalojë nëpër pesë hapa: 1) caktimi i faktorëve për sukses në procesin arsimor; 2) hulumtimi i veprimeve dhe qasjeve; 3) mos zvarritja dhe mos anulimi i gjërave; 4) kërkimi i ndihmës dhe 5) diskutimi rreth arritjes ose jo të cilësisë së nevojshme.

Në fakt, që një mësues të mund të monitorojë punën e nxënësve në mësonjëtorë si mjedis mësimor dhe të sigurohet që ai të jetë sa më cilësor dhe më produktiv duhet ta menaxhoj mësimdhënien me shkathtësi didaktike.

2.2. Rezultatet dhe analiza

Në një hulumtimin tonë më të gjerë për rolin dhe ndikimin e arsimtarit në suksesin e nxënësve në të cilën ishin kyçur 151 arsimtarë të profileve të ndryshme, parashtrova edhe pesë pyetje për cilësinë në arsim. *Çka tregojnë rezultatet?*

Pyetja e parë (e tipit të hapur) *Si mund ta definoni cilësinë në arsim e cila krijohet në mësonjëtorë?* ishte e tipit të hapur, dhe shumica nuk janë përgjigjur ose kanë dhënë përgjigje që nuk ka peshë apo nuk janë të rëndësishme. Në vazhdim do ti shënojmë 8 mendimet më

të shpeshta që kanë dhënë anketuesit (N=151) lidhur me pyetjen në fjalë, të cilat janë: 1) Nuk është gjithnjë lehtë të flasësh për cilësinë në arsim, por kur hapesh për këtë problem, të duket se ke debatuar për një problem shumë të rëndësishëm; 2) Cilësia e arsimit në mësonjëtoje buron nga vlerësimi i drejt i të arriturave, dhe mendoj se ajo është punë e mirë; 3) Cilësinë në arsim duhet ta njohin të gjithë njerëzit dhe të gjithë të kontribuojnë për të; 4) Cilësinë në arsim e krahasoj me makinën. Nëse nuk e punon do të mbetet në gjysmë të rrugës; 5) Cilësia mund të jetë e lartë dhe mos të duket se ekziston. Dikush mund të mos e shohë cilësinë, po mendon se nuk ekziston; 6) Në mësim të gjithë arrijnë cilësi por kanë edhe mangësi. Duhet të jemi të sinqertë për cilësinë dhe të punojmë në mangësitë tona; 7) Të flasësh për cilësinë në mësim, e cila zhvillohet në mësonjëtoje është njëllë sikur të notosh. Mund të hysh ngadalë ose të zhytesh drejtpërdrejt; 8) Cilësia në arsim nuk zvogëlohet, thjeshtë ndërrohen kushtet. Nga paraqitja e mendimeve dhe qëndrimeve për cilësinë e mësimin në mësonjëtoje kam vetëm një përfundim. Në fakt, cilësia është reflektim i suksesit, mosuksesit, të arriturave në mësim, angazhimi i nxënësve dhe përkushtimi në procesin e punës mësimore që i ndodh tërë popullatës së nxënësve.

Për pyetjen e dytë: *Nga cilët faktor varet cilësia e mësimin në mësonjëtoje?* përgjigjet janë si në tabelën në vijim:

Përgjigjet e mundshme	Numri	%
1. Kushtet teknike dhe mjetet mësimore	26	17,0
2. Aftësimi i arsimtarit	34	22,5
3. Teknikat e organizimit të mësimin	40	26,9
4. Cilësia e përmbajtjeve mësimore –	30	19,8

programore		
5. Interesi dhe përkushtimi i nxënësve	21	14,0
Gjithsej	151	100,0

Të dhënat e fituara tregojnë se cilësia që krijohet në mësonjëto­re para së gjithash është e përcaktuar nga teknologjia e realizimit të mësim­it 26, 9 % mandej nga aftësia e arsimtarit 22,5 % dhe nga cilësia e përmbajtjeve mësimore–programore 19, 8 %.

Për pyetjen e tretë: *Çka paraqet për ju cilësia në arsim?* përgjigjet janë si në tabelën në vijim:

Përgjigjet e mundshme	Numri	%
1.Cilësi të larta për vlerësim	40	27,0
2.Kritere të larta për mësim	42	27,8
3.Qëndrueshmëria e diturive	35	23,2
4.Shfrytëzimi efikas i diturive	33	22,0
Gjithsej	151	100,0

Rezultatet nga tabela na çojnë në përfundim se cilësia në mësim në mësonjëto­re determinohet nga kritere të larta për mësim 27, 8%, kritere të larta për vlerësimin e nxënësve 27, % dhe nga qëndrueshmëria e diturive 23, 2%.

Për pyetjen e katër: *A mundet mësuesi, arsimtari të konsiderohet për arkitekt të cilësisë së diturive?* përgjigjet janë si në tabelën në vijim:

Përgjigjet e mundshme	Numri	%
1.Arsimtari është faktor i vetëm për cilësi	34	28,5
2.Cilësia nuk varet vetëm nga arsimtari	28	18,5
3.Në masë të madhe cilësia varet nga arsimtari	22	14,6
4.Varet nga arsimtari por në masë më të vogël	29	19,2
5.Arsimtari nuk është faktor i rëndësishëm për cilësinë	38	27,2
Gjithsej	151	100.0

A është arsimtari arkitekt i suksesit dhe cilësisë së mësimi, është pyetje që ka mendime të ndara tek vet arsimtarët. Në fakt sipas disave vërtetohet se arsimtari është faktor i vetëm i cilësisë 28, 8 %, dhe njëherësh pjesa tjetër e të anketuarave mendojnë se arsimtari nuk është i vetmi faktor 27, 0 %, që do të thotë se ekzistojnë edhe shumë faktor të tjerë të cilët këtu nuk janë përfshi.

Për pyetjen e pestë: *A mund të matet cilësia objektivisht dhe realisht? përgjigjet janë si në tabelën në vijim:*

Përgjigjet e mundshme	Numri	%
1.Mundet, vetëm sasia	52	34,5
2.Cilësia më vështirë matet	48	31,8
3.Qëndrueshmëria e diturive	23	15,2

4.Nuk ka instrumente precize për matje	28	18,5
Gjithsej	151	100.0

Matja e cilësisë në arsim është një problem serioz, posaçërisht objektiviteti i cilësisë. Të dhënat tregojnë se matet vetëm ana sasiore 34, 5 %, se cilësia vështirë matet 31, 8 % dhe se kjo është rezultat i mungesës së instrumenteve precize 18, 5 %.

Në çka na orientojnë indikatorët nga studimi ynë? Analiza tregon në kompleks të faktorëve nga të cilat varet cilësia në arsim në tërësi dhe veçanërisht cilësia që krijohet në mësonjëtove. Sipas përqindjes së përgjigjeve, cilësia varet nga katër faktor, dhe atë: teknologjia e realizimit të mësimit, artikulumit didaktik–metodikë i orës mësimore dhe përmbajtjet bashkëkohore mësimore–programore; Kriteret e larta të mësimit, që është rezultat i konkurrencës mes nxënësve; Arsimtari nuk është i vetmi faktor për cilësinë, por ekzistojnë edhe të tjerë, të cilët reflektojnë në suksesin, përparimin dhe cilësinë e arsimit dhe se Cilësia mat vetëm aspektin sasior me instrumente jo precize.

Prandaj, koha parashtron nevojën të debatohet për cilësinë në arsim si dukuri e përditshme, të bëhet një dallim i vërtetë mes idealeve dhe realeve. Edhe pse cilësia tregon tendencë të rritjes dhe duhet të rritet, ne nuk duhet ti ngatërrojmë dëshirat me analizat. Duhet të flasim për rrugën e gjatë të suksesit dhe të cilësisë.

2.2. Elementet dhe shtyllat e cilësisë

Cilësia në arsim fillon në mësonjëtove dhe lëvizë sipas vijës përpjetë në tërë procesin arsimor. Për arsim cilësor janë të nevojshme:

mësonjëtoresh të mira, mësues solid dhe metodologji e rregulluar e punës mësimore. Bashkë me këto tre elemente që përbëjnë shtyllën e cilësisë, konceptet themelore të mësimi cilësor përfshijnë: këmbimin e ideve dhe zgjedhjen e tyre; menaxhimin individual dhe grupor të procesit arsimor; parashtrimin e përbashkët të qëllimeve; kooperimin mes nxënësve; përgjegjësinë kolektive; dëshira për të arritur sukses dhe të mësuar cilësor dhe participimi individual. Këto janë elementet ose atributet bazë për arsim dhe të mësuar cilësor.



Nëse në mësonjëtoresh punohet në mënyrë produktive, të angazhuar, me përkushtim të tërësishëm atëherë cilësia në procesin arsimor dhe në të mësuar është prioritet kulmor. Mësimi i suksesshëm i udhëhequr nga mësuesi paraqet faktor themelor për cilësi dhe njëkohësisht faktor motivues për nxënësit. Cilësia e të mësuarit në mësonjëtoresh kërkon mësim efektiv, menaxhim efikas të potencialeve individuale dhe të kapacitetit punues të nxënësve.

2.3. Cilësia fillon në mësonjëto

Cilësia në procesin arsimor mbështetet në efikasitetin e dinamikës grupore dhe mësimit të individualizuar. Gjithashtu cilësia e të mësuarit bazohet edhe në aspektet kognitive dhe afektive të sjelljes së nxënësve në procesin arsimor. Në themel të mësuarit cilësor dhe arsimit veçohen me:

- të mësuarit cilësor në grupe;
- përmirësimi i shkathtësive të punës;
- zhvillimi i shkathtësive komunikuese;
- rritja e aftësive kognitive.

Roli i mësuesit në mësonjëto reflekton në më shumë aspekte: 1) Stimulon dhe e përforcon vetëbesimin te nxënësit; 2) Mosplotësimi dhe progresi i zvogëluar në mësim dhe të mësuar është shenjë se cilësia nuk ekziston; 3) Sinjali se ekziston cilësi në të mësuar dhe në procesin arsimor është: 4) më shpejt mësohet; 5) ajo që është mësuar mbahet mend më gjatë; 6) zgjidhen idetë, konceptet, kuptimet, informacionet. Sakaq, mësimi jociësor ose mungesa e cilësisë në procesin arsimor duket dhe i dedikohet: përcaktimit të qëllimeve jo kompaktibile; të mësuarit çrregullohet nga faktor të ndryshëm; qëllimet e qarta mësimore janë inekzistente dhe të papërcaktuar; qëllimet mësimore janë vendosur në mënyrë preambicioze, si dhe ndryshohen shpesh qëllimet. Prandaj:

- duhet të kuptohen edhe nxënësit dhe arsimtarët se dimensionin cilësor i arsimit është proces immanent, dhe nga ajo varet plotësimi i qëllimeve dhe detyrave në përputhshmëri me standardet e parashtruara për cilësinë, si dhe

– duhet të ndërtohen strategji më të mira për sigurimin e cilësisë në procesin arsimor. Në fakt, agjenda për arritjen e cilësisë nisët nga qëllimi strategjik i vënies së punës mësimore në mëso–njëtore.

Me këtë rast duhet të kihën parasysh: rezultatet dalëse (output) dhe procedurale; përgjegjësitë e veçanta; radhitja e parashtrimit të detyrave dhe repertori i shkathtësive;

Opinionit shkencor dhe profesional dhe bartësit e procesit arsimor si kreator të arsimit bashkëkohor janë një nga supozimet kryesore dhe të rëndësishme për krijimin e cilësisë së qëndrueshme në institucionet arsimore dhe në sistem.

3. Përfundim

Së pari, përpos konsensusit të gjerë të nevojës për cilësi në arsim, thellësia e saj dhe diapazoni dukshëm dallohen edhe sipas vendeve dhe sipas regjioneve. Madje ka dallime edhe në identifikimin e bazave të cilësisë.

Së dyti, qëllimi prioritar i arsimit tonë është sigurimi i cilësisë, qëndrueshmëria e saj dhe mos të harrojmë të mësojmë për të ditur, ta përkrahim cilësinë e cila sot dominon në botë.

Së treti, cilësia në arsim duhet të paraqes prioritet reformues në arsim, ndërsa cilësia e cila fillon nga mësonjëtorja kërkon përkushtim, me atë nuk bëhet negociata dhe ajo kërkon një rol më përgjegjës të arsimtarëve.

Së katërti, të gjitha institucionet dhe individët të cilët janë në mbrojtje të cilësisë në arsim duhet të jenë më rigoroz ndaj cilësisë, dhe të krijojnë strategji të reja dhe qasje për të kontribuar në

mënyrë objektive në vlerësimin e cilësisë së arritur. Prandaj duhen instrumente të sakta, precize për ta matur peshën e cilësisë.

Së pesti, dituritë vlerësohen në cilësi, kohë dhe hapësirë. Së këndejmi paraqiten edhe diferenca të rëndësishme në objektivitet dhe qëndrueshmëri.

Së gjashti, të ndërtohet koalicion global për sigurimin e cilësisë jo vetëm mes shkollave, por edhe institucioneve, shoqërisë dhe mësuesve, të cilët e kuptojnë sfidën e cilësisë në arsim si çështje strategjike.

LITERATURA:

Glasser W. Kvalitetna škola, Educa, Zagreb, 1997

Gocevski T. Nastavnikot i kvalitetot na obrazovaniето, vo zbornikot “Nastavnikot i kvalitetot vo obrazovaniето”, Shkup, 2007, f. 21–31

Ilievski A. Kvalitet vo obrazovaniето – kvalitetno učilishte, vo zbornikot “Nastavnikot i kvalitetot vo obrazovaniето”, Shkup, 2007, f. 126–131

Kvalitet u odgoju i obrazovanju, pedagogshki fakultet, Rijeka, 1998

Murati Xh. Ndryshimi i arsimtarit dhe ndryshimet në shkollë, Cabej, Tetovë, 2005

Murati Xh. Sproveduvanje na promeni vo učilishteto kako uslov za kvalitetna nastava, vo zbornikot “Nastavnikot i kvalitetot na obrazovaniето”, Shkup, 2007, f. 52–59

Murati Xh. Obezbeduvanje kvalitet vo obrazovaniето, pristap-celi-çekori, Cabej, Tetovë, 2011

Murati Xh. Cilësia e arsimit, sfidat dhe mundësitë, gazeta “Koha”, 10 dhjetor 2018

Nastavnikot i kualitetot na obrazovaniето, Përmbledhje punimesh, Shkup, 2007

Programi nacional për zzhvillimin e arsimit në Republikën e Maqedonisë 2005–2015, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Shkup, 2006

Stoll L. – Funk D. Mijenjamo nashe shkole – kako unaprediti delotvornost i kvalitet shkola, Educa, Zagreb, 2000

LULZIM MEHMEDI

Universiteti i Tetovës

SFIDAT E ARSIMI FILLOR NË MAQEDONINË E VERIUT DHE QASJET PËR BASHKËKOHËSIMIN E TIJ

Abstrakt

Organizimi i procesit të mësimdhënies, vazhdimisht ka qenë një nga problemet kryesore që është trajtuar në teorinë dhe në praktikën didaktike, problem ky i cili vazhdon të jetë aktual edhe në ditët e sotme. Qëllimi i këtij punimi është të trajtojmë sfidat e arsimit fillor në RMV, në veçanti të arsimit në gjuhën shqipe, si dhe qasjeve për bashkëkohësin e tij. Nëse kthehemi në retrospektivë, do të vërejmë se në këtë periudhë 30 vjeçare, prej pavarësimit të RMV-së e këndeje, ashtu si shteti në përgjithësi edhe arsimit gjendet në periudhë të tranzicionit dhe në kërkim të ndryshimeve apo reformave adekuate të cilat do të sjellin bashkëkohësimin e tij.

Punimi në fjalë përqendrohet në hulumtimin e realizuar on-line në *Google Drive*, përmes pyetësorit anketues, me arsimtarë të shkollave fillore të cilët realizojnë mësim në gjuhën shqipe. Në të janë përfshi 210 mësimdhënës të mësimit klasor dhe lëndor, të cilët përmes përgjigjeve të dhëna, detektojnë sfidat reale nëpër të cilat ka kaluar dhe po kalon arsimit fillor në gjuhën shqipe në RMV. Pjesa e fundit, jo më pak e vlefshme e këtij punimi i është dedikuar

rekomandimeve që dalin nga rezultatet e hulumtimit dhe kanë të bëjnë me tejkalimin e sfidave, me qëllim të bashkëkohësimit të procesit mësimor, reformimit dhe transformimit i të cilit domosdoshmërisht duhet të vazhdojë.

Fjalët kyçe: arsini fillor, reformimi, sfidat e arsimit fillor, bashkëkohësimi i arsimit fillor, strategji, qëllime arsimore

Hyrje

Arsimi fillor në Republikën e Maqedonisë së Veriut (RMV) dhe arsimi shqip në veçanti, në periudhë nga viti 1990 e këndej, është akoma në kërkim të rrugës së cilësisë. Në këtë drejtim janë realizuar reforma të shumta duke futur risi me qëllim bashkëkohësimin e tij, por edhe pse ka lëvizje dhe të arritura në këtë drejtim, sërish gjatë matjes së rezultateve me teste ndërkombëtare, rezulton se jemi shumë poshtë dhe nuk kemi arritur të shënojmë ndonjë lëvizje të madhe progresive. Me qëllim të evidentimit të sfidave dhe qasjeve për bashkëkohësimin e arsimit fillor në gjuhën shqipe në RMV, kam realizuar një hulumtim në të cilin janë përfshirë arsimtarët e të gjitha shkollave fillore urbane dhe rurale, që nga Likova e Kumanova deri në Strugë e Ohër.




Anketa

Hulumtimi është realizuar përmes pyetësorit anketues, i cili është shpërndarë te arsimtarët *on-line* përmes *google drive*. Pyetësorit, i janë përgjigjur gjithsej 210 mësimdhënës të mësimit klasor dhe lëndor dhe, sipas tyre si sfida të arsimit fillor shqip paraqiten:


- 1) Përdorimi i TIK-ut në mësimdhënie;
- 2) Kushtet hapësinore jo adekuate, mungesat e mësimit kabinetik, laboratorëve, teknologjisë bashkëkohore dhe sallave sportive;
- 3) Planprogrami i pa përshtatshëm me mbingarkesë të nxënësve, tekstet shkollore jo adekuate dhe të pa përkthyer, apo të përkthyer fjalëpërfjalshëm dhe mungesa e teksteve shkollore;
- 4) Dominimi i teorisë – niveli i ulët i të menduarit kritik të nxënësit dhe mësimi i dijeve që nuk janë në përputhje me kërkesat e tregut të punës;
- 5) Politizimi i arsimit, nepotizmi dhe korrupsioni sigurimin e vendeve të punës;
- 6) Mësimdhënës jo kreativ, pa risi në procesin e mësimdhënies dhe të mbingarkuar në aspektin administrativ;
- 7) Rënia e numrit të nxënësve;
- 8) Mosrealizimi i duhur i procesit të inkluzionit dhe mungesa e edukatorëve special;
- 9) Mungesa e këshilltarëve pedagogjik;
- 10) Inspektorë shtetëror të arsimit të politizuar;
- 11) Nivel i ulët i bashkëpunimit në relacionin mësimdhënës – prindër;
- 12) Mungesa e mjeteve financiare.

Lidhur me sfidat e lartpërmendura, gjatë analizimit të anketës janë fituar rezultatet vijuese:




Diagrami 1. Realizimi i mësimit bashkëkohor sipas mësimeve

Në pyetjen në shkollën tonë realizohet mësim bashkëkohor, 63.3% e mësimeve janë përgjigjur se pjesërisht është ashtu, 18.8% se aspak nuk është ashtu, ndërsa vetëm 17.9% e mësimeve kanë pohuar se plotësisht është ashtu. Kjo nënkupton se shkollat tona akoma nuk janë transformuar dhe nuk mund të themi se në to realizohet plotësisht mësim bashkëkohor. Fatkeqësisht dominojnë edhe më tej elementet e mësimit tradicional të cilët shkollën nuk e vënë në funksion të përgatitjes së nxënësve për t'u aftësuar që të jenë në hap me zhvillimin e hovshëm teknik-shkencor dhe konkurrencën e tregut të punës.




Diagrami 2. Mendimet e mësimdhënësve mbi realizimin e formës së punës në grupe

Në pyetjen vijuese, sipas meje, forma e punës në grupe dhe individualizimi në mësim, më tepër vijnë në shprehje në mësimin klasor, apo mësimin lëndor, 67.1% e mësimdhënësve pohojnë se forma e punës në grupe vjen në shprehje në mësimin klasor, ndërsa vetëm 26.6% pohojnë se vjen në shprehje në mësimin lëndor, që nënkupton se problemi i rënies së cilësisë dhe rezultateve të nxënësve në mësim, fillon të paraqitet me kalimin e tyre në mësimin lëndor.



Diagrami 3. Mendimet e mësimdhënësve Lidhur me dallimin e kushteve në venbanimet urbane dhe rurale


Në pyetjen rreth *dallimit të kushteve midis shkollave që punojnë në vendbanimet urbane dhe atyre që punojnë në vendbanimet rurale*, 53.1% e mësimdhënësve pohojnë se pjesërisht dallojnë, 40.1% se plotësisht dallojnë dhe 6.8% se nuk dallojnë, që nënkupton se nuk kemi kushte të barabarta për mësim në vendbanimet urbane dhe rurale.



Diagrami 4. Mendimet e mësimdhënësve rreth financave dhe kushteve infrastrukturore që ofron procesi i decentralizimit në arsim


Lidhur me *procesin e decentralizimit në arsim se a ka mundësiuar i njëjti më tepër financa dhe përmirësim të kushteve infrastrukturore në shkollat ku punojnë mësimdhënësit*, 55.1% pohojnë se pjesërisht është ashtu, 31.4% pohojnë se aspak nuk është ashtu dhe vetëm 13.5% pohojnë se plotësisht është ashtu. Edhe pse u mendua se decentralizimi i shkollave do të mundësojë më tepër financa për shkollat, si dhe përmirësim të kushteve infrastrukturore, prapë se prapë metodologjia e shpërndarjes së mjeteve financiare me anë të bllok dotacioneve që përfshijnë edhe rrogat e të punësuarve, edhe mjetet për mirëmbajtje të shkollës, bazuar në kritere siç janë: numri i nxënësve; numri i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore; sipërfaqja e territorit të komunës në raport me numrin e nxënësve dhe dendësinë e popullsisë që jeton në vendbanim ku graviton një

shkollë e caktuar, dëshmuar të kundërtën. Shumica e shkollave sot përballen me mungesë të mjeteve financiare, një pjesë e tyre janë edhe me xhiro-llogari të bllokuara. Në të ardhmen do duhet të ndryshohet metodologjia e shpërndarjes së bllok dotacioneve nga ana e MASH-it dhe shkollat duhet të marrin më tepër financa.




Diagrami 5. Mendimet e mësimitdhënësve rreth depolitizimit në arsim gjatë përzgjedhjes së drejtorëve të shkollave

Lidhur me mundësitë që ofroi procesi i decentralizimit për depolitizimin e përzgjedhjes së drejtorëve të shkollave, 52.2% e mësimitdhënësve pohojnë se pjesërisht është ashtu, 34.3% se aspak nuk është ashtu dhe 13.5% se plotësisht është ashtu. Edhe pse qëllimi në këtë drejtim ishte që përzgjedhja e drejtorit të shkollës të bëhet nga vetë organi drejtues i shkollës, pra Këshilli i shkollës, decentralizimi në këtë drejtim sërish nuk e depolitizoi përzgjedhjen e drejtorëve, përkundrazi, përkatësia partiake e kryetarit të komunës, ndikon dukshëm në përzgjedhjen e drejtorit të shkollës.




Diagrami 6. Mendimet e mësimitdhënësve rreth depolitizimit në arsim gjatë përzgjedhjes së mësimitdhënësve

Sa i përket depolitizimit në përzgjedhjen e mësimitdhënësve të shkollave, 49.3% e mësimitdhënësve kanë pohuar se pjesërisht është ashtu, 37.7% se aspak nuk është ashtu dhe 13% se plotësisht është ashtu. Njëjtë si situata me përzgjedhjen e drejtorëve të shkollave, është edhe në pjesën e përzgjedhjes së mësimitdhënësve, nën ndikim të drejtpërdrejtë të kryetarëve të komunave. Mekanizmi i sjellë nga MASH-i që për kriter në punësim të mësimitdhënësve të merret nota mesatare e studimeve deridiplomike, është një hap drejt vendosjes së kriterëve në këtë drejtim, të cilat në të ardhmen do duhet të shtohen, me qëllim që të mundësojnë përzgjedhje të mësimitdhënësve që përgjatë studimeve deridiplomike kanë krijuar vlera të mirëfillta. Pa ndryshim të kësaj situatë, nuk mund të kërkojmë arsim cilësor dhe rezultate që do pozicionojnë vendin në rang më të lartë ndërkombëtar sa i përket të arriturave të nxënësve.




Diagrami 7. Mendimet e mësimdhënësve rreth përfitimit të shkollave nga depolitizimi i arsimit

Në pyetjen se *çka mundësoi procesi i decentralizimit*, 52.2% e arsimtarëve janë përgjigjur se ka mundësuar politizim më të madh në arsimin fillor, 25.1% se ka mundësuar përmirësim më të madh të kushteve infrastrukturore të shkollave, 15% se ka mundësuar rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe vetëm 7.7% se ka mundësuar depolitizim të arsimit fillor. Rezultatet e fituara shkojnë në drejtim të përforcimit të konstatimeve të mësimdhënësve të bëra më lart sa i përket procesit të decentralizimit dhe politizimit të madh në arsimin fillor.



Diagrami 8. Mendimet e mësimdhënësve rreth kujdesit të shkollës për zhvillim profesional të mësimdhënësve


Sa i përket *zhvillimit profesional të mësimit në shkollat ku punojnë*, 53.1% kanë pohuar se shkolla pjesërisht i kushton vëmendje zhvillimit profesional të mësimit, 26.1% pohojnë se plotësisht është ashtu, ndërsa 20.8% pohojnë se aspak nuk është ashtu. Edhe pse zhvillimi profesional është i një rëndësie të veçantë për realizimin e mësimit bashkëkohor dhe për të qenë në hap me të gjitha ndryshimet në arsim, shkollat tona nevojitet t'i qasen me seriozitet më të madh kësaj fushe. Kjo nënkupton që shkolla duhet të detektojë nevojat reale të mësimit për zhvillim profesional, bazuar në instrumente të ndryshme, vëzhgime të plan-programeve dhe orëve mësimore, si dhe të planifikojë mjete financiare, apo të gjejë donator për trajnime të mësimit apo sigurim të literaturës profesionale.



Diagrami 9. Mendimet e mësimit rreth funksionimit të aktiveve profesionale dhe bashkëpunimit të mësimit në shkollë


Rreth *funksionimit të aktiveve profesionale dhe bashkëpunimit të mësimit në shkollë*, 50.2% pohojnë se pjesërisht është ashtu, 37.7% se plotësisht është ashtu, ndërsa 12.1% se aspak nuk është ashtu. Rezultatet e fituara flasin se në shkollat fillore nuk kemi funksionalitet të plotë të aktiveve profesionale, të cilat janë

gjeneratorët kryesorë për zhvillim profesional të mësimeve. Funkcionimi i tyre i rregullt nënkupton ndihmë të ndërsjellë, si dhe këmbim të përvojave pozitive midis mësimeve, qoftë në kuadër të planifikimeve, përgatitjes së materialeve didaktike, testeve të ndryshme, orëve të hapura mësimore, trajnimeve ose punësive në kuadër të aktivitetit profesional.




Diagrami 10. Mendimet e mësimeve rreth procesit të inkluzionit në shkollë

Lidhur me realizimin e procesit të inkluzivitetit në shkollë, 66.2% e mësimeve pohojnë se inkluzioni në shkollë realizohet pjesërisht, 18.8% pohojnë se realizohet plotësisht dhe 15% e mësimeve pohojnë se nuk realizohet aspak. Të dhënat e fituara flasin se në shkollat fillore akoma kemi një inkluzion të pjesshëm dhe se akoma duhet të punohet në këtë drejtim. Shkollat nëse deri më tani nuk e kanë formuar ekipin inkluziv shkollor (EISH), sa më parë duhet të formojnë atë, për të ndihmuar procesin e inkluzionit.



Diagrami 11. Mendimet e mësimitdhënësve se a posedojnë shkollat edukatorë special


Lidhur me *punësimet e edukatorëve special në shkolla*, të cilët do të ndihmonin procesin e inkluzionit dhe do të trajtonin në mënyrë profesionale nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në shkolla, pjesa më e madhe e mësimitdhënësve, gjegjësisht 56.5% pohojnë se shkollat nuk kanë të punësuar edukatorë special, 23.7% pohojnë se vetëm në disa shkolla ka të punësuar, ndërsa vetëm 19.8% e shkollave pohojnë se kanë të punësuar edukatorë special. Kjo nënkupton se nëse duam ta ndihmojmë realizimin e procesit të inkluzionit në shkolla duhet të punësohen edukatorë special.



Diagrami 12. Mendimet e mësimitdhënësve rreth organizimit të trajnimeve për zhvillim profesional nga BZHA

Në pyetjen për *organizimin të trajnimeve për zhvillim profesional nga ana e Byrosë për Zhvillimin e Arsimit (BZHA)* 59.4% e mësimitdhënësve pohojnë se pjesërisht është ashtu, 34.3% se aspak nuk është ashtu, ndërsa vetëm 6.3% se plotësisht është ashtu, që nënkupton se për nevojat e mësimitdhënësve nuk ka trajnime të mjaftueshme për zhvillim profesional me qëllim të aftësisht të tyre për realizim të mësimit bashkëkohor.


Kohëve të fundit shkollat bëjnë edhe lëshime me delegimin e mësimitdhënësve si trajnues, pra të cilët dërgohen ta ndjekin trajnimin që më pas të bëjnë diseminimin në shkollë. Për trajnues dërgohen zakonisht mësimitdhënës që janë të afërt me drejtorin, por të cilët nuk janë të aftë ose refuzojnë të realizojnë diseminimin e trajnimeve apo punëtorisë në nivel të shkollës.



Diagrami 13. Mendimet e mësimitdhënësve rreth vizitave nga ana e Këshilltarëve pedagogjik në orët mësimore


Lidhur me vizitat nga ana e Këshilltarëve pedagogjik në orët mësimore dhe ofrimin e këshillimit dhe ndihmës profesionale, 47.3% e mësimitdhënësve pohojnë se pjesërisht është ashtu, 30.9% se aspak nuk është ashtu dhe 21.7% se plotësisht është ashtu, që nënkupton se mësimitdhënësit nuk e marrin ndihmën e duhur

këshillëdhënëse si dhe instruksionet lidhur me realizimin e procesit të mësimdhënies nga ana e këshilltarëve pedagogjik.




Diagrami 14. Mendimet e mësimdhënëseve rreth vlerësimit objektiv të ISHA gjatë evaluimit integral

Në pyetjen se sa *vlerësojnë objektivisht inspektorët shtetëror të arsimit (ISHA) gjatë evaluimit integral*, 53.6% e mësimdhënëseve pohojnë se pjesërisht janë objektiv, 18.8% se aspak nuk janë objektiv, ndërsa 27.5% se plotësisht janë objektiv. Rezultatet e fituara na vënë në dijeni se mësimdhënësit e shkollave nuk besojnë plotësisht në objektivitetin e vlerësimit të inspektorëve shtetëror të arsimit gjatë realizimit të evaluimit integral në shkolla.




Diagrami 15. Mendimet e mësimitdhënësve rreth definimit të standardeve të vlerësimit nga ana e shkollave

Lidhur me *definimin e standardeve të vlerësimit nga ana e shkollave ku punojnë*, 56.5% e mësimitdhënësve pohojnë se pjesërisht janë të definuar, 13% se aspak nuk janë të definuar dhe 30.4% se plotësisht janë të definuar. Kur jemi të standardet e vlerësimit, të theksojmë se në kuadër të Projektit për arsim fillor (PEP) të mbështetur financiarisht nga USAID-i dhe të realizuar nga Qendra Maqedonase për Arsimin Qytetar në RMV në partneritet me MASH, nga grup punues i përbërë prej profesorëve universitarë, këshilltarëve nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit, inspektor i arsimit, drejtorë të shkollave fillore, psikolog i shkollës dhe një arsimtari i shkollës fillore u hartuan standardet e vlerësimit të nxënësve në shkollat fillore. Duke i pasur parasysh standardet në fjalë, shkollat duhet t'i vënë në zbatim dhe me këtë të kontribuojnë në ngritjen e cilësisë së vlerësimit të nxënësve në shkollat fillore në RMV.




Diagrami 16. Mendimet e mësimitdhënësve rreth përdorimit të TIK–ut në mësimitdhënie

Lidhur me *përdorimin e TIK–ut në mësimitdhënie*, 63.8% e mësimitdhënësve pohojnë se pjesërisht e përdorin, 11.6% se aspak nuk e përdorin dhe 24.6% se plotësisht e përdorin. Zhvillimi i hovshëm tekniko–shkencor i jep një dimension të ri zhvillimit të shoqërisë, dimensionin e krijimit të shoqërisë kompetitive. Për të qenë në hap me nevojat e tregut të punës, është më se e nevojshme të bëhet vendosja e kriterëve për përdorimin e teknologjisë informative në mësimit. Shkollat duhet të formojnë ekip shkollor për përkrahje të TIK–ut dhe mësimit në distancë. Interneti ka filluar riorganizimin e arsimit, arsimit nuk do të jetë i njëjtë në dekadën e ardhshme, që nënkupton se klasa tradicionale do të transformohet. Përdorimi i TIK–ut ofron mundësi për të rritur standardet arsimore në shkolla, sepse mësimitdhënia pa përdorimin e teknologjive informative të komunikimit nuk perceptohet më në botën e sotme. Përshpejtimin e këtij synimi duhet ta kenë prioritet institucionet e shtetit, duke implementuar Strategjinë e Arsimit në RMV 2018–2022, duke i përkrahur dhe mbështetur mësimitdhënësit në ngritjen e kapaciteteve të tyre në zhvillimin e shkathtësive për përdorimin e teknologjive të reja në funksion të mësimitdhënies e nxënies moderne.




Diagrami 17. Mendimet e mësimitdhënësve rreth furnizimit të shkollës me mjete mësimore dhe pajisje të TIK–ut

Sa i përket *furnizimit të shkollës me mjete mësimore dhe pajisje të TIK–ut* 58.5% e mësimitdhënësve pohojnë se shkollat pjesërisht janë të furnizuara, 26.1% pohojnë se aspak nuk janë të furnizuara dhe 15.5% se plotësisht janë të furnizuara. Përgjigjet e marra na japin informacione se shkollat kanë mungesë të mjeteve mësimore dhe pajisjeve të TIK–ut dhe se është domosdoshmëri e kohës që ata të furnizohen me infrastrukture të nevojshme teknologjike.



Diagrami 18. Mendimet e mësimitdhënësve rreth punës me nxënësit e talentuar


Lidhur me *punën me nxënësit e talentuar* 58.% e mësimitdhënësve pohojnë se pjesërisht i kushtojnë rëndësi punës me nxënës të talentuar, 17.9% se aspak nuk punojnë dhe 24.2% se rregullisht punojnë. Pohimet e marra na shpjen te informata se shkollat duhet t'i kushtojnë kujdes të veçantë punës me nxënës të talentuar, për arsye se programi mësimor i përgjigjet nivelit intelektual të nxënësit me inteligjence mesatare. Kjo imponon nevojën për realizim të orëve mësimore për punë me nxënësit e talentuar konform orëve të parapara në planin mësimor.



Diagrami 19. Mendimet e mësimitdhënësve rreth funksionalitetit të teksteve mësimore


Sa i përket *funksionalitetit të teksteve mësimore dhe mundësimin të tyre për realizim të plotë të qëllimeve programore në kuadër të lëndës të cilën e realizojnë*, 67.1% e mësimitdhënësve pohojnë se pjesërisht janë funksional dhe mundësojnë realizim të plotë të qëllimeve programore, 17.4% se aspak nuk janë funksional dhe 15.5% se plotësisht janë funksional. Rezultatet e fituara flasin se MASH-i duhet të mendojë për revidimin e teksteve mësimore me

qëllim të funksionalitetit të tyre në drejtim të arritjes më të lehtë të qëllimeve programore.




Diagrami 20. Mendimet e mësimeve se a duhet të punohet në klasë të dytë me abetaren mbarëkombëtare

Lidhur me atë se *a duhet të punohet në klasë të dytë me abetaren mbarëkombëtare*, 90.8% e mësimeve pohojnë se duhet të punohet dhe vetëm 9.2% se nuk duhet. Këto përgjigje parashtrojnë edhe pyetjen se sa është e nevojshme të mendohet që edhe te ne të fillohet të punohet me abetaren mbarëkombëtare, e cila tani është në përdorim në Shqipëri, Kosovë dhe Luginën e Preshevës. Për këtë arsye është e nevojshme që MASH-i të iniciojë formimin e grupit të ekspertëve të cilët do të hulumtonin terrenin e zbatimit të abetares mbarëkombëtare në vend, të hulumtohet zbatimi i abetares mbarëkombëtare në Kosovë dhe Luginë të Preshevës, që më pas nëse rezultatet janë pozitive, të silltet vendim që edhe te ne të përdoret abetarja mbarëkombëtare.




Diagrami 21. Mendimet e mësimitdhënësve rreth rënies së numrit të nxënësve në shkolla

Sa i përket *rënies së numrit të nxënësve nga viti në vit në shkolla*, 59.4% pohojnë se plotësisht është e vërtetë që numri është në rënie, 29.5% pohojnë se numri është pjesërisht në rënie, pra në disa shkolla dhe 11.1% se aspak nuk është në rënie. Marrë në përgjithësi mendimet e shumicës së mësimitdhënësve konstatojmë se numri i nxënësve në shkollat fillore në RMV është në rënie, që do të paraqesë ngarkesë shtesë për shkollat për një numër të mësimitdhënësve të cilëve u rrezikohet vendi i punës, si dhe kuadrin e diplomuar të mësimitdhënësve që presin për punë, sidomos në mësimin klasor që janë në një numër më të madh.



Diagrami 22. Mendimet e mësimitdhënësve rreth nivelit të bashkëpunimit me prindërit

Sa i përket *bashkëpunimit me prindërit dhe Këshillin e Prindërve*, 53.6% e mësimdhënësve pohojnë se ai është i përsëritshëm, 32.4% se plotësisht kanë bashkëpunim, ndërsa 14% pohojnë se aspak nuk kanë bashkëpunim. Të dhënat e fituara flasin se niveli i bashkëpunimit të mësimdhënësve me prindërit është mesatar dhe në të ardhmen shkollat duhet të gjejnë strategji dhe të krijojnë politika arsimore që t'i rrisin format dhe metodat e bashkëpunimit me prindërit.



Diagrami 23. Mendimet e mësimdhënësve lidhje me të arriturat e nxënësve në nivel nacional me testimet ndërkombëtare

Në pyetjen e fundit Lidhur me *të arriturat e nxënësve në nivel nacional me testimet ndërkombëtare* se *kjo është si pasojë e punës së tyre*, 46.9% e mësimdhënësve kanë pohuar që pjesërisht është ashtu, 30.4% se aspak nuk është ashtu, 11.6% se plotësisht është ashtu, 11.1% fajësojnë MASH-in dhe politikat e saj, si dhe sistemin arsimor në RMV.

Përfundimet

1. MASH duhet të krijojë strategji për zhvillim të mirëfilltë të arsimit duke siguruar kushte të barabarta infrastrukturore dhe furnizim me teknologji mësimore, si për shkollat urbane, ashtu edhe për shkollat rurale, që do të mundësonte kushte të barabarta për të gjithë nxënësit në të gjitha gjuhët mësimore.
2. Në bashkëpunim me Komunat dhe shkollat të miratohen kritere gjatë emërimit të drejtorëve dhe punësimit të mësimdhënësve me qëllim të depolitizimit të arsimit.
3. Në bashkëpunim me BZHA-ne të gjenden mekanizma adekuate për motivim të nxënësve të dalluar që të regjistrohen në fakultetet të cilët përgatisin kuadro mësimore, si dhe të ndahen mjete shtesë për sigurimin e trajnimeve për mësimdhënësit.
4. Të furnizohen shkollat me teknologji bashkëkohore për mësim.
5. MASH të bëjë revidimin e teksteve shkollore dhe të ofrojë tekste të cilat do të mundësojnë që mësimdhënësit dhe nxënësit më lehtë të arrijnë qëllimet që dalin nga programi mësimor. Gjithashtu të shqyrtohet puna e mungesës së teksteve shkollore, për arsye se ankesat nga mësimdhënësit dhe prindërit në këtë drejtim janë të mëdha.
6. MASH të formojë grupe ekspertësh të cilët do të hulumtojnë dhe analizojnë përdorimin e abetares mbarëkombëtare edhe në shkollat fillore me mësim në gjuhën shqipe në RMV.
7. ISHA në procesin e vlerësimit të shkollave dhe mësimdhënësve, mos marri vetëm si bazë vlerësimin e inspektorëve që kanë realizuar evaluimin integral, por edhe të dhënat nga vlerësimi intern i

shkollës, si dhe mendimin e komunës në lidhje me shkollën, me qëllim që t'i iket subjektivizmit në vlerësim.

8. Drejtorët e shkollave të vënë theks të veçantë në funksionimin e aktiveve profesionale në shkolla, pasi ata janë gjeneratorët kryesorë të zhvillimit profesional të mësimdhënësve.

9. Shkollat të gjejnë mekanizma për rritjen e bashkëpunimit me prindërit në nivel të partneritetit të barabartë, që do të ndikonte në rritjen e rezultateve të nxënësve në mësim.

LITERATURA

Boshkovska, R. at al. (2018) Arsimi inkluziv, udhëheqësi për punën e ekipit inkluziv shkollor, Shkup, Byroja për zhvillimin e arsimit

Butleska, U. at al. (2016), Doracak për vëzhgimin e punës dhe planifikimit të zhvillimit profesional të arsimitarëve dhe bashkëpunëtorëve profesional në shkolla fillore dhe të mesme, Shkup, Vinsent Grafika

Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar (2016), Kompetenca themelore profesionale dhe standarde për arsimitarë, Shkup, Vinsent Grafika

Strategjia e arsimit për periudhën 2018–2025 dhe plani i veprimit, Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë, 2018, Shkup

Projekti i USAID-it për shkollën fillore, Standardet e vlerësimit të nxënësve në shkollën fillore, Shkup

ABDURAUUF PRUTHI

Ekspert i çështjeve arsimore

SFIDAT NË ARSIMIN SIPËROR NË RMV GJATË 30 VITEVE TË FUNDIT

Abstrakt

Arsimi sipëror në Maqedoni ka kaluar nëpër disa faza të sistemeve të ndryshme shoqërore-politike. Deri në vitin 1966 në suaza të shtetit të atëhershëm jugosllav, ishte e pamundur që shqiptarët të kërkojnë arsimim sipëror në gjuhën e tyre amtare, por edhe shkollimi fillor dhe i mesëm ishte i dozuar nga qarqet politike që vendosnin në Beograd. Pas Plenumit të IV të Komitetit Qendror të LKJ-së, fatmirësisht ndryshuan shumë stereotipa të sistemit komunist, ashtu që filloi edhe një qasje krejt tjetër ndaj kërkesave të shqiptarëve (por jo edhe aq sa pritej), sidomos kur bëhej fjalë për arsimimin e tyre prej ciklit të ulët e deri te ai sipëror. Shumë shpejt u hap Universiteti i Prishtinës, kurse në Maqedoni edhe grupet shqipe në Shkollën e Lartë Pedagogjike. Më vonë, në vitin 1979 me iniciativë të disa intelektualëve shqiptarë të asaj kohe, në Kuvendin e atëhershëm të Maqedonisë u hodh poshtë kërkesa për hapjen e grupeve studimore në gjuhën shqipe në kuadër të disa fakulteteve të Universitetit të Shkupit, dhe atë falë kryetares së atëhershme të Kuvendit të RM-së, e cila pas vitit 1981 lavdërohej për punën e “mirë” që kishte bërë.

Me nderimin e sistemeve dhe pas pavarësimit të Maqedonisë, pas vitit 1991 intelektualët shqiptarë ri aktualizuan çështjen e arsimit në

gjuhën shqipe dhe meqë kërkesat e tyre për programe studimore në kuadër të universiteteve ekzistuese nuk u përfill nga shteti u detyruan të që në vitin 1994 të themelojnë Universitetin e Tetovës e arriti të zyrtarizohet vetëm 10 vite me pas. Në ndërkohë ishte hapur mundësia për institucione private të arsimit të lart, që gjithashtu shënoi një sfidë më vete arsimore jo vetëm për shqiptarë por në përgjithësi për arsimin sipëror në Maqedoni.

Hyrje

Gjendja në arsimin sipëror në Maqedoninë e Veriut menjëherë pas pavarësisë të saj, përgjatë gjithë kohës së viteve 90-ta, nuk kishte ndonjë ndryshim të madh nga gjendja e para vitit 1990. Një prej arsyeve kryesore për këtë mos ndryshim ishte mbajtja në fuqi për plotë 10 vite e Ligjin për arsim të lartë të ish – Jugosllavisë. Kjo do të thotë se, edhe pas pavarësisë së shtetit, vite me radhë, vetëm për shkaqe politike–etnike nuk u arrit që të finalizohet një ligj i cili arsimin sipëror të saj do ta bënte më kompatibil me atë të shteteve të zhvilluara të botës. Si çdo herë, dihej, se “fajtorët” kryesor për këtë ishin shqiptarët. Këta të fundit, nuk ndalonin së kërkuari në mënyrë permanente arsimin sipëror në gjuhën e vet amtare, bile prej aty ku me disa dekrete politike, Qeveria e atëhershme e Maqedonisë ua kishte suprimuar shqiptarëve këtë të drejtë në vitet e 80-ta të shekullit XX.

Krahas kësaj, vërehej edhe një dekadencë e përgjithshme në financim të dy universiteteve ekzistuese dhe institucioneve tjera që ishin të lidhura me arsimin sipëror. E njëjta gjë ndodhi edhe me financimin e punës kërkimore shkencore, kur kishte raste që disa vite me radhë, Ministria e Shkencës nuk financoi asnjë projekt

shkencor të profesorëve shqiptarë. Prandaj, ishte më se e nevojshme që RMV-ja të nxjerr një Ligj të ri për arsimin sipëror, i cili do të ishte më kompatibil me ligjet e shteteve më të zhvilluara të botës.

Shkëndija e parë ligjore

Me shumë vonesë, dhe më në fund, ligji i parë për arsim sipëror i Maqedonisë u aprovua në fund të vitit 2000.

Fatkeqësisht, si pjesëmarrës aktiv i grupit punues i cili duhej të përgatiste draftin e atij Projekt- ligji, askush nuk më konsultoi nga subjektet politike shqiptare të cilët duhej ta votonin në Parlamentin e Maqedonisë, edhe pse subjekti politik shqiptar në atë kohë në Qeveri, kishte përfaqësues të vet në këtë grup punues, por në cilësinë e deputetëve.



Ky ligj si i pari për arsimin sipëror i cili u aprovua në vitin 2000, shkaktoi shqetësim të madh te shqiptarët e Maqedonisë së veriut, dhe jo vetëm te ata, por edhe te shumë njohës tjerë të çështjeve arsimore. Para së gjithash, kritikant kishin të bënë me faktin se në atë kohë nuk u bënë analiza racionale, nuk u angazhuan njerëz kompetent për ta vlerësuar Ligjin dhe për të dhënë mendime

profesionale mbi bazën e të cilave do të merreshin parasysh të gjitha implikimet pozitive dhe negative që mund të rezultojnë pas aprovimit të atij Ligji në praktikë.

Çka fituan shqiptarët?

Vetëm një mundësi që do të thotë se nacionalitetet, pra edhe shqiptarët, mund ta përdornin gjuhën e tyre amtare në arsimin sipëror, vetëm në institucionet e tyre private të cilat mund të themelojnë me iniciativa të veta private. Kuptohet se në këtë rast shteti nuk mbante asnjë përgjegjësi për ta. Menjëherë pas paraqitjes së draft ligjit para deputetëve në Parlament, njoftova edhe deputetët shqiptarë dhe opinionin me një konferencë shtypi për implikimet negative që ky Ligj i sjell për shqiptarët. Fatkeqësisht, ligji u votua edhe nga deputetët shqiptarë pjesëmarrës në Qeveri.

Iniciativa e kundërshtime

Pas vitit 1994 nga Unioni i Intelektualëve Shqiptarë, u riafirmua kërkesa për hapje të institucioneve të arsimit sipëror në Maqedoni, sepse edhe vetë ligji i atëhershëm në fuqi nga ish Jugosllavia, kërkonte arsimin sipëror edhe për arsimtarët të angazhuar në ciklin e ulët dhe të mesëm të shkollimit. Në fillim ky ishte edhe një nga shumë shkaqet për të kërkuar institucione të arsimit sipëror për shqiptarët e Maqedonisë.

Duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e asaj kohe, mendimi i intelektualëve shqiptarë ishte hapja e një fakulteti pedagogjik si një universitet i vogël dhe i cili duhej të përgatit kuadro për arsim për mësim klasor dhe për grupe lëndore. Duke menduar se për këtë ide do të ketë një disponim më të mirë nga pala tjetër, u përgatit edhe

projekt, por i cili gjithnjë zvarritej nga qarqet politike maqedonase në pushtet duke gjetur arsye të llojeve të ndryshme.

Kishte ide edhe për hapje të grupeve me mësim në gjuhën shqipe në fakultetet të Universitetit të Shkupit, të cilat më vonë do të mund të kondensoheshin në një universitet shqiptar. Me këtë ide mendohej që të shfrytëzohen të gjitha resurset e fakulteteve si laboratorët, sallat e mësimi, amfiteatrot etj. Për këtë ide, nuk u tregua ndonjë interesim të shqiptarët, sepse nuk do të themelohej institucion i menjëhershëm ekskluziv shqiptar për arsim sipëror, dhe nuk dihej se sa do të zgjate realizimi i kësaj ideje.

Më vonë, me themelimin e UT në vitin 1994, u themelua institucioni i parë shqiptar i arsimit sipëror, por për fat të keq i duhej 10 vite për tu institucionalizuar, e për këtë periudhë 10 vjeçare mendoj se do të duhet të bëhen studime të veçanta nga ekspert të ndryshëm. Unë isha një ndër pjesëmarrësit në procesin arsimor të këtij universiteti aq sa më lejonin angazhimet e mija të shumta të asaj kohe, prandaj nuk do të mund të jap ndonjë vlerësim më meritör.

Avancimi i të drejtës së shkollimit – universitete publike në gjuhën shqipe

Për fat të mirë më vonë, gjegjësisht gjatë vitit 2004, u bënë ndryshimet në Ligjin për arsim sipëror, me të cilat u hoqën nenet kontestuese dhe me këtë u hap rruga ndërprerjes së diskriminimit në arsimin e shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut nga aspekti juridik. U bë institucionalizimi i Universitetit të Tetovës dhe më vonë u themelua edhe Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup, që ishte një hap shumë i rëndësishëm në edukimin e të rinjve shqiptar jo vetëm në Maqedoni por edhe atyre në rajon.



Universitete private – një hap pranë shteteve të zhvilluara

Nga ana tjetër, mund të thuhet se si hap pozitiv, me ligjin e vitit 2000, për herë të parë parashihej edhe hapja e universiteteve private me iniciativë të qytetarëve apo fondacioneve si nga vendi apo ashtu edhe nga bota e jashtme. Një mundësi e tillë ishte për tu përshëndetur sepse universitetet private në shumë shtete të zhvilluara ishin praktikë shumë herët dhe ato ishin në numër shumë më të madh se universitetet shtetërore dhe gjithnjë jepnin një cilësi shumë më të lartë studimi. Kjo u bë praktikë edhe në shumë shtete tjera që na rrethonin. Por, më vonë u panë të gjitha efektet pozitive dhe negative që kishte kjo mundësi.

– *Së pari*, për shkak të një sistemi të rrënuar dhe të korrupsuar në arsim, u lejua themelimi i një numri shumë të madh dhe i pakuptimtë i universiteteve private jo vetëm në Maqedoni (mbi 25), por edhe në rajon si në Shqipëri dhe Kosovë (e cila theu rekordin e numrit të universiteteve private, me mbi 36 të tilla). Krejt kjo dha një sinjal se te shtetet e vogla dhe të pazhvilluara (me korrupsion të lartë, me mungesë të kuadrove arsimore cilësore, me mungesë të kushteve hapësinore në raport me numrin e studentëve,

me mungesë të laboratorëve dhe kështu me radhë), për hapjen e universiteteve private duhet pasur qasje me një seriozitet të posaçëm. U pa qartë se për shumë themelues të universiteteve private, qëllimi kryesor ishte vetëm profiti.

Prandaj, Ministria e Arsimit dhe Shkencës duhet ti rishikojë standardet dhe kriteret e dhënies të lejes për punë të ndonjë universiteti dhe, po kështu duhet të veprojë edhe Këshilli për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të lartë kur merr vendime për dhënin leje të hapjes së programeve studimore nëpër universitete të ndryshme. Gjithashtu, komisionet për vlerësim dhe licencim të formuara nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës duhet të jenë të përbëra nga anëtarë kredibil, të respektuar dhe të nderuar në botën akademike por edhe në masën e gjerë.

Shumë i rëndësishëm është edhe kuadri arsimor, se a i plotëson kushtet apo jo për mësimdhënie sipas kriterëve të ligjit për arsim sipëror. Gjatë përzgjedhjes së arsimtarëve, a bëhet ajo sipas ligjit apo jo. Këtë nuk e them kot, sepse Inspektorati i arsimit shumë pak merret me këtë çështje në universitetet private.

Përvoja me Universitetin Ndërkombëtar Ballkanik

Një ndër ata që morën pjesë në themelimin e një universiteti privat jam edhe unë si anëtar—themelues i një Fondacioni nga Turqia dhe Maqedonia, por duke i aplikuar gjithmonë këto kritere që i përmenda më lartë. Bëhet fjalë për Universitetin Ndërkombëtar Ballkanik ku mësimi zhvillohet vetëm në gjuhën angleze dhe është i themeluar nga Fondacion joprofitabil. Gjithmonë kam pasur kujdes gjatë udhëheqjes time me Universitetin, i njëjti mos të predimensionohet me programe studimore në proporcion me numrin e studentëve dhe hapësirës të Universitetit. Më vjen mirë

që ky Universitet, ndër shumë universitetet private në Maqedoni, disa vite me radhë ka zënë vendin e parë në Maqedoni sipas listës së Shangait për mësimdhënie dhe mësim nxënie. Sot është i vendosur në kampus universitar modern me kushte shumë të mira të punës.

Me vet faktin se Maqedonia dëshiron të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian, patjetër se do të duhet të ndërmerret masa për përmirësimin e gjendjes në sferën e arsimit në përgjithësi, duke filluar prej atij të ulët deri në atë sipëror, sepse arsimit është shtylla kryesore për zhvillimin e një vendi. Prandaj jam optimist se me hapjen e negociatave me BE, vendi ynë do të shfrytëzojë të gjitha resurset dhe mjetet financiare që do ti dedikohen kësaj sfere.

Përfundimet

1. Pas pavarësimit, sistemi i arsimit të lartë u dëmtua për shkak të mos nxjerrjes së Ligjit të ri për 10 vjet me radhë.
2. Gjendja “në vend qëndro” me mbajtjen në fuqi të Ligjit të ish-Jugosllavisë diskriminoi shqiptarët por njëkohësisht i tensionojë edhe marrëdhëniet edhe ashtu të brishta ndëretnike
3. Ligji i vitit 2000 avancoi të drejtën e shkollimit në gjuhën shqipe vetëm në universitete private, që edhe pse një e drejte jo e plotë, prapë se prapë kishte anët pozitive
4. Ndryshimi i ligjit në vitin 2004 i hapi rrugë legalizimit të Universitetit të Tetovës dhe themelimit të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup
5. Tani që janë tejkaluar barrierat juridike sfida e përgjithshme mbetet rritja e cilësisë në arsimin e lartë

6. Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Këshilli për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të lartë, rishikojnë standardet dhe kriteret për dhënien e lejeve për punë, gjegjësisht marrjen e vendimeve për akreditimin e programeve studimore duke u bërë më kërkues për nivelin e cilësisë

7. Nëpër komisione vlerësuese dhe vendimmarrëse të caktohen persona kredibil dhe të respektuar si nga bota akademike ashtu edhe opinioni i gjerë

AVZI MUSTAFA

Ekspert i çështjeve arsimore

METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES NË UNIVERSITET – NË UDHËKRYQ

Abstrakt

Në emër të reformave në arsimin e lartë, kohët e fundit paralelisht masave për organizimin e universiteteve, bëhen përpjekje edhe për ndryshime nga aspekti i brendshëm, pra për zbatimin e mënyrave të reja të mësimdhënies dhe qasjes së studimeve. Instanca e fundit e këtyre ndryshimeve padyshim se duhet të jetë përmirësimi i cilësisë, i cili duhet të reflektojë në diploma që i vlejné tregut të punës. Por, pavarësisht këtij synimi, arsimiti i lartë në RMV duket se ka ngelur “në vend numëro”, si në universitetet publike ashtu edhe në ato private. Një prej arsyeve kryesore është padyshim paaftësia për ndryshime të mirëfillta.

Mësimdhënia në universitete publike anon ende nga e vjetra, kurse në universitete private, gjoja për të përmirësuar të vjetrën, po bëhen disa risi që, si duket, as ata që i bëjnë nuk e dinë se çka synojné të ndryshojné në ngritjen e cilësisë së mësimi. Mësimdhënia është një detyrë sa vështirë aq edhe komplekse, pasi kërkon njohuri, aftësi dhe shprehje të shumta, ndërsa procesi mësimor duhet të mbështetet në metodat dhe teknikat bashkëkohore, ku studenti ka nevojë të reflektojë, të vlerësojë dhe të zbulojë, pra është në detyrën e profesorëve të orientojnë studentët drejt të menduarit kritik dhe krijues.

Universitetet ndodhen në udhëkryq për disa arsye. E para, ka të bëjë me trashëgiminë socialiste të modelit ex katedra; e dyta me përcaktimin për modelin evropian të sistemit të transferimit të kredive (ETCS) dhe arsyeja e treta me modelin amerikan të shkollimit, i cili është fleksibil por që për fat të keq nuk zbatohet tek neve. Humbja e gati se tre dekadave me improvizime ka shkaktuar përgjithësisht kaos në sistemin e arsimit të lartë dhe me këtë nuk u është lënë hapësirë shkencave didaktike – pedagogjike që të merren me analiza dhe hulumtime të cilat do të na orientonin drejtë reformave të mirëfillta e, të cilat pa diskutim se duhet të mbështeten e në metodologjinë dhe teknikat e mësimdhënies nëpër universitete.

Fjalë kyçe: metodologjia e mësimdhënies, cilësia në universitete, ex katedrat, sistemi evropian i transferimit të kredive, modeli amerikan, etj.

Hyrje

“Të dish të bësh pyetje, do të thotë të dish të bësh mësim “ (Xhon Djui)

Me nocionin mësimdhënie bashkëkohore, kuptojmë dhënien ndryshe të mësimin dhe përdorimin e mëtova jo tradicionale. Në metodikën e mësimdhënies, ky nocion përfaqëson një gamë të gjerë aspektesh, si: strategjinë, metodat, teknikat, format, ndryshimin e rolit të ligjërimit dhe të të menduarit ndryshe, përcaktimin e objektivave, mënyrën e vlerësimit etj. Prandaj ”Me mësimdhënie bashkëkohore duhet të kuptojmë atë lloj mësimdhënie, e cila

lehtëson me forma, metoda, teknika, dhe strategji të përshtatshme në procesin e të nxëniet të nxënësve”¹.

Mësimdhënia bashkëkohore nënkupton të nxëniet aktiv, të menduarit në mënyrë kritike, krijuese. ”Mësimdhënia është një detyrë e vështirë dhe komplekse dhe kërkon njohuri, aftësi e shprehje të shumta”². Procesi mësimor bëhet duke u mbështetur në metodat dhe teknikat bashkëkohore, ku nxënësi mëson duke reflektuar, vlerësuar, zbuluar dhe duke zgjidhur probleme. Ajo është një proces, veprimtari që ndryshon vazhdimisht. Në mësimdhënien bashkëkohore nxënësi apo studenti nxitet në procesin mësimor për veprimtari të ndryshme për përvetësimin e diturive të reja, çdo herë duke u mbështetur në përvojën, interesin, nevojat dhe burimet e informacionit.

Shkaqe dhe frustracione

Kohëve të fundit, në emër të reformimit të mësimin universitar, po ndërmerren masa si nga aspekti i jashtëm, ashtu edhe nga aspekti i brendshëm, me qëllim që të ndryshohet diçka në universitetet e vendit, si në universitetet publike ashtu edhe në ato private. Cilësia e mësimin në

universitet publike, për sa i përket metodologjisë së mësimdhënies, ende po animon me të vjetrën, kurse në ato universitete profitabile, gjoja duke e përmirësuar të vjetrën, po bëhen disa risi që, si duket, as ata që i bëjnë nuk e dinë se çka synojnë të ndryshojnë në ngritjen e cilësisë së mësimin. Të gjitha këto ndodhin në proceset gjoja reformuese arsimit.

¹ Bardhyl Musai, Mjeshtritë themelore të mësimdhënies, Tiranë. 1996, f. 15

² Bardhyl Musai, Metodologji e mësimdhënies, Pegi, Tiranë, 2003, f. 54



Detyra e universitetit është për të shpërndarë dijen te gjeneratat e reja, dhe kjo në ditët e sotme nënkupton se “ata duhet t’i shërbejnë shoqërisë si një tërësi, dhe se ardhmëria kulturore, sociale dhe ekonomike e një shoqërie kërkon në veçanti një investim të konsiderueshëm në arsimim të vazhdueshëm”³. Të gjitha këto ndryshime që kërkohen duken si të paqarta dhe shumë të shpejta e pa analiza. Ato duhet të fitojnë rëndësi të veçantë brenda harkut kohor të një brezi. Problemet themelore të arsimit në përgjithësi na hutojnë, sepse ne ende nuk e kemi kuptuar dhe përcaktuar mirë e qartë se çfarë modeli të njeriut dëshirojmë në këtë shoqëri.

Universitetet publike, si ato private⁴ ndodhen në udhëkryq për tre arsye:

- e para, për shkak të modelit të trashëguar nga epoka e socializmit
- i a.q. ex katedra;
- e dyta, modeli i “sistemit evropian me sistemin e kredisë” dhe

³ Shiko: Magna Charta Universitatum, Bolonjë, 1988

⁴ Në Maqedoninë e Veriut kemi 25 institucione të arsimit të lartë, prej të cilave 6 janë shtetërore, ndërsa 19 janë private.

– arsyeja e tretë ajo që në literaturën pedagogjike quhet modeli “amerikan”, i cili nuk përdoret aspak tek ne

Sot kur kemi një kohë dinamike, mësimdhënia duhet të bazohet në kompetencat që përfshijnë një sistem të integruar të njohurive, shkathtësive dhe të qëndrimeve të zbatueshme dhe të transferrueshme, të cilat do t’u ndihmojnë studentëve, që të ballafaqohen me sfidat e kohës (të ekonomisë së tregut të lirë), që më shumë se kurrë kërkojnë dije të bazuara në aftësi.

Cilën metodologji të mësimdhënies do ta zgjedhim?

Te ne sot kanë zënë vend shumë projekte të ardhura perëndimore e shumë hospitime. Nga të gjitha ato po merret nga diçka. Kështu, si kusht kryesor për metodologjinë e mësimdhënies në shumë universitete merren marrëdhëniet student–profesor, duke e lënë anash faktorin e tretë të trekëndëshit didaktik – mësimin.

Në universitetet tona tani përdoret modeli i sistemit evropian, i përzier me modelin “socialist”, ku në fakt dominon sistemi “i memorizimit”, të cilit tashmë i ka kaluar koha. Kërkesat për ndryshimin e metodologjive të mësimdhënies, që po shprehen në shtetet e Perëndimit, që moti po hasin në kritikë të rreptë, madje atje u kërkua edhe zhbërja e shkollës. Në disa raste atje shkollat krahasoheshin me kompanitë e mëdha që falimentojnë. Ata theksonin se shkollat janë njësoj si kompanitë, të cilat ua kultivojnë dhe ua imponojnë shijet e tyre njerëzve, me qëllim që t’ua shesin atyre prodhimet e veta”. Tashmë është i njohur konstatimi i I. D. Iliç-it, sipas të cilit “njeriu pjesën më të madhe të diturive që i di i

ka mësuar jashtë shkollës”⁵. Ai më tej vazhdonte: “ne mësojmë të flasim, të mendojmë, të dashurojmë, të ndjejmë, të lozim, të merremi me politikë pa ndërhyjen e mësuesit”. Pa ndërhyrë në komente rreth ideve të këtij autori, njafton të përmendim se ai është autor i librit “Poshtë shkollat”⁶. Këto dhe dilemat e tipit “zhdukja e shkollës”, “shoqëri pa shkolla” dhe “të mësojmë si të jemi” të E. Forit etj., hapën diskutime të shumta e të pafundme. Njëra nga dilemat ishte edhe se mbi cilat parime, norma dhe struktura duhet të ndërtohet arsini në përgjithësi, dhe mësimdhënia, në veçanti. Andaj shtrohet pyetja: a do të mbetemi rob i “skemës përmendësh” apo do të synojmë komunikim të hapur?

Ku harxhohet energjia?

Edhe pse gati do të mbushen 29 vjet nga tranzicioni, ne ende nuk kemi arsim të transformuar. Gjatë gjithë kësaj kohe te ne gjithë energjia është harxhuar për reformë të jashtme. Dhe, më e keqja është se secili ministër që vjen në këtë dikaster, e fillon punën nga e para, secili merr ndonjë model nga Evropa dhe pa analiza dëshiron që ta zbatojë në arsimin tonë.

Në universitet, studentët ende i vijojnë leksionet në auditoriume, duke e dëgjuar profesorin, ndërsa leksioni mbaron pa pyetje e diskutime. Studentët ende nuk janë të aftë ta përpunojnë e komunojnë informacionin mbi argumente. Sepse, nuk ka metodologji mbi të cilën do të mbështetjet argumenti. Prandaj, gjithçka mbësh-

⁵ Pëllumb Gaçe, Sistemet politike, ekonomike, shoqërore e arsimore ne disa vende të zhvilluara kapitaliste gjatë viteve 1960-1990 në këndvështrimin e pikëpamjeve të teorive filozofike e pedagogjike të kohës, Revista pedagogjike nr. 3, 1999, f. 34-35

⁶ Pëllumb Gaçe, Sistemet politike, ekonomike, shoqërore e arsimore ne disa vende të zhvilluara kapitaliste gjatë viteve 1960-1990 në këndvështrimin e pikëpamjeve të teorive filozofike e pedagogjike të kohës, Revista pedagogjike nr. 3, 1999, f. 26

tetet në përgatitjen profesionale të arsimit dhe mbi tekstet universitare. Siç prononcohet profesori Adem Temo, “askush nuk çan kokën se ç’u thuhet studentëve.” Gjithashtu edhe vlerësimi bëhet pa asnjë kriter, bile edhe më keq se tani studentët e mirë nuk kanë mundësi t’i shprehin mendimet e tyre të pavarur, ndërsa në fund krejt vlerësimi reduktohet me një a dy teste me rrethim të pyetjeve. Tani çdokush mbaron fakultet dhe pa dituri, madje edhe me nota shumë të larta.

Problemet në sistemin tonë duhet të shikohen në ndryshimin e modeleve të mësimdhënies. Këtë problem kohëve të fundit e aktualizon Edmond Çata, M. A., studiues i shkencave politike. Ai thotë se tani nuk dihet kah të orientohemi: nga modeli a.q. amerikan, i cili i vendos marrëdhëniet student–profesor në një realitet tjetër apo në modelin e sistemit evropian të bazuar në sistemin e pikëve kreditore ose, siç quhet ndryshe, mënyra binare e vlerësimit⁷

Në sistemin tonë arsimor edhe tani dominon një ngurtësi e tepruar e kurrikulave, të cilat bëhen sipas profesorit, e jo sipas asaj që e kërkon tregu i punës; te ne vërehet se kemi numër të madh të studentëve në ushtrime, kemi staf akademik shpesh pa fare përvojë, kemi mungesë bashkëpunimi midis universiteteve, orientim të gabuar të studentëve në programet studimore, si dhe tekste të përkthyer keq ose të shkruara keq, korrupsion dhe të ngjashme.

Modelet

Nëse përcaktohem për modelin “pluralist” të mësimin, studenti vendoset aty para karakterit të një numri të madh informacionesh.

⁷ <http://www.panorama.com.al/propozime-konkrete-per-nje-qasje-te-re-per-arsimin-e-larte-dhe-universitetin/>

Në të, ai duhet të mësojë dhe të gjurmojë literaturë nga burimet e ndryshme për të debatuar ose për të zgjedhur probleme praktike. Aty studenti është krejtësisht i pavarur në artikullimin e mendimeve, pikëpamjeve ose teorive.

Sipas modelit evropian të sistemit të transfer-kredive, studenti është i detyruar që ta ndjekë rregullisht kursin, por pa ndonjë debat, duke dëgjuar mësim ex-katedra, kurse vlerësimi bëhet nëpërmjet testeve, dorëzimit të punimeve të seminarit pa diskutim për to etj. Të gjithë studentët që i plotësojnë këto kërkesa nga profesori fitojnë një numër të caktuar të pikëve.



Studenti e mbaron kursin e lëndës me marrjen e pikëve përkatëse. Nëse studenti nuk i arrin pikët e duhura nga ndonjë lëndë, ka mundësi që ta përsërisë atë. Kjo nuk është e përcaktuar për gjithë programin semestral, por vetëm për një ose dy lëndë. Po ashtu duhet të potencohet se kulturës së të shkruarit aspak nuk i kushtohet vëmendje, që pastaj rezulton me shumë studentë që mbetën thuaja analfabetë!

Diploma dhe nota nuk janë zgjidhje

Modeli pluralist kërkon vlerësimin shumë komponentësh. Studimi për studentin nuk është as zgjidhje e hallit, as kalkulum individual, siç po bëhet me studentët tanë. Rezultati është produkt i investimit të studentit dhe kërkesës së tregut të punës. Profesori në këtë rast është vetëm një ndihmës i studentit për problemet që dalin dhe udhëzues i tij drejt sukseseve të reja.

Sipas këtij modeli ku profesorin e vendos në një pikë të debatit, ku ai shkon në mësim vetëm me teza për të cilat studentët do të debatojnë, ndërsa studentin për çdo temë mësimore e obligon që të lexojë të paktën 5–8 studime, a për çdo njësi mësimore se paku 3 studime ku do të mund të debatojë dhe të shprehë mendimet e tij. Për angazhimin e tij dhe për mendimin kritik studentin edhe vlerësohet.

Modeli i tanishëm i mësimdhënies, që është një miksi i të vjetrës dhe të resë, ka sjellë një huti të madhe, sepse studentin përveçon vetëm njohuri, kurse shkathtësitë dhe qëndrimet nuk vijnë në konsideratë. Kjo është kështu, sepse çdo gjë kushtëzohet me financa. Kështu që edhe pse në ushtrime duhet të vijnë në shprehje debatet e qëndrimet rreth asaj që duhet të mësohet, përsëri ata ngelin në grupe të mëdha, pa kushte për debate dhe qëndrime.

Arritja e rezultateve të shprehura me nota tani nuk është kriter i njohurive, shkathtësive e qëndrimeve të pavarura të studentëve, sepse ai nuk është në gjendje të bëjë thujë asgjë që kërkohet prej tij, sepse thjesht nuk është aftësuar as për gjërat më të rëndomta.

Duke e ditur se tani më nuk është koha e memorizimit teknik të formulave e gjeneralizimeve, por është koha që nga studentët të kërkohet ta dinë si të mësojnë, si t'i seleksionojnë informacionet e

shumta që vërschojnë gjithandej, të fitojnë shkathhtësi, qëndrime, që do të thotë se tani duhet të dominojë karakteri “pluralist” i informacionit dhe debatit në sallat e fakultetit, me të drejtë mund të konstatojmë se arsimi universitar te ne është para shumë pikëpyetjeve dhe kërkon zgjidhje urgjente.

Pasojat e mësimdhënies së dobët

Cilësia e mësimdhënies në universitetet tona është një shqetësim dhe sa më parë duhet t’i kushtohet kujdes i veçantë, duke evidencuar së pari problemet e pastaj të përgatitet ndonjë strategji për përmirësimin e mësimdhënies në universitetet tona.

Për nivelin e dobët të mësimdhënies në universitet dhe pajisjen e studentëve me njohuri gjithësesi është përgjegjësi e profesorit. Sipas sondazheve, nëpër universitete më se 40% e stafit të tyre janë të punësuar jo me nivelin e domosdoshëm profesional, madje ka edhe pedagogë që i kanë mbaruar studimet universitare nën nivelin që kërkohet për mësimdhënie.

Cilësia e ulët e mësimdhënies, padyshim që reflektohet te cilësia e dobët e studentëve⁸. Një shembull, që është më se kuptimplotë: Studentët që mbarojnë një fakultet të gjuhës, përgjithësisht nuk dinë të bëjnë as edhe një akt formal të çfarëdo lloji, nuk dinë të përpilojnë një shkresë ose më saktë, nuk dinë të shkruajnë pa gabime as edhe shqip.

Për gjendjen e këtyllë fajin e hedhin në shumë faktorë, si atij të masivizimit, dikush indiferentizmit, dikush mungesës së motivimit, mbingarkesës me shumë lënde e orë mësimore, cilësisë së

⁸ Dr. Elmas LECl, Cilësia e mësimdhënies në universitete dhe punësimet nepotike, Ballkan Veb, 20 dhjetor 2019

veprimtarisë kërkimore në universitete, nepotizmit, korrupsionit, politikës etj.

Unë mbetem në atë që gjithsesi të mbrohet integriteti dhe liria akademike, po kërkoj të jemi vigjilentë kundër mashtrimit, sepse pranimi i stafit akademik në universitet tona është bërë pa kritere rigorozë akademike. Në universitet tona shumë profesorëve u mungon përgatitja solide profesionale e pedagogjike.

Mësimdhënia në universitet tona ka nevojë për një ndryshim themelor në metodat e mësimdhënies, nga një proces i fokusuar në transferimin, duke kërkuar metodat e mësimdhënies ndërvepruese, e cila mundëson përdorimin e teknologjive moderne që shkojnë drejt hapjeve të diskutimeve dhe të menduarit kritik në mesin e studentëve. Kjo punë sa më parë duhet të zgjidhet për të kërkuar një mësimdhënie cilësore dhe frytdhënëse në universitetet tona.

Përfundimet

- Për të zgjidhur problemet që ka sot shoqëria dhe për t'ju qasur reformave në arsim duhet fillimisht të përcaktohem qartë se çfarë modeli të njeriut dëshirojmë të ndërtojmë në shoqëri;
- Në RMV përdoren modele te miksuara të arsimit, ai i *ex katedrave* të trashëguara nga epoka e socializmit dhe modeli i *sistemit evropian të transferimit të kredive*. Të dyja këto modele kanë mangësi të mëdha;
- Modeli amerikan i arsimit, i cili është tejet flaksibil, nuk ka gjetur ende zbatim tek neve dhe kjo ka penguar reformimin e mirëfilltë të arsimit sa i takon cilësisë së mësimdhënies nëpër universitete;

- Cilësia e mësimdhënies ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e diplomës dhe kjo e fundit në zhvillimin e shoqërisë;
- Për daljen nga situata është e nevojshme të punohet me metodat ndërvepruese të mësimdhënies si dhe të përdoren në masë të gjerë teknologjitë moderne;
- Shoqërisë i duhen studentë që kanë mendim kritik dhe shpirt kërkues. Askush më mirë se mësimdhënësit nuk mund ti orientojnë studenten të mësojnë në këtë frymë

LITERATURA:

Bardhyl Musai, “*Mjeshtritë themelore të mësimdhënies*”, Tiranë, 1996

Bardhyl Musai, “*Metodologji e mësimdhënies*”, Pegi, Tiranë, 2003

MAGNA CHARTA UNIVERSITATUM, Bolonjë, 1988

Pëllumb Gaçe, “Sistemet politike, ekonomike, shoqërore e arsimore ne disa vende të zhvilluara kapitaliste gjatë viteve 1960–1990 në këndvështrimin e pikëpamjeve të teorive filozofike e pedagogjike të kohës”, Revista pedagogjike nr. 3, 1999

Elmas Leci, “Cilësia e mësimdhënies në universitete dhe punësimet nepotike”, Ballkan Veb, 20 dhjetor 2019

<http://www.panorama.com.al/propozime-konkrete-per-nje-qasje-te-re-per-arsimin-e-larte-dhe-universitetin/>

DEMUSH BAJRAMI

Universiteti i Evropës Juglindore

**VEPRIMTARIA INSTITUCIONALE
E STRUKTURAVE UNIVERSITARE,
E INTEGRUAR NË STRATEGJINË
E ARSIMIT TË LARTË**

Abstrakt

Koncepti për universitetin modern nuk është një term i shpikur që duhet të mësohet përmendësh, sa herë që kemi nevojë ta përshtatim atë në rrethanat tona të arsimit të lartë. Përkundrazi, ky punim tregon se universiteti modern nënkupton një bashkëdyzim përvojash më të avancuara në rrafshin evropian e global dhe përshtatje me ato forma e modele që do t'i shkonin natyrës së organizimit vendor universitar, gjithmonë duke pasur parasysh prioritetet që e bëjnë atë përshtatje sa më kompatible me tregun e punës, me kurikulat kreative dhe jo shumë doktrinare, e mbi të gjitha me kapacitete absorbuese të shoqërisë. Por, e gjithë kjo nuk mjafton, sepse komponenti akademik i universitetit do të ishte i mangët, pa atë shkencor. Për rrjedhojë, që të ecet drejt inovacionit shkencor, është i nevojshëm ideimi, nxitja dhe ndjekja e zbatimit të projekteve ndëruniversitare apo ndërinstitutionale, që lidhen me vizionet e afishuara dhe të përpunuara në vazhdimësi; krijimi dhe zbatimi i formave të ndryshme të bashkëpunimit në projekte kërkimore—shkencore ndëruniversitare vendore, rajonale dhe ndërkombëtare.

Pa këto komponentë kompatible, mbetet i zbrazët kuptimi modern për universitetin, prandaj është e domosdoshme që kjo zbrazëti të mbushet vetëm me kreativitet dhe vizion. Prandaj, trajtimi i problemeve të arsimit të lartë përmes qasjeve analitike të gjendjes dhe veprimtarisë institucionale të strukturave universitare, të integruara në sistemin, politikat dhe strategjinë e arsimit të lartë, përbën sfidën kryesore të së ardhmes.

Fjalët kyçe: universiteti, arsimi i lartë, veprimtaria institucionale, kurrikulat, kërkimi shkencor

Hyrje

Epoka në të cilën jetojmë është transformuar ndjeshëm, si në aspektin gjeokulturor ashtu edhe në atë social e teknologjik. Kjo e fundit, madje është sinonim i të gjitha transformimeve, prandaj jo rastësisht, sot ecuria e zhvillimeve globale matet me shkallën e avancimeve në fushën e digjitalizimit dhe futjen e teknologjisë së informacionit në të gjitha segmentet e botës shkencore, industriale e arsimore. Kjo, ka sjellë edhe një përshtatje të detyrueshme të natyrës së punës, kurse ajo që është më thelbësorja epoka në të cilën jetojmë, kërkon një homosapiens⁹ të ri, me performanca që do ta reduktonte konceptin e kohës dhe hapësirës brenda kufijve digjital. Për të panjohurat e digjitalizimit, stili i të mësuarit i *homosapiensit* është plotësisht i huaj dhe i papërshtatshëm sepse ata (*homosapiensët*) kanë mësuar të shkojnë ngadalë, hap pas hapi, të mësojnë vetë, pa i përfshirë të tjerët në proceset e tyre të të

⁹ Termin Homo Sapiens e kishte përdorur për herë të parë publikisht në vitin 2000, në një konferencë në Oslo, profesori universitar holandez, Wim Veen.

mësuarit dhe se mësimin e kanë parë si një dukuri serioze dhe jo si argëtim¹⁰.



Nëse në të kaluarën, por edhe sot ushtritë dhe policitë i ruajnë kufijtë në mes shteteve, tashmë këta kufij kanë filluar ta humbin kuptimin sepse mbi dallueshmërinë e civilizimeve po injektohet një vetëdije digjitale e njeriut modern. Ky transformim global i botës nuk do të mund të ishte i plotë pa një kondicion intelektual, shkencor e akademik të këtij brezi që po bëhet gjithnjë e më tepër pjesëmarrës aktiv se sa një vëzhgues pasiv i ndryshimeve teknologjike. Për rrjedhojë, edhe arsini si pjesë e qenësishme e këtij ndryshimi ka nevojë të riformatojë politikat dhe strategjitë, në harmoni me ambiciet dhe tendencat e njeriut modern. Kështu, Dewey, do të shprehej se “arsimimi është një proces social, arsimimi

¹⁰ Marc Prensky (2010). *Teaching Digital Natives: Partnering for Real Learning*, Corwin A SAGE Company, Thousand Oaks.

është rritje, arsimimi është jo përgatitje për jetën, por vetë jeta”¹¹ “Të mësuarit gjatë gjithë jetës”¹² nënkupton procesin e të mësuarit formal, joformal dhe informal në sistemin e arsimit publik dhe atë privat, në të cilin njerëzit zhvillojnë aftësitë, pasurojnë njohuritë dhe përmirësojnë kualifikimet e tyre apo u japin atyre një drejtim të ri me qëllim që të plotësojnë më mirë nevojat e tyre dhe të shoqërisë ku ata jetojnë. Këto tri kategori gjejnë bazën e të mësuarit, edhe në Memorandumin e Komisionit Evropian mbi të mësuarit gjatë gjithë jetës, të publikuar që në vitin 2000. Kjo do të thotë se, që prej dy dekadash ky memorandum kishte për qëllim të nxisë një aktivitet më të gjerë arsimor të gjithë atyre që synojnë pandashëm formimin profesional, intelektual, krijues dhe akademik. Sipas Letrës së Bardhë për Dialogun Ndërkulturor, “Të jetojmë së bashku si të barabartë me dinjitet”¹³. nga Këshilli i Evropës në vitin 2008, për të jetuar së bashku në paqe njerëzit kanë nevojë për aftësi apo “kompetenca” të cilat nuk fitohen automatikisht, por duhen mësuar dhe praktikuar që në moshë të hershme, në mënyrë që të ruhen për gjithë jetën¹⁴.

Ideja se arsini cilësor është një nga bazat e zhvillimit dhe të përpërimit të një shoqërie në rrafshin ekonomik dhe kulturor, duhet të jetë qëllim yni institucional për të ofruar arsim të lartë me cilësi të

¹¹ Dewey, John. [1916] 1997. *Democracy and Education: An Introduction to the Philosophy of Education*. New York: The Free Press, f. 239.

¹² ‘Të mësuarit ose arsimi gjatë gjithë jetës’, është ide e kahershme, por ngritja në shkallë të një filozofie të re arsimit përkon me të ashtuquajturin revolucion teknik e shkencor, që lidhet me emrin e Gelang Paul Lang (Prl Lengrand), ekspert i UNESCO-s.

¹³ Me iniciativën e Ministrave të Jashtëm të Këshillit të Evropës në Sesionin e 118 Ministror (Strasburg, 7 maj 2008).

¹⁴ Të jetojmë së bashku. Të ndërthurim diversitetin dhe lirinë në Evropën e shekullit 21, Raport i Grupit të Personave të Shquar të Këshillit të Evropës (http://www.asp.al/pdf/GEP_report_web.pdf) Shikimi i fundit, 01.02.2020.

lantë, inovativ, efikas, në mënyrë që të kontribuojë në konkurrencën e brendshme, rajonale dhe ndërkombëtare.

Efektet e reformave arsimore evropiane në Maqedoninë e Veriut

Kalimi nga mendësia që arsimin e perceptonte si pjesë të doktrinae propagandistike për njëfarë revolucioni shoqëror, në një trajtë krejt tjetër të rolit dhe rëndësisë së arsimit në jetën e njeriut modern, ka prodhuar në planin global një vetëdije të re mbi politikat arsimore. Ajo që mbetet konstante është se të nxënit apo të mësuarit formal, zhvillohet në institucionet përkatëse të arsimit dhe formimit dhe finalizohet me diploma dhe kualifikime të njohura.

Roli i arsimimit formal është i pazëvendësueshëm në përfitimin e kompetencave kyçe, të përkufizuara sipas Këshillit të Evropës për tregun e punës. Para së gjithash, duhen nisma institucionale që të nxitet një bashkëpunim dhe veprim i koordinuar i segmenteve të ndryshme në shoqëri, edhe atë duke filluar nga institucionet universitare në vend dhe në rajon, pastaj institucionet qeveritare dhe sektori joqeveritar nga fusha e arsimit. Dhe, kur jemi këtu, nuk mund ta anashkalojmë mendimin e ish-presidentes së Irlandës, Mary McAleese, e cila do të shprehej qartë: “Arsimimi ka çelësin jo vetëm të punëve më të mira dhe rritjes më të madhe të prodhimit bruto vendor (PBB-së), por edhe të zhvillimit kulturor, politik dhe social, që nevojitet për t’u siguruar se qytetarët janë të përgatitur dhe me këmbë në tokë për të udhëhequr në nivele lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Duke u fokusuar te politikat e duhura, liderët e BE-së mund të sigurohen se arsimimi u mundëson atyre për të qenë qytetarë globalë të artikuluar dhe aktorë ekonomikë të

fuqishëm”¹⁵. Nga ky këndvështrim del që sfera e interesimit për arsimin shkon duke u zgjeruar, kurse qeveritë nacionale, me institucionet përcjellëse, duhet të jenë më të përgatitur që arsimin të mos e shohin si reparti i ndarë i një uzine, por pjesë integrale e saj, sepse vetëm në këtë mënyrë integrohet ideja zhvillimore në procesin e përgjithshëm të një shoqërie.

Dijet, aftësitë dhe njohuritë, që i fitojmë si fëmijë dhe të rinj në familje, në shkollë, gjatë trajnimeve ose në universitete nuk do të zgjasin gjithë jetën. Jo rastësisht vërehet një përshpejtim në riformatimin e konceptit të të mësuarit, në një koncept të “të mësuarit gjatë gjithë jetës”, ku procesi i të mësuarit shihet në vazhdimësi si një bashkudhëtar i pandarë në ecjen dhe formimin profesional të individit. Pra, të mësuarit gjatë gjithë jetës ka zënë vend qendror në mjaft dokumente të rëndësishme ndërkombëtare mbi arsimin. Ndër to, duhet përmendur: Memorandumi i nxjerrë nga Komisioni i Bashkimit Evropian, i titulluar: “Të mësuarit gjatë gjithë jetës” (tetor 2000), Konferenca e UNESCO-s mbi arsimin e të rriturve (CONFINTEA, mbajtur në Hamburg, nëntor 1997), etj. Tashmë, Evropa 2020 quhet strategjia e rritjes së Bashkimit Evropian dhe ka për qëllim nxitjen e një rritje *të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse*. Të tre këto qëllime synojnë të ndihmojnë Bashkimin Evropian të ofrojë nivele të larta të punësimit, produktivitetit dhe kohezionit social¹⁶. Aktualisht, të gjitha këto dokumente dhe kontribute të institucioneve ndërkombëtare, kanë një jehonë e cila ka trokitur gjithkund ku ka nevojë më së shumti të ndërmerren aktivitete, qoftë si shoqëri qoftë si shtet. Vlen të theksohet se

¹⁵ Mary McAleese, ish-presidente e Irlandës, aktualisht presidente e Grupit të Nivelit të Lartë të BE për modernizimin e arsimit të lartë.

¹⁶ José Manuel Barroso, Raport i Komisionit, Evropa 2020 – Strategjia për një rritje të mençur, qëndrueshëm dhe inkluziv, Bruksel, 2010

Maqedonia ka 14 universitete dhe 5 shkolla të larta profesionale. Në vitin 2016/17 numri i studentëve të regjistruar në të gjitha institucionet e arsimit të lartë ishte 58.083 studentë. Nga ky numër, pjesa më e madhe e studentëve (86,6%) janë regjistruar në institucionet shtetërore të arsimit të lartë, ndërsa 13% janë regjistruar në institucionet private të arsimit të lartë. Raporti student–profesor është 20,3 (58.083 studentë përkundrejt 2.854 profesorë)¹⁷ Mirëpo, duke ndjekur tendencat globale dhe rajonale, shumë pak universitete në Republikën e Maqedonisë së Veriut u rreshtuan përkrah Universitetit të Evropës Juglindore (UEJL), që të implementojnë metodat më të përparuara të mësimdhënies në arsimimin e lartë në kuadër të sistemit formal arsimor.



Arsimi i lartë është një pjesë integrale e sistemit të të mësuarit gjatë gjithë jetës. Rezultatet e arsimit të mesëm barten në arsimin e lartë, kështu që nga cilësia e shkollës së mesme varet edhe cilësia e arsimit të lartë. Më tej, nga arsimi i lartë hyhet në botën e punës dhe në sistemin e arsimit të mëtutjeshëm formal dhe joformal. Qëllimet e

¹⁷ Marija Topuzovska Latkovikj, Mirjana Borota Popovska, Eleonora Serafimovska, Aneta Cekikj, Nita Starova (2019). Studim rinor në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2018/2019, Friedrich-Ebert-Stiftung, Shkup.

përgjithshme të arsimit të lartë janë optimizimi i zhvillimit të qëndrueshëm nacional, por edhe krijimi i njohurive të reja që nuk janë rezultat i drejtpërdrejt i atij mjedisi dhe mund të mos rezultojnë me një përfitim të menjëhershëm shoqëror. Një përcaktim i tillë pluralist i qëllimeve të arsimit të lartë, ka implikime të mëdha për pozicionimin shoqëror dhe financimin e shkencës dhe arsimit të lartë. Meqenëse institucionet e arsimit të lartë nuk janë vetëm vende të ndërmjetësimit të njohurive ekzistuese të nivelit të lartë dhe atij shkencor, por ato janë gjithashtu edhe vende të krijimit të njohurive të reja shkencore dhe të nivelit të lartë, sistemet e arsimit të lartë dhe të shkencës janë të ndërlidhura ngushtë dhe duhet të koordinohen. Për më tepër, kjo tregon se duhet një mbështetje më e madhe e veprimtarive kërkimore-shkencore, veçanërisht nga institucionet dhe organizmat e ndryshëm shtetëror, përfshi edhe sektorin privat që tregon interesim. Shumë nga këto tashmë janë pjesë e Strategjisë së arsimit për vitin 2018–2025 dhe Planveprimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, sidomos në aspektin e arsimit të lartë dhe hulumtimit¹⁸, sikurse janë:

- rritja e cilësisë në arsimin e lartë nëpërmjet përmirësimit plotësues të punës së Këshillit për akreditim dhe vlerësim në arsimin e lartë;
- përmirësimi i bazës materiale e metodologjike të arsimit të lartë;
- zhvillimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë, sektorit privat dhe organeve publike relevante;
- optimizimi i profileve arsimore që financohen nga shteti, kurse u ofrohen universiteteve në Maqedoni dhe sigurimi i qasjes së

¹⁸ Strategjia për arsim për vitin 2018-2025 dhe Plani i Veprimit, Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2018, f.

barabartë në arsimin e lartë, kohezioni social dhe të nxëniet gjatë gjithë jetës;

- sigurimi i rrjetëzimit me universitetet e huaja,
- përmirësimi i kapaciteteve për akomodimin e studentëve të universiteteve publike;
- rritja e investimeve publike dhe private në kërkimin e zbatuar, zhvillimin dhe risitë.

Pra, rritja e niveleve cilësore të punës kërkimore–shkencore, mund të bëhet duke u përafruar dhe krahasuar me standardet ndërkombëtare në fusha të caktuara kërkimore, që të vlerësohen, përdoren dhe publikohen në botimet e institucioneve ndërkombëtare.

Ndonëse, mirëqenia e përgjithshme e një shoqërie deri më tani është matur vetëm me parametra ekonomikë, duke e përjashtuar arsimin si katalizator i këtij procesi zhvillimor, sistemi global i informacionit teknologjik ka bërë që të krijohen modele unike në politikat arsimore, kurse emërues i përbashkët i këtyre politikave (përfshi këtu edhe Strategjinë e arsimit për vitin 2018–2025), është pikërisht investimi në shkencë, në hulumtime dhe në avancimin e shkathtësive teknologjike, në metodikën e re akademike. Investimi në arsim, duhet nënkuptuar si investim në ekonomi dhe industri, sepse sot nuk mund të merret parasysh një ekonomi e zhvilluar pa profesionalizim të lartë të arsimit. Pra, bashkëpunimi mes arsimit formal, joformal/informal dhe sektorit afarist do të mundësojë inkorporim të nevojave të vërteta të shkathtësive për sipërmarrje në sistemin arsimor¹⁹. Pikërisht ky dimension i interaksionit në mes të arsimit dhe ekonomisë, është konsideruar me të drejtë një rrëfim

¹⁹ Strategjia për mësimin sipërmarrës në Republikën e Maqedonisë 2014-2020, Shkup, 2014

ende i papërfunduar në Maqedoninë e Veriut, sepse të flasësh për një proces dhe ta vendosësh në lëvizje atë, janë dy gjëra të kundërta. Institucionet tona kanë vullnet ta vendosin këtë interaksion, por nuk kanë strategji, dhe mungesa e strategjisë ka bërë që reformat e paralajmëruara për arsimin dual të shkojnë shumë ngadalë.

Shtrohet pyetja: Sa jemi të vetëdijshëm se problematizimi i temave të tilla paraqet në vetvete edhe sfida për të kapur trendet moderne të organizimit dhe planifikimit arsimor e shkencor? Kjo padyshim ndihmon që të kihet një gatishmëri jona për problematikat arsimore, me qëllim që të sigurohen edhe efekte përcjellëse me dijen dhe përvojën e sistemeve arsimore në BE.

Arsimi universitar prek një dimension shumë të rëndësishëm që lidhet me hapjen e universiteteve ndaj shoqërisë dhe tregut të dijeve, si dhe në ofrimin e përvojave ndërkombëtare. Pa këto përpjekje, nuk do të mund të flisnim sot për krijimin e mundësive të barabarta në një mjedis të hapur dhe me perspektivë ndërkombëtare, që këmbëngulë në ballafaqimin krijues në një treg konkurrues vendor, rajonal dhe global arsimor dhe shkencor. Me të drejtë thotë Fichte se “vetëm arsimi mund të na shpëtojë nga të gjitha të këqijat që na shtypin”²⁰. Që të ndodhë kjo nevojitet një qasje strategjike, sipas së cilës “transformimi i arsimit të lartë nuk përbën vetëm detyrim prej ndryshimeve që ndodhin në nivel nacional, por ai është implikim dhe prej ndikimit të së ashtuquajturve faktorë të jashtëm, domethënë globalë, të gjithanshëm, të cilët e përkufizojnë arsimin e lartë dhe në vendet e tjera të botës”²¹.

²⁰ Fichte, Johann Gottlieb. [1808] 1922. *Addresses to the German Nation*. Chicago, IL: The University of Chicago Press, 193

²¹ Programi nacional për zhvillimin e arsimit në Republikën e Maqedonisë 2005 – 2015, Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2006

Të gjitha ngjarjet, zhvillimet arsimore dhe kulturore duhet parë nga këndvështrimi i sotëm, i cili duhet të sintetizojë vizionin dhe dinamikën e një zhvillimi nacional, emancipues dhe kulturor brenda kornizave të një arsimit cilësor evropian. Kjo, para së gjithash lidhet me faktin se vizioni i një populli matet me aftësinë krijuese për të anticipuar vlerat që përbashkojnë të djeshmen me të sotmen dhe të ardhmen. Një kapërcim i kujdesshëm drejt përqaimit të këtyre vlerave nuk do të mund të bëhej pa një kontributin kolosal në sferën arsimit dhe të shkencës.

Efektet e reformave arsimore në Evropë nuk përbëjnë risi në vetvete nëse ato nuk prekin vetëdijen e atyre që duan një shoqëri më iluministe. Por, kjo është e pamundur të ndodhë pa një qasje kreative mbi reformat në arsim, të cilat do të prodhonin në praktikë mirëqenie për të gjithë. Në këtë kontekst, ka tregues të shumtë që thonë se numri i universiteteve është rritur, por studentët kanë më pak gjasa të punësohen se sa kolegët e tyre në BE²². Pikërisht këtu duhet kërkuar edhe roli i universiteteve në përsheptimin e krijimit të një hapësire të përbashkët, pa të cilën nuk do të mund të ndodhte konkurrimi i denjë në hapësirat tjera më të gjera të dijeve, qofshin ato rajonale apo evropiane. Integrimi arsimor është treguesi më real i pjekurisë së një shteti për të marrë mbi vete përgjegjësi e vendime historike, kurse ata që i japin kuptim më të plotë kësaj aspirote integruese janë pikërisht institucionet e arsimit. Roli i arsimit në zhvillimin ekonomik të Maqedonisë së Veriut është i dukshëm, gjë që vihet re edhe nga iniciativat dhe programet e ndryshme të bashkëpunimit me BE-në.

²² Rishikimi i OECD-së mbi evaluimin dhe notimin në Republikën e Maqedonisë së Veriut: vlerësimi dhe rekomandimi - Shkup: UNICEF, 2019.

Duhet pasur parasysh se reformat arsimore në Bashkimin Evropian (BE), gjithnjë kanë bartur dhe bartin me vete porosi dhe kanë mision për t'u dhënë gjeneratave të ardhshme njerëz sa më të kualifikuar me dije dhe kulturë. Ky mision, është i vetmi model i pranueshëm ku do të mund të bashkëjetonin shkëlqyeshëm tendenca evropiane arsimore dhe nevoja imediate e ekonomisë dhe shoqërisë sonë për kuadro të aftë.

Universiteti modern si bashkëdzim përvojash më të avancuara

Shoqëritë që integrojnë në vetvete frymën e reformave arsimore, e kanë më lehtë të mbindërtojnë infrastrukturën e ndryshimeve strukturore që prekin drejtpërdrejt kursin e zhvillimit ekonomik, social e zhvillimor. Thellimi i njohurive për arsimin dhe shkencën nëpër kohë, njëkohësisht do të hapë shtigje të reja për të sotmen dhe të nesërmen e një arsimimi modern të gjeneratave të reja. Këto gjenerata edhe më do të përballen me sfidën e modernizimit dhe të ardhmen e globalizimit. Kështu, do të sigurohet vazhdimësia e popujve, për faktin se arsini i sotëm do të zhvendoset në kufijtë e së nesërmes, duke afirmuar vlerat dhe kontributet e arritura kohët e fundit në fushën e arsimimit.

Që nga viti 2011, Programi i modernizimit të arsimit të lartë²³ ka dhënë udhëzime strategjike për BE-në dhe shtetet anëtare të saj:

- të mbledhë prova për atë që është funksionale në arsimin e lartë (arsim, kërkim, inovacion dhe në formësimin e sistemit), duke

²³ Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions Supporting growth and jobs – an agenda for the modernisation of Europe's higher education systems * COM/2011/0567 final *

kryer studime, punë në grupe ekspertësh dhe analiza e monitormeve të standardeve dhe treguesve;

- të mbështetë bashkëpunimin, mësimin e ndërsjellë dhe konsultimin e përqendruar më politikat e qeverive dhe organeve përgjegjëse për arsimin e lartë;
- të forcojë kapacitetet dhe rezultatet e institucioneve të arsimit të lartë, duke financuar projekte inovative, në kuadër të bashkëpunimit midis institucioneve dhe partnerëve të tyre (Erasmus +, Horizon 2020) dhe, përmes Fondeve strukturore dhe investuese Evropiane (ESIF), duke investuar në infrastrukturë, pajisje, aftësi dhe projekte novatore; Banka evropiane e investimeve gjithashtu ka mbështetur investimet në arsimin e lartë përmes projekteve të saj, duke përfshirë midis tjerash edhe në kuadër të Fondit Evropian për investime strategjike (EFSU),
- të mbështesë lëvizshmërinë ndërkombëtare (mobilitetin) të studentëve, stafit dhe studiuesve, si një mënyrë për të zhvilluar përvojën dhe aftësitë e tyre (Erasmus + dhe aktivitetet “Marie Skłodowska Curie”), si dhe
- të forcojë bashkëpunimin midis arsimit të lartë, hulumtimit dhe biznesit... por, duke u përqendruar në mundësitë dhe sfidat ekzistuese, si dhe ato në zhvillim.

Unikaliteti i dimensionit individual dhe social të të mësuarit është vendimtar për zhvillimin e një shoqërie demokratike, pra, aktive dhe të përgjegjshme, e në kontekst të kësaj edhe kompetenca qytetare sot përbën një nga çështjet më të rëndësishme të të nxënimit. Për më tepër, pistat e kompetencës qytetare kalojnë nëpër të gjitha ciklet arsimore, brenda sferës shoqërore-humanistike, si temë kurikulare që kontribuon në trajnimin e gjeneratave të reja për një rol

aktiv dhe efektiv në shoqëri. Kjo do të thotë se duhet bërë “standardizimi i veprimtarisë në arsimin e lartë sipas kritereve evropiane dhe respektimi i ligjshmërisë gjatë hapjes dhe funksionimit të institucioneve të larta arsimore; rivendosja e autonomisë në universitete, duke përfshirë lirinë akademike dhe parandalimi i mundësive për të ushtruar presion ndaj anëtarëve të komunitetit akademik; zgjerimi i mundësive për arsimimin e të rriturve dhe mbështetja e konceptit për të nxënëit gjatë gjithë jetës”²⁴.

Përpjekjeve titanike për të ngritur një arsim cilësor universitar, duhet t’ua njohim edhe kontributin përmbajtësor në përgatitjen e kuadrove që ishin bartës të procesit reformues. Ky proces, zaten ka qenë i përfshirë edhe në strategjinë e Lisbonës, e cila siguron më tepër aftësi konkurruese në tregun global të punës, por edhe avancim të kohezionit social që herët a vonë do të sjellë të drejtën e barazisë dhe diversitetit.



Reformimi i sistemit arsimor, do të kontribuojë në thellimin e njohurive për arsimin në përgjithësi në Maqedoninë e Veriut, në përpjekje për të hapur shtigje të reja për të sotmen dhe të nesërmen

²⁴ Strategjia për arsim për vitin 2018-2025 dhe Plani i Veprimit, Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2018.

e një arsimimi të bazuar në barazi të plotë të popujve brenda kufijve shtetëror. Edhe në Strategjinë e edukimit të UNESCO-s 2014–2020, shprehet qartë se për një të ardhme të qëndrueshme sistemi i edukimit, politikat zhvillimore dhe reformat në sistemin e edukimit në mbarë botën duhet të zhvillohen duke synuar rritjen e cilësisë së mësimdhënies, dhe rezultateve të të nxëniet, të drejtën e paanshme të përfshirjes në arsimin e lartë dhe në të mësuarit gjatë gjithë jetës, krijimin e aftësive dhe kompetencave që përgatisin gjithsecilin për tregun e punës, përnirësimin dhe zgjerimin e mundësive të shkollimit përmes përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit...

Kur një bashkëpunim ka ne fokus këmbimin e përvojave interaktive dhe shumëdimensionale, atëherë nuk do të mungojnë edhe rezultatet që do të krijonin parakushte për një strategji solide. Institucionet arsimore përmes projekteve konkrete duhet të kenë si qëllim përhapjen e vetëdijes për mënyrën se si të gjithë, si shoqëri dhe individë, mund të ndikojmë ndaj ndryshimeve në arsim. Sot, duhet dhënë prova se çfarë mund të bëhet për të përmbushur kërkesat arsimore në përputhje me nevojat e tregut të punës, me qëllim të arritjes së një zhvillimi të qëndrueshëm në shoqëri. Ekspertët shpesh na e tërheqin vërejtjen se ndryshimet duhet ndodhur tek ne jo diku tjetër. Kështu, kambanat që po bien na bëjnë për të kuptuar por edhe për të menduar, që të punojmë në mënyrë aktive, për ta shpëtuar arsimin.

Mbetet obligim krijimi i institucioneve të qëndrueshme arsimore, të cilat do të përkrahin procedurat dhe praktikat më të mira arsimore të bazuara në standarde dhe vlera, që janë vënë me kohë në zbatim në BE. Ka qasje të shumta që mund të shërbejnë si një nxitje për të ndërtuar partneritete të reja të rëndësishme për nisma të përbashkëta

arsimore e shkencore në të ardhmen... Që nga shfaqjet e para shkencore e deri te zgjidhjet e efektshme e praktike të problemeve, përvijohen rrugëtime të gjata, prandaj duhet përkushtim dhe dije për të pasur një mjedis të qëndrueshëm arsimor. Kjo do të thotë se është e domosdoshme të kihet një bashkëveprim i të gjithë orga- nizmave akademik e shkencor ndëruniversitar, gjithnjë në funksion të përmirësimit të nivelit të përgatitjes së studentëve me dije dhe kulturë të përgjithshme, teorike dhe praktike, moderne.

Shqyrtime përmbyllëse

Strategjitë tona arsimore duhet bazuar në strategjitë evropiane, siç është, bie fjala, Strategjia evropiane për rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse 'Evropa 2020', e cila e vendosë arsimimin dhe aftësimin në qendër të strategjisë për zhvillim dhe forcimin e konkurrencës, duke rritur financimin e arsimit për më shumë se 36% në buxhetin e ri të BE-së për periudhën 2014–2020. Në zbatimin e kësaj kornize strategjike, gjithashtu u krijuan disa nisma të rëndësishme, përfshirë Programin për aftësim dhe vende të reja pune (*An Agenda for new skills and jobs: A European contribution towards full employment*), që nga viti 2010, i cili, veç tjerash, theksonte nevojën e zëvendësimit të profesioneve ekzistuese dhe nivelin e kualifikimeve me llojet e kompetencave të kërkuara nga sektorët dhe profesionet reja.

Ndryshimet e shpejta në tregun e punës, si dhe përgjithësisht në shoqëri, kërkojnë jo vetëm njohuri dhe aftësi të reja profesionale, por edhe përmirësim të kompetencave kryesore që do të mundësojnë adaptim më të shpejtë dhe më të lehtë me këto kërkesa të reja zhvillimore dhe lehtëson punësimin. Fundja, vetëm në këtë mënyrë do të krijohet një sistem i cili do të ofronte mundësi për kualifikime

që do t'ju përgjigjeshin nevojave të popullatës, por edhe përmirësimin të shkallës së punësimit dhe të plotësimit të nevojave të tregut të punës.

Ndihmesa dhe roli i universiteteve në rritjen e përshpejtuar të nivelit arsimor të brezave të rinj, ka një rëndësi të veçantë për faktin se ata do të jenë, para së gjithash kontribuuesit kryesor në zhvillimin demokratik të shoqërisë dhe në zhvillimin e ritmeve të tregut social-ekonomik, në përmbushjen e objektivave kryesore në procesin e integrimit evropian, etj.

Në thelb të një arsimimi funksional, modern dhe në përputhje me standardet e BE-së, është edhe përgatitja e stafit akademik sipas kërkesave e niveleve të zhvillimit të arsimit të lartë, duke ndjekur sistemet konkurruese për nominimin dhe promovimin e profesorëve, bazuar në meritat akademike. Prandaj, mbetet detyrim i pashmangshëm kualifikimi dhe trajnimi sistematik, i organizuar i kuadrit mësimdhënës dhe i hulumtuesve shkencorë në universitete dhe institute të veçanta.

Nevojitet një ndërgjegjësim për një arsim cilësor, i cili do të mund të arrihej vetëm në saje të vlerësimit të drejtë, racional dhe ndërveprues, si në procesin e mësimdhënies, ashtu edhe në atë studimor e kërkimore-shkencor. Sakaq, integrimi i arsimit të lartë, konceptimi dhe zbatimi i tij në një sistem shkencor, duhet të jetë gjithnjë në proces kërkimi, përmirësimi e perfeksionimi me arritje e risi.

Njohja me përvojat dhe problemet në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor për transmetimin e njohurive në fusha e disiplina shkencore dhe profesionale, duhet të ndjekë ritmet e evropiane.

LITERATURA:

Marc Prensky (2010). *Teaching Digital Natives: Partnering for Real Learning*, Corwin A SAGE Company, Thousand Oaks

Dewey, John. [1916] 1997. *Democracy and Education: An Introduction to the Philosophy of Education*. New York: The Free Press

“Të jetojmë së bashku. Të ndërthurim diversitetin dhe lirinë në Evropën e shekullit 21”, Raport i Grupit të personave të shquar të Këshillit të Evropës (http://www.asp.al/pdf/GEP_report_web.pdf). Shikimi i fundit, 01.02.2020

José Manuel Barroso, Raport i Komisionit, *Evropa 2020 – Strategjia për ujë rritje të mençur, qëndrueshëm dhe inkluziv*, Bruksel, 2010

Marija Topuzovska Latkovikj, Mirjana Borota Popovska, Eleonora Serafimovska, Aneta Cekikj, Nita Starova (2019). “*Studim rinor në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2018/2019*”, Friedrich–Ebert–Stiftung, Shkup

“*Strategjia për arsim për vitin 2018–2025 dhe Plani i Veprimt*”, Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2018

“*Strategjia për mësimin sipërmarrës në Republikën e Maqedonisë 2014–2020*”, përgatitur me ndihmën e Fondacionit evropian të trajnimeve, Torino, Itali (Fondacioni evropian i trajnimeve është agjenci e Bashkimit Evropian – BE), Shkup, 2014

Fichte, Johann Gottlieb. [1808] 1922. *Addresses to the German Nation*. Chicago, IL: The University of Chicago Press

“*Programi nacional për zhvillimin e arsimit në Republikën e Maqedonisë 2005 – 2015*”, Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2006

“*Rishikimi i OECD-së mbi evaluimin dhe notimin në Republikën e Maqedonisë së Veriut: vlerësimi dhe rekomandimi*” – Shkup: UNICEF, 2019

Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions Supporting growth and jobs – an agenda for the modernisation of Europe's higher education systems ★ COM/2011/0567 final

AJTEN HAJDARI – QAMILI

Universiteti “Shën Kirili dhe Metodi” – Shkup

SHKAQET QË E PRISHIN CILËSINË E SISTEMIT ARSIMOR

Abstrakt

Eksperimentimi me modele të ndryshme arsimore dhe mospër-shtatja e planprogrameve mësimore të shteteve të zhvilluara me kushtet aspak të mira të shkollave tona, kanë ndikuar negativisht në sistemin arsimor në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Megjithatë, këta dy faktorë nuk janë të vetmit mëkatarë të rrënimt të sistemit tonë arsimor. Janë edhe shumë faktorë të tjerë po aq të rëndësishëm dhe që kanë po aq ndikime negative, sikurse janë: politizimi dhe partizimi i shkollave; presioni i prindërve dhe fryrja e notave nga ana e arsintarëve; mbingarkesa e nxënësve (me orë dhe lëndë mësimore) dhe mbingarkesa e mësimdhënësve (me çështje administrative); konkurrenca jo e drejtë në përpilimin e teksteve shkollore si dhe mungesa e tyre; rënia e standardeve dhe kriterëve të studimit dhe të ngjashme.

Të gjithë këta faktorë, jo vetëm që kanë zbehur misionin e mësuesisë dhe kanë cenuar rëndë bazat e sistemit arsimor, por kanë prodhuar pasoja, antivlera dhe kriza të shumta shoqërore, sikurse janë: prishja e cilësisë; shkalla e lartë e analfabetizimit funksional; humbja e aftësive për vlerësim real, mendim kritik dhe kreativitet të nxënësit–studentit; si dhe prodhimi i kuadrove që nuk posedojnë kompetencat dhe aftësitë të cilat u përshkruhen në diplomat që

kanë. Të gjitha këto na bëjnë shoqëri jokompetente dhe të paafër në hapësirën e gjerë të tregut të punës.

Pedagogë universitarë, sociologë dhe specialistë të fushës ka kohë që kanë dhënë alarmin për këtë gjendje të rëndë, ashtu sikurse ka kohë që janë identifikuar problematikat. Prandaj, u takon institucioneve që krijojnë politika arsimore në krye me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës që të dëgjojnë zërin e ekspertëve dhe të vënë në zbatim rekomandimet e tyre me qëllim të daljes nga kjo situatë.

Fjalë kyçe: prishja e cilësisë, mungesa e mendimit kritik, analfabetizëm funksional, diploma pa meritë

Hyrje

“Kur dikush di dhe e di se di, mëso prej tij.

Kur dikush di dhe nuk e di se di, bëja me dije.

Kur dikush nuk di dhe e di se nuk di, ndihmoje.

Kur dikush nuk di dhe nuk e di se nuk di, largohu prej tij.”

Në këtë kumtesë do të përpiqem të paraqes përsiatjen time rreth një çështjeje tepër brengosëse e që më “dhemb” shumë, gjegjësisht rreth cilësisë së arsimit në RMV. Duke analizuar situatën rreth gjendjes së arsimit, do të përpiqem të ndalem në numërimin e shkaqeve që prishin cilësinë e sistemit arsimor, të cilat i kam identifikuar në dy dekadat e fundit, duke u përpjekur që të jap edhe disa sugjerime, që gjykoj se do të ndihmonin të përmirësohet kjo gjendje.

Do të filloj me atë që mendoj se është fajtori kryesor që prish cilësinë e arsimit, e ai është sistemi politik në përgjithësi i RMV-së,

sidomos i politikave arsimore. Kjo shtyllë që duhet të jetë më e forta dhe më e qëndrueshmja e një shteti, fatkeqësisht në vendin tonë është shtylla më e luhatshme që ndryshon saherë që ndërrohen ministrat, qeveritë dhe preferencat e partive politike ose e individëve të caktuar.

Mos adaptimi i planprogrameve me kushtet e shkollave

Që nga Pavarësia e Maqedonisë (së Veriut) po bëhet tranzicion i vazhdueshëm në arsim duke ndryshuar planprogramet²⁵ dhe duke eksperimentuar me ato pa i analizuar mundësitë, kushtet dhe mendësinë e popullatës sonë. Shumë shpesh ndodh që planprogramet të mos përputhen me metodat, pajisjet, teknikat, për shkak se merren modele të gatshme nga shtete të tjera, me të cilat ne nuk kemi për afri në këto pika. Nuk do të thotë se nëse një planprogram apo sistem i caktuar arsimor ka dhënë rezultate shumë të mira në ndonjë shtet apo krahinë, që po ai planprogram apo sistem arsimor do të jetë i suksesshëm edhe në shtetet e tjera. Këtë gjë e kemi konstatuar shumë herë në RMV. Shumë modele të gatshme që kemi marrë nga shtetet e tjera, këtu te ne kanë dështuar, pasi janë keqpërdorur dhe janë realizuar keq (si: testimi ekstern, sistemi i Kembrixhit²⁶,

²⁵ Asllan Hamiti & Ajten Hajdari-Qamili, **Programi mësimor i gjuhës shqipe në arsimin fillor për nxënësit e bashkësive të tjera etnike në Republikën e Maqedonisë së Veriut**, Konferenca shkencore “Zhvillimet në shkencat e ligjërimit dhe lënda e gjuhës dhe e letërsisë në arsimin parauniversitar”, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 12.06.2019.

²⁶ Mënyra e të menduarit dhe të perceptuarit e gjërave janë shumë ndryshe nga tradita dhe mentaliteti ynë, shumë gjëra janë të pathëna nëpër libra duke ia lënë atë nxënësve të hulumtojnë vetë, por se çfarë të dhënash arrijnë të sigurojnë ata nga interneti dhe familja, sa janë të sakta dhe të plota ato, asnjëherë nuk dihet, sepse nuk ka se ku të verifikohen ato të dhëna. Ende është herët të flitet për rezultatet e këtyre programeve, sepse pak vite janë në zbatim dhe pasojat ende nuk janë shumë të dukshme. (Shih më tepër në: Ajten Qamili 14.02.2017 -

sistemi i Bolonjës etj.). Kjo ndodh, sepse duhet të përshtaten planprogrami me kushtet e jetesës dhe të objekteve shkollore, me pajisjet e shkollës, me mendësinë e popullatës, me nivelin e mësimdhënësve, me të gjitha instancat e politikave arsimore etj. Të gjitha këto hallka të zinxhirit janë të lidhura me njëra-tjetrën. Nëse njëra nga këto këputet apo nuk përputhet, atëherë prishet i tërë zinxhiri. Në vendin tonë nuk përpqemi që një sistem ta modifikojmë e ta përshtasim sipas nevojave tona, por kapërcejmë prej një modeli në model tjetër pa arritur të adaptohemi me asnjërin.

Veç kësaj, ne ende kemi probleme elementare me objektet dhe pajisjet shkollore. Disa fshatra shqiptare as nuk i kanë kushtet elementare për një shkollë, e ne po presim në ato kushte të zbatojmë teknika dhe metoda të marra nga ndonjë shtet shumë i zhvilluar përëndimor. Në Maqedoninë e Veriut ka nivele të ndryshme të shkollave, duke filluar nga shkolla me kushte shumë të mira, deri tek ato me kushte jashtëzakonisht të këqija. Dhe fatkeqësisht numri më i madh i shkollave me kushte minimale, janë shkollat ku mësojnë shqiptarë. Nëse merret një mesatare, mund të thuhet se relativisht ka kushte për t'u realizuar procesi arsimor, por jo në të gjitha segmentet, jo të gjitha njësitë mësimore dhe jo të gjitha metodat interaktive mund të zbatohen në secilën shkollë. Ndërkaq, nëse krahasojmë qytetet, pa i përmendur secilin me emër veç e veç, mund të them se kjo lidhet ngushtë me politikën ditore, sepse qytetet që kanë pasur kryetar komune person të partisë në qeveri, ka pasur më shumë mjete financiare nga buxheti i shtetit dhe ka pasur mundësi të përmirësojë kushtet e shkollave. Në anën tjetër, shkollat e qyteteve ku kryetari i komunës nuk ka qenë pjesë e

partisë në qeveri ose kryetari nuk ka qenë shqiptar, po ashtu edhe në qytetet ku shqiptarët janë më pak në numër (si Velesi e Manastiri), shumë qartazi vërehet se janë diskriminuar në çdo aspekt, sidomos në aspekt financiar²⁷.

Politizimi

Një plagë më vete dhe shumë e thellë që e “ha” arsimin nga brenda si kancer, është punësimi partiak dhe jo sipas cilësisë. Shumë shpesh ndodh që mësimitdhënësit, të cilët punësohen përmes partisë të mos e kenë dëshmuar veten gjatë shkollimit të tyre dhe gjatë studimeve. E si mund të përhapë dije, ai që nuk di për vete dhe që mezi ka marrë një diplomë?! Si mund të ndërtohet një kështjellë nëse themelet dhe tjegullat janë baltë e butë dhe e qullët?! Si mund ta ndërtojme ne shtyllën kryesore të shoqërisë – arsimin – me kuadro jociësore?! Një mësimitdhënësi i dobët dëmton gjenerata të tëra.

PISA 2012-2015

Republika e Maqedonisë merr pjesë
në disa studime ndërkombëtare:

1. TIMSS – viti 1999, 2003 dhe viti 2011.
2. PIRLS - viti 2001 dhe 2006.
3. PISA – viti 2000 dhe 2012 -15.

²⁷ Gazeta KOHA, Ndryshe me Ajtene Qamili profesoreshë, **Jemi në fazë të diplomomanisë, masteromanisë**, 10.11.2017 (e premtë), f. 12-13.

Faktor tjetër që ndikon në prishjen e cilësisë së arsimit është notimi joreal (i fryrë) i nxënësve dhe studentëve. Mesatarja e suksesit në përgjithësi është shumë e lartë, kurse dija reale e nxënësve dhe e studentëve është shumë e ulët. Kjo u dëshmuua edhe me vlerësimin e OECD-së ku nga 79 vende të botës RMV u radhit e 67-ta në listë²⁸. Gabimi më i madh është se te ne vlerësohen notat (numrat) dhe jo dija reale. Në këtë mënyrë ne prodhojmë kuadro që mendojnë se dinë, por në të vërtetë nuk dinë asgjë. Secili vrapon të marrë nota të mira pa meritë, që të mund të regjistrohet në fakultetin që dëshiron, pastaj që të mund të magjistrojë, që të marrë bursë e kështu me radhë duke u ngjitur nëpër pozicione gjithnjë e më të larta në shoqëri, duke bërë deri karrierë akademike apo edhe duke zënë majat më të larta të funksioneve shtetërore e gjtëkë.

Presioni i prindërve

Prindërit detyrojnë fëmijët të sjellin nota të larta, nxënësit dhe studentët lusin mësimitdhënësit për t'ua falur notat; e nëse kjo nuk ka sukses, atëherë prindërit detyrojnë mësimitdhënësit të falin nota dhe ky qark vazhdon e përsëritet pa ndalur. Kjo dukuri ndikon që të demotivohen ata që vërtet mësojnë dhe japin mund. Kështu përzihet vlera me antivlerën. Në anën tjetër, ka një diskrepancë të madhe të vlerësimit mes shkollave njëra me tjetrën, mes qyteteve, mes fshatrave, mes fshat – qytet etj. Më pas rangimi i tyre për në universitet nuk është real, sepse nuk vlerësohet dija, por notat. Nota 5 e një shkolle apo qyteti, mund të jetë e barabartë me notën 2 apo 3 të një shkolle tjetër e kështu me radhë.

²⁸ Rezultate të shpallura në 03. 12. 2019 nga hulumtimi i kryer nga OECD me 79 vende të botës, ku RMV zinte vendin e 67, Shqipëria e 61-ta, Kosova e 75-ta, Kina e 1-ra. Shih më tepër në: <https://youtu.be/KYh2pRD3t7I>

Një vorbull që e përpin dhe e fundos cilësinë e arsimit në RMV është numri i madh i universiteteve në përpjesëtim me numrin e banorëve në vend, konkurrenca e padrejtë mes universiteteve dhe mundësia e studimit të secilit njeri pa pasur ndonjë kriter universal për suksesin e shkollimit paraparak dhe moshën. Gjithashtu, mundësia e studimit me korrespondencë (disa nga këta studentë as nuk e meritojnë diplomën), shkollat e mesme me korrespondencë që kryhen brenda natës, universitetet private që “shesin” diploma etj. të gjitha këto nuk lejojnë që cilësia të dalë në pah dhe të lulëzojë. Këtu duhet shtuar edhe lejimi apo mundësia e secilit njeri të magjistrojë dhe të doktorojë, edhe nëse nuk ka mesatare të lartë gjatë studimeve. Kurse në disa fakultete që kërkohet domosdoshmërisht mesatarja e lartë, jepet mundësi që pas disa vitesh të diplomuar, të jepen rishtaz disa provime (riprovim) që të mund të rritet mesatarja.

Por ende më paradoksale është mundësia e magjistrimit në fakultet dhe drejtim krejtësisht ndryshe nga fakulteti i kryer!!? Je jurist magjistrosh në ekonomi, je gjuhëtar magjistrosh në studime europiane, je mësues parashkollor magjistrosh në filozofi etj. Me diploma të këtilla nuk mund të punësohesh askund, vetëm e mashtrojmë vetëveten, ua mbushim xhepat pronarëve të universiteteve dhe e rrisim numrin e masterave në vend. Masteromania është bërë sëmundje shumë e përhapur në Ballkan. E ç’të duhet diploma e masterit, kur nuk të hyn në punë?! Ç’të duhet diploma e masterit, kur nuk ke fare njohuri rreth asaj që ke “hulumtuar”?!

Konkurrenca jo e drejtë

Më sipër përmenda planprogramet e arsimit fillor dhe të mesëm, por nuk mund të lëmë pa përmendur edhe programet e arsimit të lartë, si p.sh. programet studimore 3+2 që detyrojnë secilin të

magjistrojë, që në anën tjetër dëmtojnë dhe u bëjnë konkurrencë jo të drejtë programeve studimore 4+1. Po ashtu, duhet cekur se sistemi i Bolonjës me lëndët me zgjedhje dhe njësemestrare, po nxjerr kuadro të gjymtuara në dije. Vetë fjala lëndë me zgjedhje e ul vlerën dhe rëndësinë e disa lëndëve.

Botimi i librave, përmes furnizimeve publike që shpesh bëhen për përfitime personale dhe manipulimet e pazarllëqet që bëhen me autorët, përkthyesit, recensentët, shtëpitë botuese etj., ka krijuar që tekstet shkollore të arsimit fillor dhe të mesëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut të mos jenë në cilësinë dhe nivelin që dëshirojmë, sepse ka gabime edhe gjuhësore (fonetike, morfologjike, leksikore, sintaksore), por edhe teknike, përmbajtësore e logjike. Kjo ndodh, sepse punët tona bëhen me ngut dhe jo gjithmonë me njerëz të specializuar për detyrën që e kryejnë. Këto gabime ndikojnë negativisht në nxënien, së pari të shqipes standarde, por edhe në cilësinë e arsimit, në përgjithësi, prandaj duhet të korrigjohen e të mos lejohet që në të ardhmen të përsëriten.²⁹ Meqenëse teksti shkollor është burim i diturisë dhe mjetei mësimor i formësuar në pikëpamje didaktike për arritjen e qëllimeve edukative–arsimore në mësim dhe nxënie, ai duhet t’i mundësojë nxënësit që të arrijë standarde të caktuara njohurish dhe ta nxisë zhvillimin e aftësive: në *fushën kognitive* për të kuptuar, për të zbatuar njohuritë, për të analizuar e sintetizuar; në *fushën afektive* për të zhvilluar aftësitë e pranimit dhe të përvetësimit të vlerave dhe si pikësynim kryesor – formimin e personalitetit; dhe në *fushën psikomotorike* për të

²⁹ Shih më tepër në: Ajten Hajdari-Qamili, **Niveli gjuhësor në tekstet shkollore të arsimit fillor në RMV**, Konferenca e parë shkencore: Shqiptarët, shkollat, programet mësimore dhe tekstet shkollore në gjuhën shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Organizata joqeveritare “Nisma”, Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, 15.06.2019. u botua në 2020, f. 19 – 30.

përvetësuar shkathtësi, nxitur të menduarit dhe për të jetësuar në praktikë njohuritë e fituara.³⁰

Procesi i hartimit të librit është një varg zinxhiror që varet nga secila hallkë e saj (Ministrisë së Arsimit, autorit, përkthyesit, redaktorëve, recensentëve, lektorit, korrektorit, ilustruesit, përpunuesit teknik, botuesit etj.), prandaj që të gjithë duhet punën e vet ta kryejnë me përgjegjësi dhe përkushtimin maksimal. Nëse vetëm njëra nga këta nuk e bën punën si duhet, atëherë libri del me të meta dhe mangësi të ndryshme.³¹

Zbehja e misionit të mësuesisë

Nëse në shoqërinë tonë e analizojmë konceptin e mësuesisë midis dy paradigmeve: mision apo profesion, do të konstatojmë se misioni ka mbetur në mendësinë dhe synimin e fare pak njerëzve. Dikur në kohët e mbretërive ilire, greke, romake etj., mësimdhënësi ishte një kult shumë i çmuar i dijes. Mësuesi kishte mision të edukojë dhe arsimojë, fillimisht fëmijët e mbretërve, pastaj edhe të tjerët. Respekti që gëzonte mësuesi, ishte kulminant. Me kalimin e shekujve ky respekt është zbehur. Kurse sot ky kult është shkelur edhe nëpërkëmbur nga të gjitha anët: nga nxënësit, nga prindërit, nga shteti dhe nga vetë mësimdhënësit.

Mjerisht, sot mësuesia shihet vetëm si profesion, i cili është jofitimprurës, si një punë pa përgjegjësi, një punë e lehtë, një punë sa për të marrë një rrogë e sa për të pasur vendim që do t'u sigurojë pension. Pagat e ulëta në arsim kanë ndikuar që këtë profesion ta

³⁰ Ministria e Arsimit dhe e Shkencës e R. së Maqedonisë, Byroja e Zhvillimit të Arsimit, Koncepti për tekst shkollor të arsimit fillor dhe të mesëm, Shkup, maj, 2006, f. 7.

³¹ Gazeta KOHA, Ndryshe me Ajtene Qamili profesoreshë, Jemi në fazë të diplomomanisë, masteromanisë, 10.11.2017 (e premtë), f. 12-13.

zgjedhin jo gjithmonë nxënësit më të mirë e me ambicie të larta; pastaj ka ndikuar që një numër të mësimdhënësve të detyrohen të mbajnë punë të dytë apo të tretë për të siguruar të ardhura të mjaftueshme për familjen. Kjo shkakton që përkushtimi psikik dhe fizik i mësimdhënësit të përgjysmohet dhe të mos arrihet cilësia e duhur në mësim. Në ditët e sotme ka shumë prindër të pandërgjegjshëm, që i stërpërkëdhelin dhe lazdrojnë fëmijët e tyre, të cilët bëhen nxënës përtacë, pa edukatë themelore, pa ndërgjegje, pa vlera morale dhe etike, ku sundojnë gënjeshttrat, aktrimet, manipulimet, shantazhet dhe korrupsioni, prandaj zvetënohet imazhi i mësuesit, reputacioni në shoqëri dhe motivimi për punë me sakrificë nga ana e mësimdhënësve.

Mbingarkesa

Me ndryshimin e vazhdueshëm të ligjit për arsim dhe të sistemeve arsimore, arriti puna që mësimdhënësit dhe nxënësit të mbingarkohen me më shumë punë dhe përgjegjësi, duke i mbajtur paralelisht dy forma të evidentimit (atë elektronik dhe atë në letër). Natyrisht se mbingarkesa me orë dhe lëndë, përveç asaj administrative, sjell në çrregullim të shumë segmenteve të procesit mësimor, me ç'rast krijohet një hamulli e madhe, sepse mësimdhënësit shndërrohen në robotë të gjithëdijsëm. Lodhja e mësimdhënësve dhe e nxënësve ndikon në cilësi të ulët të ligjërimit dhe mësimnxënies, nga kjo dobësohet përqendrimi; kontrollimi i të arriturave të nxënësve nuk mund të mbërrihet për shkak të numrit të madh të nxënësve dhe kohës së shkurtër të vlerësimit; zhurma dhe mungesa e oksigjenit në një klasë të ngushtë me 40 nxënës ndikojnë nega-

tivisht në zhvillimin psikik dhe psikofizik të nxënësve³². Prandaj, duhet t'i hiqen disa barra edhe mësimdhënësit, edhe nxënësit.

Analfabetizmi funksional

Në këtë epokë digjitale që jemi, përpos përfitimeve dhe dobive të shumta që kemi nga teknologjia, kemi edhe disavantazhe që dëmtojnë thellë cilësinë e arsimit. Nxënësit dhe studentët po keqpërdorin internetin, konkretisht: *google classroomin* (njësitë mësimore që plasohen aty shfrytëzohen për kopjim, në vend që të mësohen librat), punimet e seminarit dhe esetë merren të gatshme nga interneti, sepse mungon mendimi kritik i nxënësve dhe studentëve. Në ditët e sotme është shumë i pranishëm *analfabetizmi funksional*. Kjo nënkupton se kjo kategori njerëzish dinë të lexojnë, por nuk janë në gjendje ta vënë në zbatim atë që kanë mësuar, gjegjësisht shndërrohen në robotë që i kryejnë disa funksione, por nuk i kuptojnë as ata vetë se çfarë janë duke bërë.



Kreativiteti, aftësitë kërkimore e hulumtuese, dëshira dhe vullneti për të lexuar dhe shprehia e punës te rinia e sotme është zvetënuar plotësisht. Fatkeqësisht një numër i vogël i atyre që vërtet janë me

³² Po aty.

kapacitet të lartë mendor, me inteligjencë dhe kanë dëshirë e vullnet për të punuar, demotivohen nga kjo dukuri që po i rrethon, por edhe nga perspektiva e pasigurt drejt të cilës synojnë ata.³³ Analfabetizmi funksional shfaqet në të gjitha vendet e botës, por diku më shumë e diku më pak. Një raport i fundit i Bankës Botërore ka dalë me rezultatin tronditës se 57% e 15-vjeçarëve në Shqipëri janë analfabetë funksionalë. Shqetësues është fakti se sipas të dhënave statistikore të këtij institucioni, Shqipëria radhitet në 3–4 vendet e fundit, me analfabetizëm modern shumë të lartë. Meqë në Shqipëri, pra në shtetin që në nivel të vendeve të Ballkanit ka një sistem shkollimi shumë më solid, atëherë çfarë duhet të themi për nivelin e analfabetizmit funksional në Maqedoninë e Veriut?!

Kultura gjuhësore dhe globalizimi

Nga sa shohim e dëgjojmë çdo ditë, por edhe nga përvoja jonë si pedagogë universitarë, me keqardhje mund të themi se përgjithësisht niveli i kulturës gjuhësore te të rinjtë shqiptarë është jo i kënaqshëm: shumë nxënës të filloreve e të shkollave të mesme nuk dinë t'i shprehin mendimet e veta as me shkrim e as me gojë, por edhe atë që e lexojnë nuk janë në gjendje ta riprodhkojnë. Ky analfabetizëm funksional, kjo paaftësi e tyre në shkrim–leximin me kuptim vërehet shpesh edhe te studentët. Fjala vjen, në provimet me shkrim a me gojë ata po përgjigjen vetëm duke i mbetur besnik me përpikëri tekstit mësimor, në të shumtën e rasteve duke e mësuar përmendësh ose duke e kopjuar. Rrallëherë lexojnë përgjigje origjinale me fjali që nuk janë kopje e tekstit. Rrjedhimisht, mund të përfundohet se te adoleshentët shqiptarë në Maqedoninë e Veriut

³³ Po aty.

kemi analfabetizëm funksional, që mund të supozojmë se sillet prej 30–50%.³⁴

Në cilësinë e dobët të përdorimit të shqipes standarde nga nxënësit dhe studentët e sotëm rol të rëndësishëm ka luajtur edhe procesi i globalizimit. Ky proces (që nga forcat e mëdha çmohet si shumë i rëndësishëm për zhvillimin e tregut të lirë dhe për shoqërinë e hapur, për zbatimin e parimeve të demokracisë dhe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në përpjesëtime botërore), po bëhet rrezik për kulturat dhe gjuhët kombëtare. Ndikimi i gjuhëve të mëdha në gjuhët e vogla edhe deri më tani ka qenë i madh. Por, me procesin e globalizimit, gjuhët e popujve të vegjël janë edhe më të rrezikuara. Anglishtja është bërë dhe si duket do të jetë edhe mëtej gjuhë me prestigjin më të lartë në botë. Ajo edhe tani si gjuhë zyrtare ose gjysmëzyrtare përdoret në më shumë se 60 shtete, kurse vend të posaçëm zë edhe në 20 vende të tjera. E gjithë bota e kulturuar kujdeset të mësojë anglishten; nga sasia e përgjithshme e informatave në kujtesën e sistemeve elektronike, 80% janë në anglisht. Në ndikimin e anglishtes shkombëzohen gjuhë amtare. Mund të parashikohet se me globalizimin e botës, në dy shekujt e ardhshëm do të vdesin gjysma e gjuhëve të popujve të vegjël³⁵.

Siç mund të vërehet nga gjithë ajo që u tha deri tani, mund të konstatohet se ka shumë faktorë që prishin cilësinë e arsimit në RMV, por ne nuk duhet të rrimë duarkryq e të vëzhgojmë, përkundrazi duhet sa më parë të ndër marrim masat mbrojtëse. Arsimin duhet ta shohim nga prizmi i idealit kombëtar, sepse të parët tanë kanë derdhur gjak për të e ne duhet ta mbrojmë me djersë. Para se

³⁴ Asllan Hamiti, *Kultura e gjuhës për të gjithë*, Sak-Stil, Shkup, 2018, f. 243-247.

³⁵ Rexhep Qosja, *Kongresi i Drejtshkrimit – tridhjetë vjet pas*, Studime filologjike nr. 3-4, 2002, Tiranë, f. 31-36

të jap disa rekomandime që mendoj se mund të jenë të dobishme në këtë çështje, do ta përmbyll shtjellimin e kumtesës, ashtu siç e nisa, me një fjalë të urtë popullore: “*Nëse do që ta shkatërrosh një popull, prishja arsimin, atëherë ai popull është i shkatërruar dhe i dëmtuar në të gjitha rrafshet.*”

Rekomandime:

1. Të sistematizohen nxënësit sipas aftësive dhe shkathtësive: qysh në shkollë fillore varësisht nga aftësitë dhe shkathtësitë që kanë të klasifikohen në drejtime dhe zanate, që të mos kemi hiperproduksion të disa profileve, prej të cilëve 70% nuk janë në gjendje të kryejnë profesionin ashtu si duhet; e në anën tjetër, të kemi mungesë kuadroshe në disa profile dhe zanate, për të cilat kemi shumë nevojë.³⁶

2. Të shkarkohen mësimdhënësit dhe nxënësit nga disa detyrime dhe përgjegjësi që mbingarkojnë ata, megjithëkëtë gjithnjë duhet pasur parasysh që nuk duhet të tejkalohen caqet e shkarkimeve që të mos prodhojnë pastaj gjenerata përtacësh. Në këtë sferë duhet të bëhen më shumë përpjekje, analiza, parashikime dhe strategji të kolauduara, prandaj duhet të rishikohen ligji, rregulloret, planprogramet, metodat e punës, librat, të bëhet vlerësimi (evaluimi) real i brendshëm dhe i jashtëm, por të mos bëhet me dënime, siç ishte deri para pak kohe³⁷.

3. Të motivohen nxënësit dhe mësimdhënësit, sepse për të arritur sukses në ngritjen profesionale, njeriu duhet të jetë i motivuar: a) të garantohet punësimi i rinisë, duke bashkëpunuar shkollat e mesme

³⁶ <https://youtu.be/KYh2pRD3t7I>

³⁷ <https://wetransfer.com/downloads/fe785d938ab0f4350f0e11d04491e39520200312202901/87ff55564220805a7d0d5ac6a99760ce20200312202901/577a1d>

profesionale ose fakultetet me ndërmarrjet publike dhe të gjitha institucionet në vend, b) të rriten pagat e mësimit në të gjitha nivelet e arsimit.

4. Prindërit duhet të kujdesen më shumë për fëmijët e tyre. Rëndom, ne i gëzohemi vetëm rastit kur fëmija jonë regjistrohet në shkollë, në klasën e parë dhe nuk mungon edhe interesimi ynë për punën e tij deri sa të mësojë të shkruajë e të lexojë, ndërsa në klasat e mëvonshme interesimi ynë zvogëlohet ose shuhet krejtësisht. Prindërit merren vetëm me punët e përditshme të mbijetesës, ndërsa për arsimimin dhe edukimin e fëmijëve nuk çajne kokën. Fëmija duhet të jetë gjithnjë nën përkujdesjen e prindit: A shkon në shkollë?, Kur shkon e kur kthehet?, Çfarë sjelljesh e çfarë edukate ka? A lexon, çka e sa lexon? A i bën detyrat? Si e kalon kohën e lirë? Kur zgjohet e kur fle? Sa kohë qëndron në internet? Çka shfrytëzon nga rrjeti i internetit? etj.³⁸

5. Mësimit duhet të punojnë me përkushtim më të madh, me më shumë zell dhe me metoda ndërvepruese (interaktive). Në orët e gjuhës amtare të shmanget mësimi skolastik, të mos kërkohet nga nxënësit vetëm që të riprodhojnë atë që e dëgjojnë ose e lexojnë, por të kërkohet nga ta të flasin e të shkruajnë me një originalitet, stil dhe kreativitet. Mësimi i të gjitha lëndëve të vihet në funksionin e zbatimit praktik në jetën e përditshme. Nxënësit të nxiten që të lexojnë sa më shumë libra. Ata të motivohen të thonë atë që mendojnë (qoftë edhe gabimisht), duke mbështetur e argumentuar mendimin, të kuptojnë atë që kanë lexuar a dëgjuar si dhe të kenë qëndrim vlerësues e kritik ndaj tyre. Mësimit duhet të jep për nxënësit duhet të jetë i matur, i drejtë, jofyes.

³⁸ Asllan Hamiti, *Kultura e gjuhës për të gjithë*, Sak-Stil, Shkup, 2018, f. 243-247.

6. Gjatë punësimeve nëpër shkolla të sundojë meritokracia dhe jo punësimet partiake.
7. Të bëhen inspektive sistematike dhe reale. Nuk ka nevojë të gjobiten mësimdhënësit, por t'u tërhiqet vërejtje, të bëhen këshillime dhe seminare (trajnime) për përmirësimin e mangësive të tyre, kurse ata që e kryejnë punën me sukses të shpërblehen.
8. Testimi shtetëror për të marrë vendimin si mësimdhënës të jetë realisht i vlerësuar dhe jo vetëm formalisht.
9. Të formohen grupe punuese në kuadër të Byrosë për Zhvillimin e Arsimit për të hartuar strategji dhe ndarje të detyrave. Këto grupe punuese do ta kenë barrën më të madhe të planifikimit afatgjatë të të gjitha strategjive. Për këtë arsye, në këto grupe punuese duhet të angazhohen njerëzit më të suksesshëm në këtë fushë.

REFERENCA:

Ajten Hajdari – Qamili, *Perla gjuhësore*, SAK STIL, Shkup, 2018.

Ajten Hajdari – Qamili, *Niveli gjuhësor në tekstet shkollore të arsimit fillor në RMV*, Konferenca e parë shkencore: Shqiptarët, shkollat, programet mësimore dhe tekstet në gjuhën shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Organizata joqeveritare “Nisma”, Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, 15.06.2019. u botua ne 2020, f. 19 – 30.

Asllan Hamiti, *Gjuha e teksteve shkollore të kimsë të arsimit fillor në Maqedoni*, Seminari V Ndërkombëtar i Albanologjisë, 3–4. 10.2011, Tetovë – Shkup, f. 47–51.

Asllan Hamiti, *Kultura e gjuhës për të gjithë*, SAK STIL, Shkup, 2018.

Asllan Hamitin & Ajten Hajdari – Qamili, *Programi mësimor i gjuhës shqipe në arsimin fillor për nxënësit e bashkësive të tjera etnike në Republikën e Maqedonisë së Veriut*, Konferenca shkencore “Zhvillimet në shkencat e ligjërimit dhe lënda e

gjuhës dhe e letërsisë në arsimin parauniversitar”, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 12. 06.2019.

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës e R. së Maqedonisë, Byroja e Zhvillimit të Arsimit, *Konceptioni për tekst shkollor të arsimit fillor dhe të mesëm*, Shkup, maj, 2006.

Rexhep Qosja, *Kongresi i Drejtshkrimit – tridhjetë vjet pas*, Studime filologjike nr. 3–4, 2002, Tiranë

Deklarata që kam dhënë unë në media të ndryshme për këtë çështje:

<https://www.facebook.com/289839541067084/posts/3040213716029639/>

<https://www.facebook.com/AlsatMTTelevision/videos/199068451440059/?vh=e>

<http://portalb.mk/375268-dy-dekada-reformim-te-pasuksesshem-te-sistemit-arsimor-shqiptaret-mbeten-ne-vendnumero/>

<https://www.facebook.com/radiokosova1/videos/1125854260957605/UzpfSTY1MTg2NTI0NzoxMDE1NjQ4MzA3NzA0NTI0OA/>

<https://www.youtube.com/watch?v=W1SyyUpIhkM&feature=share>

<https://wetransfer.com/downloads/fe785d938ab0f4350f0e11d04491e39520200312202901/87ff55564220805a7d0d5ac6a99760ce20200312202901/577a1d>

<https://youtu.be/KYh2pRD3t7I>

Gazeta KOHA, *Ndryshe me Ajtene Qamili profesoreshë, Jemi në fazë të diplomomanisë, masteromanisë*, 10.11.2017 (e premte), f. 12–13.

AVNI AVDIU

Universiteti “Nënë Tereza” – Shkup

ME SLOGANIN “*REFORMA NË ARSIM*” – PREJ UTOPISË DREJT REALITETIT TË MUNDSHËM

Abstrakt

Me sfidat arsimore përballen të gjitha shoqëritë dhe shtetet pavarësisht zhvillimit të tyre. Janë bërë studime e hulumtime të shumta, janë shkruar libra, janë organizuar tribuna, seminare e konferenca shkencore, janë krijuar lëndë që merren enkas me këtë problematikë (për shembull Sociologjia e arsimit) dhe mbetet çdo herë aktual debati për dilemën e madhe: Ç’duhet bërë për arsim sa më cilësor? Kjo është temë madhore për të gjithë, ngaqë një shoqëri e shëndoshë varet kryekëput nga cilësia e arsimit. Arsimimi i dobët dhe jocilësor bën që gjithçka të rrjedhë mbrapshtë. Humbin vlerat, meritokracia, ngec zhvillimi, dalin probleme të ndryshme dhe të paparashikueshme.

Trajtimi i kësaj çështje synon të hedhë dritë mbi burimet, arsyet dhe shkaqet e problemeve me të cilat ballafaqohet arsimi, si dhe gjetjen e mundësive për daljen nga labirinti dhe tejkalimin e sfidave.

Konsideroj se konkluzionet dhe përfundimet që do të nxirren nga ky punim, mund të shërbejnë si burim i nevojshëm për thellimin dhe vazhdimin e shtjellimit më të thellë e më të gjerë të kësaj çështjeje nga studiuesi të tjerë. Po ashtu mund të jetë edhe bazë

pikënisjeje për strukturat vendimmarrëse për t’i detektuar të metat dhe për të ndërmarrë masa për t’i sanuar pasojat e gjertanishme po edhe për t’i gjetur mënyrat e zgjidhjes më të mirë të kësaj problematike. Metodologjia: Krahas shfrytëzimit të literaturës dhe të dhënave empirike, punime do të sjell edhe përvojën e drejt-përdrejtë në proceset edukativo arsimore nga cilësia e pedagogut universitar.

Fjalë kyçe: arsimi, problem, zgjidhje, utopi, realitet

Hyrje

Arsimi dhe edukimi nuk janë vetëm probleme lokale, por para së gjithash e mbi të gjitha janë probleme globale³⁹. Ato ndryshojnë nga vendi në vend, varësisht prej kushteve, rrethanave dhe nivelit zhvillimor. Është pra afërmendsh se arsimimi në vendet e zhvilluara nuk mund të krahasohet me atë në vendet e prapambetura. Ndërkaq me zhvillim nënkuptojmë në veçanti zhvillimin ekonomik. Në këtë kontekst është i kapshëm slogani i Marksit se “infrastruktura përcakton superstrukturën”.

Në vendet e Evropës Juglindore, veçanërisht në ato të ish-blokut socialist të cilat përnjëherë e ndërruan sistemin politik, arsimi pësoi goditje të rënda, pasi kaluan nëpër periudha të stërzgjatura të tranzicionit, madje disa shtete nuk e kanë përmbyllur ende këtë

³⁹ Raporti i UNESCO-s “Arsim për të gjithë” që u paraqit në janar të 2014 në kryeqyteti etiopian Adis Abeba, tregoi se 57 milionë fëmijë në mbarë botën nuk shkojnë në shkollë. 774 milionë të rritur në mbarë botën janë analfabetë. Të prekura më shpesh janë gratë dhe vajzat në zonat rurale dhe në vendet në zhvillim... January 29, 2014 / <https://kumti.com/unesco-paralajmerim-per-krize-globale-ne-arsim/>

proces. Tranzicioni pati ndikimin e vet të jashtëzakonshëm në sistemin arsimor. Kalimi nga sistemi arsimor i mëparshëm në sistemin e ri ndodhi shpejtë dhe pa ndonjë studim të mirëfilltë paraprak. Ballkani, e posaçërisht viset shqiptare, u përballën me një mori problemesh të karakterit politik, ekonomik e shoqëror. Të gjitha këto ndikuan që çështja e arsimit të anashkalohet, spostohet dhe asnjëherë të mos vendoset në agjendën e prioriteteve. Përskaj kësaj, pushtetet e deri tanishme e etabluan dhe e instaluan logjikën sipërfaqësore të formalitetit, falsitetit dhe të kamuflimit, me ç'rast eksponentë të caktuar politikë e përdorën arsimin për efekte propagandistike në momente të ndryshme (posaçërisht parazgjedhore), varësisht prej diktimit të interesave të tyre. Në këtë mënyrë slogani i tyre *reforma në arsim*, është bërë aq monoton sa ka humbur edhe kuptimin e mirëfilltë.

Dëshirat, mundësitë dhe realiteti

Shkërmoqja e ish-sistemit të kaluar monist, pa dyshim pati pasoja në të gjitha fushat e jetës, përfshirë edhe atë në sferën e arsimit. Ndërrimi i sistemit politik imponoi edhe nevojën e ndryshimit të tërësishëm të mendësisë, qasjes dhe metodologjisë arsimore. Lipsej të bëhej ndërrimi i teksteve, mënyra e shpjegimit dhe metodat e nxënies së tyre. Një ndërmarrje madhore, e shumanshme dhe me përmasa të thella e të gjera angazhimi. Në të njëjtën kohë shtetet, të cilat kalonin nëpër kapërcyellin e transformimeve të mëdha politike, ekonomike e shoqërore nuk kishin kapacitete të mjaftueshme që as për së afërmi të merren me cilësinë e duhur që kërkohej në arsim.



Ndërrimi i teksteve kërkonte kuadër profesionistësh, qofshin vetëm edhe përkthyes (e jo hartues) ngaqë secilin tekst të çdo fushë shkencore nuk mund ta përkthej një përkthyes i rëndomtë. Nevojiten specialist dhe njohës profesional të gjuhës së caktuar. Sa për ilustrim janë paraqitur gabime trashanike konceptuale si bie fjala, në tekstet e përkthyer nga gjuha angleze të fizikës në vend të “*fusha magnetike*” është përkthyer “*arat magnetike*” në vend të “*i jep qëllime!*”, është përkthyer “*i dhanë gola!*”, e kështu me radhë. Po ashtu librat e lëndëve të tjera përmbajnë gabime të rënda, për të cilat shpesh raportojnë edhe mediat e shkruara dhe ato elektronike. Kjo flet për faktin se hartuesit dhe përkthyesit e teksteve shkollore kanë qenë të papërgatitur për punën për të cilën janë ngarkuar. Futja e teksteve të Kembrixhit si dëshirë është e mirëseardhur, por propozuesit e kësaj ideje nuk kanë pasur parasysh shumë gjëra, përfshirë këtu edhe përkthimin adekuat të atyre teksteve. Këto tekste po ashtu kërkojnë edhe kushte e rrethana të tjera shpjegimi, por edhe nxënie. Në vendet perëndimore nxënësit rrinë pothuajse tërë ditën në shkollë, kurse mënyra e sqarimit të teksteve është më tepër praktike, gjë që lehtëson nxënien e tyre teorike. Sa për

ilustrim aq shumë janë të ngarkuar me mësimë nxënësit, sa edhe po të ishin gjeni nuk do t'ia dilnin dot vetë pa ndihmën e prindërve. Çanta e tyre është e stërngarkuar, e që në jo pak raste ka shkaktuar deri edhe deformime trupore të nxënësve.

Pasi koha e qëndrimit në shkollë nuk mjafton për të ezauruar gjithë materialet e caktuara me programin mësimor, mësuesit dhe arsimtarët i ngarkojnë nxënësit me detyra të shumta shtëpie. Për zgjidhjen e atyre detyrave në shtëpi (nga lëndët: shqip, matematikë, anglisht, maqedonisht, bazat e arsimit teknik, shkencë etj.) duhet të angazhohen familjarët tjerë, madje edhe dy-tre të rritur. Pra logjikisht, gënjejnë veten nëse mendojmë se në shkollat tona mësohet me tekste të Kembrixhit, sepse ato tekste kërkojnë edhe kushte të Kembrixhit! Dorën në zemër dëshira është shumë e mirë, por kur rrethanat reale nuk mundësojnë realizimin e tyre, atëherë dëshirat bëhen utopike. Duke mos i bërë llogaritjet mirë, pra duke mos bërë studime paraprake për implementimin e atyre planprogrameve, nxënësit tanë kanë marrë vlerësimet më të dobëta në testimet PISA-s (Programit për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve), se 80% të 15 vjeçarëve janë analfabetë funksional, pra dinë të lexojnë e të shkruajnë, por jo edhe t'i kuptojnë mirë tekstet që i lexojnë e shkruajnë⁴⁰.

⁴⁰ Banka Botërore sugjeron se shkollat dhe mësuesit duhet t'i përgatisin studentët me aftësi së paku në lexim dhe shkrim. Nxënësit duhet të jenë në gjendje të interpretojnë informacione, të formojnë mendime, të jenë krijues, të komunikojnë mirë, të bashkëpunojnë dhe të jenë elastikë. Përvoja ka treguar se kriza e arsimit është, në thelbin e saj, një krizë mësimore. Nxënësit që duan të mësojnë kanë nevojë për një mësues të mirë, por shumë sisteme edukimi i kushtojnë pak vëmendje asaj që mësuesit e dinë dhe çfarë bëjnë ata në klasë. <http://artistatshqiptar.net/2019/03/07/bota-po-perballet-me-nje-krize-te-mesuarit-ja-cka-sugjeron-banka-boterore/> March 7, 2019 ~ 2019-12-12 David Malpass, President i Grupit të Bankës Botërore / <https://www.worldbank.org/sq/news/opinion/2019/12/12/learning-crisis-requires->

Nga fillore në të mesmen

Shkollimi i mesëm profesional është shtylla e zhvillimit ekonomik të vendit. Krahas gjimnazeve duhet pasur edhe shkolla të mesme të zanateve të ndryshme. Faza e shkollimit të mesëm duhet të jetë momenti crucial, ku duhet të bëhet orientimi i nxënësve sipas prirjeve dhe aftësive. Për regjistrim në shkollat e mesme nuk ka kurrfarë kriteri, as provim pranues e as notë mesatare, pra mund të regjistrohet edhe ai që nga fillorja vjen me sukses minimal të notave – të njaftueshëm. Përveç kësaj, me Ligjin që në vitin 2008 bëri të obligueshëm arsimin e mesëm, Ministria e Arsimit, respektivisht Qeveria kishte dështuar që paralelisht këtij obligimi ligjor të krijojë edhe kushte shkollimi, nëse jo të barabarta të paktën të për afërta, për të gjithë. Sepse, nga shumë të dhëna mësohet se ka një pabarazi të madhe në arsim dhe se një pjesë dërrmuese e nxënësve në shkolla të mesme janë të dekurajuar të ndjekin mësimin. E, pavarësisht kësaj, në fund secili mbaron shkollën dhe pajiset me një diplomë të arsimit të mesëm.

Profesorët s’kanë llogari të ngatërrohen as me nxënësit e as me prindër dhe në këtë mënyrë, me shkollë të mesme bëhen edhe ata që nuk kanë as njohuri elementare. Për fat të keq diskutohet edhe heqja e provimit të maturës. Dorëzimi eventual i MASH-it kundrejt kërkesave të tilla do të ishte një gabim fatal. Kur kësaj t’i shtojmë edhe problemet me ambientin e shkatërruar shkollor, tekstet me përplot mangësi dhe mosinteresimin e profesorëve për të qenë në nivel të detyrës (për shkak të pagave tejet të ulëta), atëherë bëhet e qartë edhe tabloja e cilësisë së arsimit.

new-approach Mësimi i leximit është një zotësi posaçërisht kritike: ai e hap një botë të mundësive dhe është themeli mbi të cilin ndërtohet mësimi thelbësor, përfshirë punën me numra dhe shkencën.

Të pa punët me diplomë

Zinxhiri i filluar nga fillorja në të shkollën e mesme, vazhdon e plotësohet në arsimin e lartë, sepse edhe këtu studentët regjistrohen pa kaluar asnjë filtër seleksionimi dhe një pjesë e konsiderueshme nuk shfaqin as pak interesim për studim. Thjeshtë janë të dalldisur nga mania e diplomave, në fillim të studimeve deri universitare pastaj të magistraturës, sepse vetë sistemi trevjeçar i studimeve me 180 kredi pamundëson punësimin dhe imponon kryerjen e mas-terit. Pra ata që trasojnë prej fillores një dije skajshmërisht të ulët, detyrimisht e kryejnë dhe shkollën e mesme, eksperimentojnë me kryerjen e studimeve beçelor dhe detyrimisht e kryejnë edhe masterin. Një pjesë e konsiderueshme nuk e kanë idenë përse studiojnë. Gjithë kësaj atmosfere të krijuar të rënies së cilësisë, i ka kontribuar edhe shtimi pa kritere i universiteteve publike e private, fakulteteve, kolegjeve dhe shkollave të larta. Prej tyre, çdo vit del hiperproduksion i të diplomuarve e që përfundojnë në armatën e të papunëve.



Numri enorm i universiteteve ka bërë që ato të mos mbajnë llogari as për cilësinë e pranimit të studentëve por as edhe për cilësinë e të diplomimit. Shumicës, thjeshtë u interesojnë të ardhurave financiare

që sigurohet nga pagesat për regjistrim të studentëve. Kështu universitetet nga vatra të arsimit u shndërruan në ndërmarrje biznesi, pasi studentët i shohin më tepër si klientë që u sjellin fitim. Kjo bën që universiteteve t’u interesojnë më tepër sasia sesa cilësia.

Problem tjetër, e që është temë më vete, është pjesa e stafit akademik që imponohen nga politika (pa kualifikimet e duhur, pa përvojë dhe me të kaluar diskutueshme shkollimi). Nuk janë të pakta rastet e atyre kuadrove partiak që edhe për vete ishin shko-lluar me “*procedurë të shpejtuar*”. E kam fjalën për mësimdhënësit që i delegojnë partitë politike, i punësojnë si asistentë (në shumë raste edhe në moshë të shtyrë, pa u përfillur mesatarja e studimeve, me mungesë publikimesh e tj.), që më pas të magjistrojnë e të doktorojnë. Kjo kategori profesorësh fatkeqësisht pajiset shpejtë edhe me thirrjet mësimore të cilat i marrin pa meritë dhe pa ndonjë kontribut ‘*madhor*’ për shoqërinë, shkencën dhe artin.


Rritja enorme e universiteteve

Përzjerja e politikës në universitete ka qenë e mbetet ndër problemet më të ndjeshme, sepse ka futur nëpër universitete kryesisht kuadro të dobët, gjersa ka lënë rrugëve profesionistë e specialistë të dëshmuar nga fusha të ndryshme shkencore. Nga mediat ka pasur raportime edhe për raste të blerjes së diplomave, raste të plagjiaturave dhe angazhimit të mësimdhënësve në shumë vende të punës. Po ashtu janë shënuar raste kur një mësimdhënës ka ligjëruar në tre e më tepër universitete, pra më shumë se dhjetë lëndë brenda një semestri. Të gjitha këto e të tjera probleme, vetvetiu e venë në pikëpyetje çështjen e cilësisë. Sipas akademik Izet Zeqirit “nëse i analizojmë studentët e regjistruar sipas drejtimeve 2017/2018 dhe numrin e fakulteteve do të shohim se:

– *e para*, prodhohmë kuadro në shkencat shoqërore për të cilat tregu i punës ka më pak nevojë dhe

– *e dyta*, kemi një numër të madh të fakulteteve të akredituara që nuk i plotësojnë kushtet për akreditim sipas ligjit.

Aktualisht në RMV kemi 22 fakultete ekonomike me 10.997 studentë dhe 15 fakultete juridike me 4.884 studentë të regjistruar. Shteti s'ka kapacitete të kuadrove me thirrje mësimore shkencore për 5 fakultete ekonomike dhe juridike e jo më për 22, respektivisht 15 fakultete. Kjo mund të shihet edhe nga të dhënat e Entit Shtetëror të Statistikave, ku numri më i madh i atyre që kërkojnë punë, janë ata që kanë mbaruar në shkencat shoqërore, ndërsa kryesojnë ekonomistët dhe juristët⁴¹.



Megjithëse ka një rrjet universitar, nuk ka ende një analizë ose një studim se cila është ecuria e tyre, cili është niveli i mësimdhënies. Kemi universitete, fakultete, kolegje në thuajse çdo qytet... Çdo ditë shoh reklama universitetesh që nuk i ke parë ndonjëherë dhe askush nuk di të thotë sesi akreditohen, sesi vlerësohen, sesi hidhen

⁴¹ Halili, Evis, 'Diplomat që s'bëjnë punë', Gazeta 'Koha' viti XII, nr.3495, f.1 dhe 4, e hënë 29.X-2018

në tregun e arsimit këto universitete... Kundruall kësaj situatë me 15 fakultete juridike, 22 ekonomike dhe disa të shkencave politike, si dhe një numri të lartë të diplomuarish, përsëri jemi shteti me politikën, ekonominë dhe drejtësinë më të dobët në rajon...Kështu është edhe në lëmi e sfera të tjera e, që flet për cilësinë e dobët të arsimit të lartë. Së këtejmi, është nevojë urgjente që të rivlerësohen dhe riakreditohen të gjitha universitetet publike dhe private duke vendosur kritere dhe standarde të larta. Nëse duam eliminimin e pasojave të padëshirueshme, duhet t'u hymë në thelb shkaqëve që sjellin deri te problemet e caktuara.

Prej testeve të Kembrixhit drejt sistemit të Bolonjës

Ashtu sikurse në arsimin fillorë është eksperimentuar me përshtatjen e teksteve të Kembrixhit, në arsimin e lartë kemi rastin e sistemit të Bolonjës. Nën parullën ose sloganin 'Reforma në arsim' sistemi i Bolonjës u fut ngutas dhe pa studim paraprak, gjë që u reflektua dukshëm në gjithë procesin mësimor. Disa vite kaluan pa informim të hollësishëm: as studentët e bile as profesorët nuk e kishin idenë e saktë se çfarë po ndodhte, se çka saktësisht nënkuptonte ky sistem. U reduktua dukshëm sasia e lëndëve mësimore. Në vend të librave, u bënë praktikë skriptat, e në rastet edhe më të këqija vetëm ca fjali nga sllajdet e marra prej ligjëratave të shkurttra në Power Point. Kështu studentët diplomojnë me ndihmën e skriptave dhe sllajdeve. U instalua një praktikë e keqe studimi me skripta e sllajde, që për nga sasia e mësimin është shumëfish më i pakët se me cilitdo libër. Përmes silabusit të lëndës, nga pikët e ndara të vlerësimit, studentëve u mundësohet notë kaluese nga vijueshmëria, pak 'aktivitete' sa për të thënë dhe ndonjë punim seminarik që për më tepër është 'copy-paste' nga dr. google.

Po ashtu lënda brenda semestrit është e ndarë në dy kolokfiume–teste, të cilat studentët zakonisht i kalojnë duke kopjuar përmes metodave të ndryshme të sofistikuara teknologjike. Kur krejt kësaj i shtohet numri i madh i studentëve në klasë dhe zhurmës që bëjnë (duke pëshpëritur në orë, duke shikuar e folur në celular, duke dalë e hyrë kot fare gjatë orës mësimore, etj.), është më se e kuptueshme se për çfarë cilësie bëhet fjalë. Është afërmendsh dhe nuk duhet shumë logjikë për të kuptuar se cili studim është më cilësor: ai që e detyron studentin të lexojë së paku dy–tri libra e të përgatisë lëndën prej tyre, apo ai që u thotë të përgatiten prej skriptave të hartuara shkel e shko për shkak të nevojave të ngutshme. Kjo mënyrë studimi tashmë e njohur sipas sistemit të përshtatur të Bolonjës nuk shpie askund, sepsenuk premtion as shkencë dhe as inovacion. Të mos harrojmë edhe intervenimet e mëdha që u bëhen profesorëve për një notë kaluese studentëve të dobët.

Reforma në arsim

Ka kohë që gjithandej hapësirave shqiptar diskutohet çështja se si të sigurohet arsim cilësor. Të gjithë jemi dëshmitarë se si sistemi ynë i përgjithshëm edukativ–arsimor po degradohet, gjersa ministrinë e arsimit nuk kanë hartuar ndonjë plan strategjik serioz e kredibël për ta rritur cilësinë. Sistemi arsimor nuk mjafton vetëm të analizohet dhe proklamohet, por edhe të vepohet konkretisht.

Për fat të keq, tekstet mësimore vazhdojnë të kenë mangësi të mëdha përmbajtësore dhe shumë gabime logjike. Kushtet në shumë shkolla vazhdojnë të jenë të ulëta dhe për shkak të pagave jo të larta, profesorët e kanë të vështirë të ndajnë të holla për ta blerë një lllaptop, mos flasim më pastaj për diç tjetër. Problemi i vërtetë me sistemin tonë të arsimit është se nuk vlerësohet kreativiteti. Një

brejtës shumë i keq i arsimit mbetet përfshirja e politikës në të, në të gjitha segmentet. Kemi nevojë të ndryshojmë në radhë të parë mendësinë dhe qasjen për reformat. Pa një kthesë “kopernikane” në këtë drejtim, s’ka reformim.

Përfundimi

Qasja që aktualisht institucionet tona shtetërore i kushtojnë sistemit të shkollimit duhet medoemos të ndryshojë. Tregu i punës e ka zor të përcaktohet se çfarë studenti do të përzgjedhë, për sa kohë që ka shumë ndryshime në lidhje me llojet e diplomave që janë lëshuar dhe cilësinë e këtyre diplomave. Kjo është edhe arsyeja se përse rinia nuk po sheh asnjë të ardhme nga shkollat që po bëjnë.

Mbi gjithçka dhe para së gjithash, duhet të hiqet nga mendja se secili njeri është për shkencë, sepse jo të gjithë ata që kanë tituj shkencor janë të dobishëm për shkencën.

Puna e parë që duhet bërë është të sigurohet regjistrimi i nxënësve në shkollat e emsme sipas aftësive dhe afiniteteve. Të mos bëhet presion imponues ndaj nxënësve për diçka që nuk kanë vullnet, zell, dëshirë, priirje dhe as gatishmëri.

Të mos ushqehen të rinjtë me iluzione (diploma), por të hapen edhe shkolla zanatesh, ku secili mund ta gjejë veten aty ku ka priirje, aty ku i sheh qartazi afinitetet e veta dhe ku mëton t’i zhvillojë ato.

Pranimi në fakultete gjithashtu të bëhet me provim pranues.

Të bëhet kompletimi i stafit të shkollave dhe fakulteteve “me personel të kualifikuar për lëndët përkatëse”⁴².

⁴² Qendra për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, ‘Sfidat dhe zhvillimi i arsimit në Shqipëri’, Tiranë, 2014, f.17

Të ritën kriteret për regjistrimin në studime pasdiplomike dhe të bëhet monitorim sa i takon respektimit të atyre kritereve në institucionet e larta publike e private arsimore.

Të ritet “ndihma nga ana e shtetit” për shkollimin e atyre fëmijëve që kanë talent të rrallë, por që vijnë nga familje skamnorësh dhe nuk kanë kushte ⁴³”

Këto masa janë më se të nevojshme e të domosdoshme për t'i hedhur hapat reformues drejt një arsimit sa më cilësor. Kur të bëhen këto, atëherë mund të flasim për hapa konkret, serioz dhe real drejt ‘*reformave në arsim*’. Në të kundërtën, gjithçka mbetet të sillet në rrethin vicioz të retorikës boshe e propaganduese për nevoja ditore.

LITERATURA:

Mitev, G, Maja & Spaseva, M, Suzana & Gjorgjev, Dragan, ‘*Prioritetet e politikës për përfshirjen sociale në Maqedoni*’, Friedrich Ebert Stiftung Foundation, Shkup, 2007

Qendra për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, ‘*Statat dhe zhvillimi i arsimit në Shqipëri*’, Tiranë, 2014

Halili, Evis, ‘*Diplomat që s’bëjnë punë*’, Gazeta ‘*Koha*’ viti XII, nr.3495, 29.X–2018

web: <https://kumti.com/unesco-paralajmerim-per-krize-globale-ne-arsim/>

web: <http://artistatshqiptar.net/2019/03/07/bota-po-perballet-me-nje-krize-te-mesuarit-ja-cka-sugjeron-banka-boterore/>

web:<https://www.worldbank.org/sq/news/opinion/2019/12/12/learning-crisis-requires-new-approach>

⁴³ Mitev, G, Maja & Spaseva, M, Suzana & Gjorgjev, Dragan, ‘*Prioritetet e politikës për përfshirjen sociale në Maqedoni*’, Friedrich Ebert Stiftung Foundation, Shkup, 2007, f.5

TAHIR ZAJAZI

Ekspert i çështjeve pedagogjike

ZGJIDHJE ALTERNATIVE E TEJKALIMIT TË GJENDJES SË ARSIMIT NË VEND

Abstrakt

Tranzicioni midis dy regjimeve, monizmit dhe pluralizmit gjatë tri dekadave e, që aktualisht nuk i shihet fundi, shënoi ngjarje serioze, por me pasoja retrograde në të gjitha sferat e jetës dhe veprimtarive materiale dhe shpirtërore të vendit. Ndryshimet, fatkeqësisht regresive prekën edhe themelet arsimit duke devaluuar kritere me standarde akademike edhe të atyre vlerave që trashëguam nga shkolla e regjimit të kaluar.

Sipas një parimi në shkencë nuk ndodh një pasojë pa pasur një shkak. Me rënien e regjimit politik monist ndodhi ajo që nuk duhej të ndodhë. Krerët e politikës moniste vazhduan të jenë mbartës edhe të politikës në tranzicion, me dallimin e vetëm: ndërrimin e idealeve për interesa të ngushta personale, familjare, klanore dhe të politikës. Kjo, sipas parimit të vertikalishtit, që vjen nga kreu drejt bazës reflektoi edhe në sferën e arsimit. Pra, vazhdoi shkolla sipas pedagogjisë së edukatës socialiste (të autorit kontrovers rus, Gonçarov) ne përpjekje për të sjellë modelin e shkollën sipas pedagogjisë së arsimit plural, kapitalist të cilin e synojmë tri dekada me radhë. Gjatë tranzicionit, politika për alibi zgjodhi inskenimin e projekteve në arsim, duke kamufluar me arsyetimin se kuadri arsimor me konceptime tradicionale të regjimit monist do të

konvertohen në konceptin modern, në një kohë kur katedrat pedagogjike të fakulteteve në vend akoma prodhojnë kuadër me konceptime tradicionale.

Fjalë kyçe: tranzicioni në arsim

Hyrje

Të gjithë jemi dëshmitarë se nga viti 1994 në Republikën e Maqedonisë së Veriut kemi vërshim të projekte arsimore, si p.sh. projektet “Një nxënës një kompjuter”, “Vlerësimi ekstern”, “Matura shtetërore”, “Ditari elektronik”, “Puna në grupe të vogla”, dhe shumë eksperimentime tjera të ngjashme. Mirëpo, në asnjë rast nuk u mbajt llogari për punën e mësimit ndryshuesve, pra se si do ta përballojnë ata gjithë këtë ndryshim, të kalimit të sistemit nga modeli tradicional në modelin moderne dhe si do tu përshatën ndryshimeve kur dihet se, për tejkalimin e sfidave që vinin nga jashtë dhe nga brenda shkollës, kjo e fundit zgjodhi improvizimin e gjërave edhe në shkollë edhe në klasë. Për rrjedhojë, sistemi arsimor është zhytur brenda një kaosi të vërtetë nga i cili pësojmë të gjithë, por më së shumti nxënësit.

1. Ndryshimi si fenomen

Me qëllim që të arrijmë në pohimin eventual të tezës se ndryshimi në arsim është i domosdoshëm, ndalemi në definimin e nocionit “*ndryshim*”. Si fenomen ndryshimi është dukuri natyrore universale, komplekse në përbërje dhe i ndërlikuar në kufizimin e limiteve. Asociacion në shprehjen e lashtë historike të Heraklitit, “*panta rej*” në kuptimin e ndryshimit të fenomeneve natyrore,

shoqërore, sociale, familjare, personale, anatomike, fiziologjike, teknologjike, teknike, teknologjike, politike dhe kështu me radhë. Sipas një burimi, ndryshimi është një gjë e shprehur me fjalë të njëjta por në forma të ndryshme që tregojnë raporte të ndryshme si, bie fjala në punë, kohë, numër, mënyrë, shpresë, përcaktim e kështu me radhë⁴⁴. Në gjuhën e kibernetikës shprehja “ndryshim” nënkupton ndërhyrje në ndërrimin e kahut të elementeve në përbërje të sistemit që ai të funksionoj ndryshe⁴⁵.

Ndryshimet zhvillohen pa vullnetin tonë. Nuk mund ti ndalim. Evoluojnë së bashku me kohën. Përjashtime ndodhin në sisteme pragmatike shoqërore, me hapësirë për ndërhyrje të njeriut në inicimin, përkrahjen dhe ngacmimin e procedimet të ndryshimit. Në këtë kategori takon edhe sfera e arsimit.



Në parim ndryshimi i fenomeneve sociale janë në kah progresiv. Ata na çojnë përpara drejt shkallëzimit të gjendjeve. Pra, nuk është problem ndryshimi. Problem është njeriu që nuk e do ndryshimin për tri arsye: *E para*, sepse ndryshimi na përball me sfida dhe

⁴⁴ Petroviç, P.M. etj. (1937): “Sveznanje”. Zagreb-Beograd: Narodno delo

⁴⁵ Zajazi, T. (1997): “Mësimi i programuar në kushte laboratorike”. Tetovë: Se Seft (disertacioni)

rezulton rrezik eventual i ngacnimit të shqetësimit që është rrjedhojë e prishjes së komoditetit që kemi. *E dyta*, ndryshimi ngacmon probleme dhe imponon të marrim rrezik në zgjedhje të problemit që vjen nga ndryshimi. Nga natyra që ka, njeriu nuk i do problemet. Ai iu shmanget problemeve deri në masë kur vetëdijesohet se është i rrezikuar nga problemet. Nga ana tjetër, përtej natyrës që kemi, nuk mund t’iu shmangemi problemeve. Ata janë pjesë e jetës në përditshmërinë e njeriut. Zgjidhje e vetme është të pranojmë se motivi për të mësuar është se si ti zgjidhim problemet që vijnë nga ndryshimi⁴⁶. *E treta*, njeriu i injoron ndryshimet për shkak të rrezikut që vjen pas përplasjes midis ndryshimit dhe vetvetes. Bie ndesh mentaliteti ndryshe me arsenalin e sistemit të bindjeve, qëndrimit, vlerave, botëkuptimit, idealit, interesit, vizionit dhe kështu me radhë.

Nuk është një punë e thjeshtë dhe pa brenga të merresh me ndryshimin e vetvetes. Është e dhimbshme të mohosh atë që dikur e ke pasur ideal. Të duhet një bindje ndryshe, e thelluar në masë, e cila ngacmon një motiv tjetër në marrje të rrezikut për ndërhyrje të vullnetshme dhe me dashuri në tejkalimin e sfidave për të arritur në nivele të idealit për ndryshimin e vetvetes me arsenalin e vlerave të bagazhit personal që posa e theksuam.

2. Palët e interesit dhe qëndrimi ndaj ndryshimit në arsim

Ndryshimi ndodh kur gjërat i sistemojmë ndryshe nga ajo që ishin më parë. Procesuimi i rivendosijes së gjërave nuk është një punë e thjeshtë, as e lehtë. Kërkon një angazhim të përkushtuar me dashuri. Paraprin ideali që të ndodhë ndryshimi dhe radhazi

⁴⁶ Zajazi, T. (2003): “Metodologji të mësimdhënie dhe mësimnxënies”. Shkup: Winsent Graphic

ngacmuesit e brendshëm siç janë: interesi, bindja, motivi, vizion për realizimin e një *strategjie ndryshe*, adekuate me ndryshimin.

Ndër palët primare të interesit për ndryshim janë studenti (nxënësi), prindi, mësuesi dhe opinioni (që pret nesër të bëhet prind apo gjysh). Në kategorinë e dytë të palëve të interesit për ndryshime është tregu i punës dhe politika. Ndryshimi pritet të ndodh kur të gjithë palët duhet të jenë bashkë dhe të pajtohen se ndryshimi është i domosdoshëm për vendin dhe se ajo duhet bërë patjetër. Shkojmë radhazi në parashikimin e peshës së interesit të palëve që posa i nominuam.

A. *Studenti-nxënësi* është pala më e prekur sepse jo ndryshimi e godit drejtpërdrejt. Ai e do një diplomë e cila i siguron një vend pune. Diploma e cila nuk të garanton një jetë në kushte të mira materiale dhe shpirtërore, ajo është e keqe, jo funksionale, jo produktive, e pa vlerë. Andaj, studenti e do ndryshimin. Jo vetëm kaq. Ndryshimi që premtos është forcë e cila e motivon studentin në përkushtim ndaj shkollimit cilësor. Shkollimi nuk është një punë e thjeshtë dhe e lehtë. Rrugëtimi deri në diplomë të përplas me shumë sfida, ndonjëra bile shqetësuese. Tejkalimin e barrierave të pritura e mbështet ideali me vizion për jetë më të mirë. Shkollimi me ideal çliron energji, ngacmon forca motivuese dhe angazhim të palodhshëm, sepse zhvillohet me shpresë dhe entuziazëm.

Shembulli më origjinal, burimor që aktualisht e prekim të gjithë ne përreth është qëndrimi injorues i gjeneratave, me përjashtime minimale ndaj shkollës dhe shkollimit serioz në vrap për dije, aftësi dhe kompetencë. Sepse një diplomë të keqe që ia jep shkolla nuk e pranon as tregu i brendshëm as tregu i jashtëm i punës. Akoma edhe më keq ndodh kur studenti sajton se politika ka kaluar në pozitën e “agjencisë për punësim” dhe ajo, pavarësisht se diploma

është me dije ose pa dije, tregut ia imponon kuadrin i cili është në shërbim të politikës. Për pasojë, studenti ka më tepër leverdi të kërkon një lidhje me politikën se sa të merret me literaturë nëpër biblioteka. Sepse kjo e fundit nuk ka forcë që të siguron një vend pune. Rezulton se, gjeneratat që nuk e duan librin dhe bibliotekën, nuk janë fajtorë. Faji i takon mjedisit i cili nuk krijon rrethana motivuese për shkollim të përkushtuar të gjeneratave me ideal. Një e keqe tjetër që ndodh është se studenti i përkushtuar në studime merret me gjurmime në biblioteka dhe arkiva; ai nuk ka kohë të kërkon lidhje me politikën dhe përfundon të migroj në një vend të zhvilluar, me shpresë të integrohet atje në botën globale dhe kështu ndodhë zbrazja e vendit edhe nga truri i gjeneratave që premtan. Thjeshtë, studentët elitar i gëlltiti interesi i vendeve të zhvilluara dhe atje në sisteme të hapura u treguan të suksesshëm.

B. *Prindi* është një fenomen tjetër i palës së sferës së ngushtë të interesit për ndryshim në arsim. Prindi edhe nga natyra është i “dënuar” të jeton për një ideal të vetëm që është përpjekja maksimale për t’i siguruar fëmijës kushte për jetë normale dhe të lumtur në mjedis, që është një mbështetje e vetme e ndjenjës së sigurisë së fëmijës⁴⁷. Prindi sot nuk është ai që ishte dje. Qëndrimi refuzues i prindit të dikurshëm ndaj shkollës, ka evoluar; ka tejkaluar barrierat konservatore që dikur ishin të përmbytura me paragjykime. Prindi, sot është i vetëdijesuar se ndjenjën e sigurisë e siguron shkolla moderne dhe rezulton që një kategori e caktuar e

⁴⁷ Është e njohur në psikologji se ndjenja e sigurisë vjen e para pas katër instinkteve thelbësor të races, jo vetëm njerëzore (instinktit amnor, i etjes, urisë dhe seksual)

prindërve, jo vetëm shqiptar fëmijët e tyre i shkollojnë në vende me sistem të zhvilluar të arsimit⁴⁸.

C. Sipas një gjykimi logjik që vjen nga kjo del se prindi e do ndryshimin në arsim. Një shkollë moderne në vend, me gjasë e leverdis secilin prind, ku për shumë shkaqe, ai ka vullnet që fëmijën ta arsimon në shkollë moderne të vendit, pavarësisht përqindjes së participimit eventual për shkollim, ama i sigurt se nga shkollimi modern pritet një diplomë që siguron një vend pune. Afërsisht kështu mendon edhe opinionin i gjerë publik i vendit.

Ç. *Mësuesi* është një kategori tjetër e palës së interesit për ndryshim. Ai e do ndryshimin, me përjashtime minimale deri në masë ku nuk prek në interesin e ngushtë që ka. Nga pozita që ushtron, mësuesi është i përkushtuar në mision; ai e do nxënësin, e do edhe freskimin e punës mësimore, ama brenda kornizave të gjendjes së trashëguar, por jo edhe transformimin që të konvertohet nga një mësues tradicional në mësues modern me konceptime diverzive me vetveten. Sepse kjo e fundit kërkon sakrifica. Autori i këtij shkrimi këtë e ka vërtetuar në një studim të thelluar eksperimental të viteve 1994–2001⁴⁹.

D. *Tregu i punës* është një pikë tjetër e palëve të interesit. Ai është treguesi më i mirë, më real dhe më valid i vlerës ose jovlerës së diplomës. Në treg i eksponojmë dijet, aftësitë dhe efektin pragmatik me kompetencë që vjelim gjatë rrugëtimit në stadi adekuate të shkollimit nga foshnjorja deri te doktoratura. Jo vetëm kaq. Tregu i punës është i motivuar sepse ka leverdi të drejtpërdrejt materiale

⁴⁸ Zajazi, T. (2019): “Memoare – skicë e rrugëtimit pedagogjik të një jete në arsim. Shkup: Brigada

Dizajn

⁴⁹ Zajazi, T. (2003): E cituar

dhe shpirtërore. Nga ajo që aktualisht perceptojmë të gjithë ne, dëgjojmë zëra se diploma që vjen nga shkolla jonë, me përjashtime është e pavlerë. Këto vlerësime vijnë nga sfera të tregut publik dhe jopublik, siç është, p.sh. sfera e administratës, shëndetësisë, arsimit, jurispodencës, ekonomisë, teknikës, artizanateve, e të tjera. Rezulton konstatimi se tregu i punës, jo vetëm vendor është përkrahës i denjë i ndryshimit në arsim. Thjeshtë, të gjithë ne të sferave që posa i theksuam, në objektiv e kemi ndryshimin e pakapërcyeshëm të arsimit, si shans të vetmen për jetë në mirëqenie.

Dh. Politika transitive, është e vetme që dallon nga gjithë sferat tjera të interesit në arsim. Ajo nuk e do ndryshimin në arsim.

3. Qëndrimi i politikës ndaj ndryshimit në arsim

Politika sipas pozitës qëndron në hierarkinë e mjedisit shoqëror, është forcë e vetme e ndryshimit të gjërave. Bëjmë dallim midis politikës që menxhohet me dije dhe politikës që menaxhohet pa dije. E para mbështetet në koncepte të filozofisë sociale, ndërsa e dyta mbështetet në ideale të interesave të ngushta personale, familjare, klanore. Për rastin na imponohet të diskutojmë pak më detaisht në komentimin e themeleve të filozofisë së sistemit politik.

Sipas enciklopedisë britanike limitet e sistemit politik përcaktohen si, "... tërësi e institucioneve formale të cilat së bashku përbëjnë një qeveri ose një shtet"⁵⁰. Që mos ngatërrohemi, bëjmë dallim midis "sistemit politik" dhe "regjimit politik". Sistemi politik kupton mënyrën e organizimit të shtetit, ku përfshin regjimin politik, strukturën ekonomike, organizimin social etj. Regjimi politik është

⁵⁰ David Easton (1953): "The political System"


forma e organizimit të pushtetit brenda sistemit politik dhe ai i referohet, në veçanti Kushtetutës së shtetit, mënyrës së votimit, organizimit të pushtetit midis përbërësve të ndryshëm politik të sistemit etj.⁵¹ Sipas stilit të organizimit dallojnë sisteme të ndryshme politike, me variante të regjimeve të brendshme siç është, p.sh. sistemi demokratik me variant të regjimit parlamentar ose regjimit presidencial. Pa u thelluar, kthehemi në qëllimin e temës tonë.

Nga ajo që e jetuam dhe perceptuam gjatë tre dekadave të fundit, na lejohet të konstatojmë se politika e tranzicionit nuk e do ndryshimin në arsim. Jo pse nuk e kupton, por sepse ndryshimi nuk është në leverdi të saj. Mjafton, qoftë edhe një ditë pune që mund të observosh punën dhe jetën e një shkolle me klasë moderne dhe të kuptosh pasojat marramendëse që vijnë si pasojë e neglizhencës së politikës ndaj ndryshimit në arsim. Shkojmë radhazi në gjykimin e kronologjisë që vjen si rrjedhojë midis shkakut dhe pasojave.

Në përfundim të Luftës së Dytë Botërore ndodhi konvertimi midis dy sistemeve diverzive politike në vend dhe rregullat e lojës së regjimit të dikurshëm plural kaluan në ideologji të frymës marksiste-leniniste të Bashkimit Sovjetik⁵². Si rrjedhojë ndodhi kalimi nga pedagogjia e arsimit kapitalist të mbretërisë Serbe-Kroate-Slllovene në pedagogjinë e edukatës socialiste të autorit rus, Gonçorov (1945). Kuadri, jo vetëm shqiptar i shkolluar në universitete të zhvilluara të perëndimit u trajtuan të indoktrinuar dhe u dënuan me diferencime ideopolitike, u burgosën ose u likuiduan fizikisht. Filloi një periudhë e re në frymë të modelit të shkollës së mbyllur, jo konkurrenente as në tregun e brendshëm as në tregun e jashtëm.

⁵¹ Të dhënat janë vjelë nga interneti

⁵² Zajazi, Tahir (1997): "Pedagogjia e Arsimit". Shkup: Logos A



Një përjashtim minimal dhe në kohë të kufizuar që më kujtohet ndodhi me Universitetin “Shën Kirili dhe Metodi” në themelimin (1947) në Shkup, kur në mungesë të kuadrit akademik të vendit, me urdhër të politikës u angazhua kuadër i dënuar për shkaqe ideologjike, sepse ishin të “indoktrinuar” gjatë shkollimit në universitete të perëndimit, siç ishin, p.sh.: prof. dr. Vuk Pao Pavloviç, prof. dr. Zagorka Miçiq dhe prof. dr. Vlladimir Spasiq në Fakultetin Filozofik dhe prof. dr. Marika Popova që vinte nga burgu i Idrizovës si kuadër në Normalen Shqiptare “Liria” (asaj kohe në Shkup). Ajo që favorizon objektin e këtij studimi është se kuadri i posa nominuar dalloj me konceptime dhe stile të frymës moderne, pa përjashtuar ideatorët e shkollës së madhërisme të Elbasanit dhe më gjerë në të gjitha sferat e profileve arsimore, të cilët e pësuan tmerrësisht sepse ishin të shkolluar në qendra universitare të perëndimit.

Lëshimi i regjimit autoritar (1991) dhe kalimi në demokraci parlamentare të vendit, shënoi ngjarje me pasoja serioze. Krerët e politikës moniste, me resurse të mentalitetit komunist kaluan në menaxhimin edhe të regjimit të ri plural, ku tingëllon se deklarimi për demokraci parlamentare ishte, thjeshtë i formalizuar, verbal, prej nga edhe rezultoi konstatimi se arsimit aktual është vazhdimësi e pedagogjisë së edukatës socialiste. Ajo që ndryshoi është kahu i idealit nga interesi i ideologjisë komuniste, në ideal të interesit të ngushtë personal, familjar, klanor dhe politik. Kjo është substanca e motivit të politikës transitive, e cila shpreh vullnet që tranzicionit të mos i shihet fundi. Sepse kjo është një hapësirë “ideale” e realizimit të interesave që posa i theksuam.

4. Profili i arsimit modern

Janë dy shprehje që për rastin duhet ti definojmë: “*tradicionale*” dhe “*moderne*”. Në shprehjen “tradicionale” kuptojmë një gjë që është e përcjellë nga gjenerata në gjeneratë; diç që është e zakonit nga të parët; e mbështetur në traditë; e mbartur sipas traditës. Kjo del edhe nga nocioni latin, “*traditio*” nga “*tradere*” që në domethënie e ka kuptimin e dhënies, mbartjes, dorëzimit; gojëdhënë, tejdhënie, traditë. Mund të kuptohet, gjithashtu edhe si rend i caktuar, rregull e sjelljes që kalon nëpër gjenerata. Prej këtu rrjedh edhe nocioni “*tradicionalle*” që kupton një gjë që ka ardhur tek ne sipas dhënies apo dorëzimit nga të parët; diç si tejdhënie, që tejkalon; gjëja që dorëzohet nga gjenerata në gjeneratë; diç që është e zakonit nga lashtësia; e mbështetur në traditë; e marrë nga të parët sipas traditës. Në këtë kontekst është edhe nocioni “tradicionalizëm” që do të thotë besimi në tradicionalen; dhënie përkrahje tradicionales; bindje në traditën e të parëve, të cilës i beson. Gjithashtu, veçojmë edhe nocionin “tradicionalist” që

nënkupton përkrahësin e tradicionalizmit, këmbëngulës në tradicionalen, konzervativist⁵³.

Shprehja frënge “*modern*” do të thotë e re; sipas shijes më të re; një gjë që i përshtatet kohës; bashkëkohore; e sotme; e tanishme. Në këtë kontekst edhe fjala tjetër frënge “*moderniser*”–“*modernizim*” do të thotë rindërtim, përtëritje, me përsërit. Shprehjet për definimin e këtij nocioni (e re, më e re, e kohës, e sotme, tanishme) janë relative. Ajo që tani është e sotme, nesër bëhet e dikurshme; ajo që sot është e tanishme, nesër bëhet e kaluar. Në qoftë se të gjithë ato i vëmë në një emërues të përbashkët, domethënien e nocionit “*moderne*” e mbulon vënia e një gjëje me themele (në rezultate) të reja, të tanishme, të sotme ose më të fundit, që i zbulon shkenca dhe teknologjia, me parashikim se ndjekja e ndërrimeve që ndodhin në shkencë dhe në teknologji i bën gjërat të jenë në linjë ndërrimesh të gjendjeve; në avancim të vazhdueshëm, apo moderne⁵⁴.

Moderne do të quajmë atë që është në hap me rezultate gjithnjë aktuale të shkencës dhe teknologjisë. Për shembull do ta quanim moderne shkollën e cila organizimin e drejtimit atje e ka vënë me themele të shkencës së menaxhimit; do të ishte modern prodhimi i një gjëje në qoftë se teknologjia që e prodhon atë është vënë me themele në arritje aktuale të shkencës; do ta quanim modern mësuesin i cili është shkencërisht i sigurt se nxënësi i tij përparon ose nuk përparon; është modern mësuesi i cili shkencërisht është i sigurt se nxënësin e shpie drejt botës globale të dijes; do ta quanim modern mësuesin i cili ka kaluar nga pozita e burimit të

⁵³ Klaiç, Bratoljub (1972): “Veliki rječnik stranih riječi”. Zagreb

⁵⁴ Klaiç, Bratoljub (1972): Ibid.

informacioneve, në pozitën e vëzhguesit aktiv të avancimit të nxënësit në klasë⁵⁵.

5. Shembull i ndryshimit në arsim

Zhvillimi i shkencës dhe teknologjisë nga njëra anë dhe zgjerimi i nevojave shoqërore për jetë më të mirë, nga ana tjetër imponoi ndërhyrje në ndryshime të thelluara në sistemin e shkollimit. Iniciativa lindi në SHBA të kohës së presidentit, Lyndon Johnson (1963–1969) kur nga përvoja e presidencës që ushtroi arriti të konstatoj se: *“Në tavolinën ku unë qëndroj kam mësuar një të vërtetë të madhe që jep përgjigje për të gjitha problemet kombëtare; përgjigje për të gjitha problemet e botës – të gjitha virtytet shpjegohen me një fjalë të vetme. Ajo është arsimi”*⁵⁶.

Në realizimin e këtij ideali u fillua me seminare dhe projekte të dizajnuara me qëllim që kuadri arsimor aktual me konceptime tradicionale të transformohet në modern, gjegjësisht të mbështetur në rezultatet shkencore. Kjo ide kaloi edhe në Evropë, më parë në Angli, megjithatë, pa u thelluar në detaje. Pas harxhimeve të pakursyera në investime marramendëse u konstatua se qasja me seminare nuk tregoi rezultate, ajo doli e dështuar. Hulumtimet e ndërruan kahun dhe u fillua nga koka, pra u bë transformimi i thellë i universiteteve, me çka u arrit që nga gjenerata e parë e kuadrit të shkolluar ndryshe, të nis zbatimin e modelit të ri, modern, me stile të metodave aktive, “hulumtuese” nga foshnjorja dhe radhazi deri në shkallën e doktoraturave. Një prej meritave të shkollimit modern është përcaktimi i parashikimeve që për

⁵⁵ Zajazi, T. (2009): “Perfeksionimi i vazhdueshëm i absolventëve të diplomuar në Fakultetin Pedagogjik-UEJL”- Projekt hulumtues 2008. Tetovë

⁵⁶ Majkëll, Fullan (2001): Kuptimi i Ri i Ndryshimeve në Arsim”. Tiranë: Edualba

periudhën prej pas 20 viteve deri në absolvimin e gjeneratës së parë me konceptime ndryshe, të ndodhë modernizimi i shkencës, teknikës, teknologjisë deri në arritje të rezultateve të kibernetikës dhe elektronizimit të veprimtarive njerëzore në të gjitha fushat. Kjo përgjegjësi, në veçanti për çështje të arsimit, iu besua universitetit të Havardait, atje ku u zhvilluan hulumtime madhore të mbështetura në tri shtylla të kohës: Kibernetika e Winner, N. (1948), Psikologjia biheviore e Skinner –it (1953) dhe Taksonomia e Benjamin Bloom (1956). Pa humbur në kohë dhe investime, kjo përvojë u aplikua edhe në vende tjera të Evropës, atje ku sot kulmojnë me shkencë dhe teknologji të avancuar.

Ngjashëm ndodhi edhe në Japoni me kryetarin e parë, kur në rastin e dhënies së betimit zëshëm dhe bindshëm u shpreh: “*Gjatë mandatit tim do përqendrohem në tri objektiva: objektivi i parë arsimit, i dyti prapë arsimit dhe objektivi i tretë përsëri arsimit*”.

6. Zgjidhje alternative e ndryshimit të arsimit në vend

Sfera e arsimit dhe shëndetësisë janë dy shtylla ku mbështeten të gjitha sferat tjera në shoqëri. E para zhvillon trurin dhe e dyta shëndetin dhe del se mendja e shëndoshë në trup të shëndoshë krijon mjedis me kushte të shëndetshme për jetë më të mirë. Mrekullitë që i prekim dhe shijojmë përreth janë prodhim i mendjes dhe dorës, gjegjësisht forcës afektive dhe psikomotorike. Cilësia në arsim reflekton në cilësinë e jetës. Atje ku ndodhi flakja e modeleve mesjetare të mësimin mekanik, u ngritën shkollat moderne, me themele të mbështetura në rezultate të shkencës siç është rasti me SHBA-të, Japoninë, Zvicrën, Anglinë, etj.

Pas rënies së regjimit monist (1991), tek neve nuk u shfrytëzua përvoja e vendeve që para nesh e shijuan strategjinë reale të

ndryshimit në arsim. Rifillimi me seminare dhe projekte që u realizuan, ishte përsëritje e gabimit të një strategjie të dështuar pas shumë investimeve. U injorua pohimi i tezës shkencore (nga SHBA) se seminarët e dizajnuara për konvertimin e kuadrit tradicional në modern, nuk dha rezultate, ajo u tregua e dështuar⁵⁷.

Ajo përvojë e vyer u injorua, jo pse munguan informacione, por me gjasë politikës nuk i konvenoi ndryshimi, jo vetëm në arsim. Dhe ndodhi ajo që ndodhi me tejkalimin e limiteve akademike universitare dhe përfundoj në rregulla të anarkisë universitare. Vërshoi hapja e 18 universitete në vend, 6 publik dhe 12 jopublike, pa llogaritur edhe disperzimin (me alibi që universiteti të jetë sa më afër studentit) në çdo cep urban të vendit. Sipas standardit ndërkombëtar është i mjaftuar një universitet për 700 mijë banorë, kështu që sipas numrit të banorëve të vendit tonë Shqipërisë do ti mjaftonin tre (3) universitete. Për të grumbulluar student në amfiteatro të 18 universiteteve, disa edhe të dispenzuar vërshoi gara në shkolla të mesme, madje promovini i Ligji për shkollim obligativ të mesëm; shpërndarja e dëftesave të shkollave të mesme për kandidatë të vonuar në shkollim; regjistrimi paushall edhe i nxënësve me dëftesa të shkollave artizane tri vjeçare dhe mbi të gjitha, rezultoi prodhimi i kuadrove akademike më shumë seç duhet (në raport me numrin e banorëve të vendit) por jo edhe i duhur dhe i kënaqshëm për tregun e punës, përfshi edhe cilësimin e kuadrit të diplomuar jo funksional. Kjo me automatizëm reflektoi në drejtim vertikal të sistemit deri në klasën e parë fillore, me motivim për arritje të një dëftese apo diplome, pa gjykuar se ata, me përjashtime janë pa vlerë.

⁵⁷ Majkëll, Fullan (2001): “Kuptimi i ri i ndryshimeve në arsim”. Tiranë: Edualba

7. Rikthimi në shembullin e klasave speciale

Në shikim të parë, kjo e fundit si alternativë tingëllon jo serioze. Për tejkalimin e paragjyqimeve, e diskutojmë radhazi. Shembullin e grup–klasave speciale si alternativë eventuale e mbështesim në përvojë të tri rasteve që personalisht i kam prekur.

Rasti i parë është shembulli i praktikës së shkollës fillore “Liria” në Shkup, kur drejtori i kohës, prof. Avni Zllatku aplikoi klasë speciale të ciklit të parë (I–IV) me nxënës të dalluar, të cilët i menaxhoinin mësues me afinitet për punë me klasën e parë, dytë, tretë, të katërt dhe i bie që grupi i klasës të thithë prioritetet e katër mësuesve. Për fat, nuk u zhvillua ndonjë hulumtim për përcjellje të efektit eventual në gjeneratat e klasave speciale që u menaxhuan nga mësues me afinitete speciale⁵⁸.

Rasti i dytë ka të bëjë me përvojën e Gjinnazit të Prishtinës kur me insistim të Ministrisë së atëhershme të Arsimit dhe në pajtim me Fakultetin e Shkencave Natyrore Matematikore u themelua nga një paralele speciale, me kushte të veçanta jete në konvikt dhe me angazhimin e profesorëve të fakultetit për mbulimin e kurrikulave. Efekti i këtij eksperimenti përfundoi me prodhimin e 40 doktorave të shkencave të matematikës⁵⁹.

Rasti i tretë dhe shumë domethënës vjen nga përvoja e shkollës moderne të vendeve të zhvilluara, ku fëmijët atje nga klasa e parë grupohen sipas 6 fushave të inteligjencës: 1) gjuhësore, 2) logjiko–

⁵⁸ Më kujtohet asaj kohe kur edhe bijtë e mi, Nora, Kelmendi dhe Armendi ishin pjesë e klasave speciale, ku klasën e parë e menaxhonte Age Xhini, të dytën Qefsera Shehu, të tretën Gëzime Zllatku, të katërtën Bajram Haskaj dhe këtu përfundonte puna mësimore me klasë speciale dhe mësues me afinitete speciale

⁵⁹ Sipas rrëfimit të profesorit të denjë të Universitetit të Prishtinës, Prof. Dr. Esat Dauti

matematikore, 3) pamore–hapësinore, 4) muzikore, 5) trupore–kinetike dhe 6) inteligjenca personale (ndër personale dhe brenda personale). Këta shkolla menaxhohen nga mësues me orientim adekuat gjatë studimeve për mësuesi. Grupimi i nxënësve atje zhvillohet nga ekipi i shërbimit pedagogjik i shkollës, me instrumente metrike adekuate. Grup–klasën e menaxhon një mësues me të gjitha kurrikulat deri në klasën e VI kur ndodh diferencimi i nxënësve sipas rezultateve kumulative në *Port folio* në dy drejtime: akademike dhe profesionale. Ata që fitojnë dokumentin me nënshkrim të mësuesit për drejtim akademik vazhdojnë shkollimin tri vjeçar në parajimnaz dhe katër vjeçar të gjimnaz, ndërsa përfundojnë me sinjal jeshil, të hapur të regjistrohen pa pengesë në fakultete adekuate të universiteteve. Pjesa tjetër e nxënësve të grupit profesional vazhdojnë shkollimin sipas afiniteteve në shkolla profesionale dhe aty përfundojnë, pa të drejtë të regjistrohen në fakultete. Përsërisim se gjatë procesimit të selektimit që zhvillohet ekskluzivisht në shkollimin gjashtë vjeçar të shkollës fillore, dëshmon me përgjegjësi mësuesi. Dokumenti me nënshkrimin e tij është i plotfuqishëm. Prindi jo i kënaqur fiton të drejtë që fëmija të përsërisë edhe një vit me pagesë, asaj kohe 18.000 franga zvicerane⁶⁰.

Le të kthehemi tek rastin jonë.

Nga ajo që u theksua, për kushtet tona aty ku jemi sot, mund të merret si alternativë shembulli i shkollave moderne, ama i improvizuar në këto kushte:

⁶⁰ Zajazi, T. (1996): Shembulli u observua drejtpërdrejt në shkolla dhe universitete gjatë qëndrimit

- 1) Shkolla ta ndal hyrjen e politikës në shkollë, që nënkupton drejtorin ta zgjedh, ekskluzivisht stafi arsimor si kusht që drejtori të jetë në shërbim të shkollës, jo të politikës, i pavarur nga politika;
- 2) Shkolla të praktikoj parimin e “provimit pranues”, në kuptimin e selektimit të kuadrit arsimor;
- 3) Mësuesi i angazhuar në klasë speciale të shpërblehet me pagë shtesë të ndjeshme;
- 4) Mësuesi special të adresohet në një shkollë moderne për observime të drejtpërdrejta së paku një javë, së bashku me psikologun prej nga do të vjelin përvojë dhe instrumente metriken.

Jemi të vetëdijshëm se për shkaqe nga më të ndryshme kjo alternativë nuk mund të realizohet në të gjitha shkollat e vendit. Por do ishte e mjaftuar që në mjedise urbane të organizohet, qoftë edhe një shkollë e vetme.

Gjimnazi mendoj se duhet ti kthehet origjinës së gjimnazit klasik, si kusht për rikthimin edhe të imazhit që kishte në të kaluarën. Konkretisht, regjistrimi në gjimnaz duhet të jetë selektiv, të pranohen nxënës me rezultate të larta dhe që premtojnë vazhdimësi në rrugëtimin e tyre akademik. Vlerësoj se strategjia e selektimit të fëmijëve është një ndërhyrje jo vetëm funksionale në rrugëtimin e shkollimit, por edhe humane në përgatitjen funksionale të fëmijëve sipas afinitetit që disponojnë. Thjeshtë, dëftesa e gjimnazit për kategorinë e nxënësve pa potencial akademik, është kohë jo vetëm e humbur por edhe dëshpëruese, që të ndjek gjithë jetën.

LITERATURA:

Petroviç, P.M. etj. (1937): "Sveznanje". Zagreb–Beograd: Narodno delo

Zajazi, T. (1997): "Mësimi i programuar në kushte laboratorike". Tetovë: Se Self (disertacioni)

Zajazi, T. (2003): "Metodologji të mësimdhënie dhe mësimnxënies". Shkup: Winsent Graphic

Zajazi, T. (2019): "Memoare – skicë e rrugëtimit pedagogjik të një jete në arsim". Shkup: Brigada Dizajn

David Easton (1953): "The politikan System" studies në Universitetin e Hamburgut në Gjermani dhe universitetin në Curih të Zvicrës

Zajazi, Tahir (1997): "Pedagogjia e Arsimit". Shkup: Logos A

Klaiç, Bratoljub (1972): "Veliki rječnik stranih riječi". Zagreb

Zajazi, T.(2009): "Perfeksionimi i vazhdueshëm i absolventëve të diplomuar në Fakultetin Pedagogjik–UEJL"– Projekt hulumtues 2008. Tetovë

Majkëll, Fullan (2001): Kuptimi i Ri i Ndryshimeve në Arsim". Tiranë: Edualba

Gazeta, "Shekulli" 25.02.2014 Zajazi, T. (2014): "Nevoja për reorganizimin e arsimit të lartë gjithëshqiptar". Tiranë:

MINIR ADEMI

ITSHKSH – Shkup

VLERËSIMI SI SFIDË NË PROCESIN EDUKATIVO–ARSIMOR

Abstrakt

Arsimi është bazë e zhvillimit të një shoqërie. Pa arsimim të shëndoshë nuk mund të kemi as rini e as shoqëri të shëndoshë. Arsimi është fuqi, po njëherazi edhe sfidë.

Nxënësit në shkollë mësojnë për të fituar njohuri, por jo edhe shkathtësi. Po ashtu nxënësit mësojnë më shumë për notë se sa për dituri. Notat paraqesin simbol për gjendjen ku më e rëndësishme për prindin dhe nxënësin është të tregojnë se janë të suksesshëm edhe atëherë kur për këtë nuk kanë argumente. Nëse nuk janë të interesuar për mësim, nota doemos duhet t'i "detyrojë" nxënësit të mësojnë atëherë kur duhet të notohen ose kur duhen të përmirësojnë notën. Për prindërit janë me rëndësi vetëm notat. Përmes tyre ata kuptojnë se sa i kanë të suksesshëm fëmijët e tyre.

Nga mësimdhënësit vazhdimisht kërkohet të shënojnë nota, për të bërë vlerësimin e diturive që fitojnë nxënësit në shkollë. Në notën përveç diturisë, padrejtësisht marrin pjesë edhe elementet të tjera. Ajo çka e zvogëlon notën ka të bëjë me pa dëgjueshmërinë, parregullsinë apo edhe moskryerjen e detyrave të shtëpisë, ndërsa ajo çka e zmadhon notën e nxënësit ka të bëjë me dëgjueshmërinë, rregullsinë, zellin, aktivitetin në orë dhe ndikimin e prindërve. Të gjitha elementet e theksuara, faktikisht bëjnë pjesë në përcaktimin e notës, edhe atë në të dyja rastet, pavarësisht nëse bëhet fjalë për

zvogëlimin apo zmadhimin e notës. Së këndejmi, mund të pohojmë pa hezitim se notimi është një proces i ndërlikuar dhe se studimet përkatëse duhet të jenë shumëdimensionale, me qëllim që të arrijmë ta vlerësojmë sa më objektivisht mënyrën e notimit të nxënësve, i cili gjithsesi se ka nevojë të ndryshojë dhe të çlirohet nga ndikimi i subjektivizmave.

Fjalë kyçe: arsini, mësimdhënësi, nxënësi, vlerësimi, reforma

Hyrje

Mësimdhënësve u kërkohet vazhdimisht të shënojnë nota në ditar, për të vlerësuar shkallën e njohurive që fitojnë nxënësit për secilën lëndë, pasi sistemi i arsimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut është i lidhur ngushtësisht me notimin e nxënësve. Rrjedhimisht, në fund të çdo viti shkollor të njëjtat nota (me të cilat mësimdhënësi ka vlerësuar shkallën e njohurive të nxënësve, respektivisht shkallën e diturive të fituara sipas programeve përkatëse mësimore) duhet të shënohen në dëftesat e nxënësve, që prindi, respektivisht kujdestari, të ketë të dokumentuar suksesin arsimor të fëmijëve të tyre.

Në përcaktimin e notës përveç diturisë, padrejtësisht marrin pjesë edhe elementet të tjera. Ajo çka e zvogëlon notën ka të bëjë me pa dëgjueshmërinë, parregullsinë apo edhe moskryerjen e detyrave të shtëpisë, ndërsa ajo çka e zmadhon notën e nxënësit ka të bëjë me dëgjueshmërinë, rregullsinë, zellin, aktivitetin në orë dhe ndikimin e prindërve. Të gjitha elementet e theksuara, faktikisht bëjnë pjesë në përcaktimin e notës, edhe atë në të dyja rastet, pavarësisht nëse bëhet fjalë për zvogëlimin apo zmadhimin e notës.

1. Shkollimi i mesëm i obligueshëm dhe interesimi i nxënësve

Qëllimi kryesor për një arritje të suksesshme të zhvillimit arsimor është të identifikohen dobësitë e sistemit ekzistues të vlerësimit, si dhe të shqyrtohen pasojat nga vlerësimi joadekuat. Qëllimi parësor i shkollës është t'i mësojë nxënësit. Në shkollë nxënësit duhet të fitojnë njohuri, por nuk po fitojnë shkathtësi. Njohuritë që kërkohen të mësohen janë në nivel shumë të ulët, kryesisht njohuri faktografike dhe memorizime (mësimi përmendësh).

Në periudhën e fundit të këtij shekulli nxënësit mësojnë për notë e jo për dituri. Ku qëndron shkak në politikën e ministrisë së arsimit apo tek politika e shkollës. Ligji për arsim të mesëm sipas dispozitave të përgjithshme në Nenin⁶¹, ku me këtë ligj detyrohen nxënësit që mbarojnë shkollimin fillor të përfshihen në shkollimin e mesëm të detyrueshëm, pavarësisht nga ajo se sa janë ata të interesuar dhe të aftë për përfshirjen në shkollimin e mesëm. Nëse jo, prindërit do të gjobiten në të holla (deri në 1000 euro).



⁶¹ Neni 3 parasheh: Arsimi i mesëm është i detyrueshëm për çdo qytetar në kushte të barabarta të përcaktuara nga ky ligj

Nxënësit paraqiten për t'u regjistruar në arsimin e mesëm të detyrueshëm me anë të suksesit të arritur në shkollimin fillor. Notat paraqesin simbole për gjendjen e nxënësit. Nxënësit nuk janë të interesuar për të mësuar, por për të marrë notë kaluese dhe të disa lëndë edhe nota të larta pa meritë⁶².

Nga mësimdhënësi vazhdimisht kërkohet të vënë nota, edhe atë më të larta pa njohuri. Pas ekspozimit të fjalisë së parë konstatohet se kjo është kritika më e përhapur për sistemin arsimor në RMV. Në esencë, me pohimin e këtillë përgjegjësia për mosp suksesin në mësim dhe mësimnxënie i hidhet vlerësimit.

Pastaj kërkohet të theksohen shkaqet e gjendjes së këtillë. Përdoret teknika *stubi idesh*, pa ndonjë diskutim konkret. Pas përfundimit të *stubi idesh* prezantohen në sllajde shkaqet e dhëna, me ç' rast dhe krahasohet përputhshmëria e ideve të theksuara me idetë e dhëna. Lejohet mundësia për prezantimin edhe të ideve që nuk janë përfshira në sllajde.

Nxënësit nuk janë shumë të interesuar për mësim, në disa raste e humbin interesin për mësim edhe nxënësit e shkëlqyeshëm, e sidomos kur marrin nota shokët apo shoqet e tyre pa meritë. Nota doemos i "detyron" nxënësit të mësojnë atëherë kur duhet të notohen ose kur duhet të përmirësojnë notën.

Për prindërit janë më me rëndësi notat se sa dituria, ku përmes notave ata kuptojnë se sa i kanë të suksesshëm fëmijët e tyre. Ata nuk marrin informacione të vlefshme për atë se çka dinë fëmijët e tyre, ndërsa nota u shërben vetëm si tregues se a kanë mësuar ose jo fëmijët e tyre.

⁶² Regjistrimi i nxënësve në vitin e parë të Gjinnazit "Sami Frashëri" - Kumanovë, viti shkollor 2016/2017

2. Notimi sipas standardeve

Nga mësimdhënësit vazhdimisht kërkohet të shënojnë nota. Mësimdhënësit janë nën presion të vazhdueshëm për të shënuar nota edhe atëherë kur nuk kanë njohuri të mjaftueshme për nivelin e arritjeve të ndonjë nxënësi të caktuar⁶³.

Çka zakonisht merret parasysh kur formohet nota?

– Mësimdhënësi zakonisht kërkon nga nxënësit të tregojnë se çka kanë mësuar për njësinë e zhvilluar, ndërsa të tjerëve u lejohej të plotësojnë atë me diç që nuk është thënë paraprakisht.

Çka e zvogëlon dhe çka e zmadhon notën?

– Në formimin e notës, përveç diturisë padrejtësisht marrin pjesë edhe elemente të tjera. Për shembull. notën e zvogëlon: jodisiplina, padëgjueshmëria, parregullsia, moskryerja e detyrave të shtëpisë, jopajisja me mjete për punë etj., ndërkaq notën e zmadhon: dëgjueshmëria, rregullshmëria, zelli, aktiviteti në orë, ndikimi i prindit etj.

Në bazë të analizës dhe punës time praktike 26 vjeçare me nxënësit, mund të konstatoj se të gjitha elementet e theksuara padrejtësisht bëjnë pjesë në notë, në të dyja rastet edhe kur e zvogëlon, edhe kur e zmadhon notën. Këto elemente nuk duhet të bëjnë pjesë në notën e lëndës së caktuar. Disa prej tyre mund të bëjnë pjesë në notën për sjellje. Sipas rregullave, ata që e përmirësojnë suksesin e nxënësve për të nxënë më tepër njohuri është vlerësimi i drejtë⁶⁴

⁶³ Mbledhja e këshillit të klasave për suksesin e arritur në fund të vitit shkollor 2016/2017 në Gjimnazin “Sami Frashëri” - Kumanovë.

⁶⁴ Projekti për arsim fillor të USAID, Udhëzime për vlerësim në shkolla fillore (21.02.2008)

3. Vlerësimi përmirëson të mësuarit

Vlerësimi adekuat kemi atëherë kur sigurojnë informatë kthyesë efektive; i kyç nxënësit në mënyrë aktive në mësim; e përshtat mësimdhënien duke marrë parasysh rezultatet nga vlerësimi; zmadhon motivimin dhe vetë respektimin e nxënësve, si faktorë kyç për të mësuarit duke marrë parasysh nevojën për inkuadrimin e nxënësve në vlerësim për të kuptuar se si mund të përmirësohen.

Vlerësimi joadekuat sjell edhe pasoja, sikurse janë: dhënia përparësi e sasisë në vend të cilësisë në të mësuar; zvogëlimi i vetërespektimit të nxënësit përmes gjykimit rreth të arriturave, në vend të dhënies së këshillave për përmirësim; demoralizimi i nxënësve të shkëlqyeshëm në krahasim të vazhdueshëm me nxënës më të dobët se ata⁶⁵; e t; ngjashme. Pra, vlerësimi joadekuat sjell deri te pasojat të pafavorshme në cilësinë e mësimit të nxënësve. Në këtë rast bie interesimi i nxënësve për të mësuar.

Dëshmi për vlerësimin joadekuat të nxënësve nga ana e e mësimdhënësi janë ankesat e nxënësve të paraqitura te kujdestari i klasës apo pedagogu i shkollës. Organet e shkollës duhet të punojnë me mësimdhënësin që vlerësimi të jetë pjesë përbërëse e procesit mësimor. Rreziqet e paraqitura për vlerësim joadekuat duhet të ekspozohen njëri pas tjetrit në mënyrë publike gjatë mbledhjes së këshillit të klasave atëherë kur komunikohet suksesi i arritur i nxënësve gjatë periudhës së notimit. (Mirëpo edhe më e rrezikshme ishte kur nxënësit nuk ishin në informacion të notimit të shokëve të tyre gjatë procesit edukativo-arsimor dhe notat e tyre ndryshoheshin para mbajtjes së këshillit të klasave).

⁶⁵ Publikimi „Brenda në kutinë e kuqe” nga Blek dhe Vilijam.

Drejtori dhe pedagogu i shkollës duhet të bisedojnë në mënyrë individuale me mësuesin për vlerësim adekuat. *Vlerësimi adekuat* e rrit cilësinë dhe e motivon nxënësin të mësojë edhe më shumë ndërsa *vlerësimi joadekuat* e demotivon nxënësin për të mësuar.⁶⁶

Përvoja dhe pjesëmarrja e mësuesve në seminare të ndryshme për notim sjell njohuri të reja dhe suksese në mësim. Gjatë notimit mësuesi duhet të ketë parasysh edhe aktivitetet e tyre, por rolin kryesor gjatë aktiviteteve duhet ta ketë mësuesi.

4. Dallimi mes vlerësimit dhe notimit

Definicioni i nocioneve *mësimdhënie* dhe *mësimnxënie*, si dhe vlerësimi bëhet me qëllim që të arrihet një sukses si te mësimdhënia, ashtu edhe te nxënia.

Mësimdhënia është proces që e realizojnë nxënësit për t'i arritur qëllimet që janë të parashtruara nga mësuesi ose vetë ata. Vlerësimi është nocion më i gjerë se notimi. Vlerësimi gjithashtu, ka për qëllim t'i përmirësojë të arriturat e nxënësve.



⁶⁶ Deklaratë nga drejtori i Gjinnazit “Sami Frashëri” - Kumanovë, Hysen Rrahmani, në mbledhjen e Këshillit të shkollës.

Vlerësimi shërben për ta nxitur nxënësin të mësojë, si dhe mësimdhënësi t'i ofrojë udhëzime se si të mësojë, e jo të konfirmojë se cilët nxënës kanë mësuar e cilët jo.

Vlerësimi adekuat ka për qëllim të përmirësojë arritjet e nxënësve. Vlerësimi duhet të sigurojë informacione edhe për atë se çka mund të bëjnë, e jo vetëm çka dinë. Gjatë vlerësimit mësimdhënësi duhet të përdorë metoda të ndryshme të vlerësimit. Vlerësimi adekuat duhet të bëhet duke i përfshirë të gjitha aktivitetet e nxënësve gjatë tërë vitit shkollor. Përmes vlerësimit nxënësi kontrollon se a është duke përparuar apo ngecur në mësim dhe gjithmonë nxënësit udhëzohen drejt qëllimeve të përcaktuara mësimore. Nëse mësimdhënësi bën vlerësim të drejtë, ai vlerësim nënkupton paanshmërinë gjatë zbatimit të vlerësimit të të arriturave gjatë interpretimit dhe shfrytëzimit të rezultateve. Mësimdhënësi nuk duhet të vlerësojë nxënësit sipas prejardhjes së tyre apo përvojave të tyre paraprake me mësimdhënësin.

Nxënësit i dinë saktë qëllimet e mësimdhënësit gjatë vlerësimit si dhe kur favorizohet dhe vlerësohet në mënyrë joadekuate.

Nxënësit dhe prindërit kanë qasje në vlerësim, ku disa mësimdhënësit bien nën ndikimin e prindërve e disa për interesat e tyre. Gjatë vlerësimit nga mësimdhënësi në shumë raste haptas reagojnë nxënësit në vlerësimin joadekuat ku mësimdhënësi shkel parimet e vlerësimit.

Vlerësimi duhet bëhet në bazë të paraqitjes së njohurive të nxënësve, e jo në bazë të afërsisë apo familjarizimit gjatë vlerësimit. Këto vlerësime joadekuate sjellin pakënaqësi te nxënësit dhe i demotivojnë nxënësit e shkëlqyeshëm kur ata në fund barazohen me nxënësit e dobët.

5. Trekëndëshi i notimit

Vlerësimi i nxënësve, nuk është thjeshtë çështje numrash, që në sistemin e arsimit parauniversitar të RMV-së i përgjigjet shkallores së notave nga njëshi deri te pesa. Vlerësimi është një trekëndësh pedagogjik: vlerësimi–mësimdhënia–mësimnxënia.

Nxënësit do të mësojnë apo do të nxënë dituri aq sa mësimdhënësi u jep mësim dhe si i vlerëson ata. Mësimdhënësit nxënësve u jep mësim, por varet nga nxënësit se sa ata do të mësojnë. Ky sukses i nxënësve varet nga rezultatet e vlerësimit. Nxënësit sa dhe si kanë mësuar varet nga mësimdhënësi dhe vlerësimi i tij. Nëse mësimdhënësi nuk jep njohuri të njafueshme dhe nuk i kushtohet mësimdhënies, atëherë nxënësit humbin interesin për mësim, e posaçërisht demotivohen gjatë vlerësimit joadekuat.⁶⁷

Vlerësimi joadekuat e ç'vlerëson arsimin në të gjitha nivelet, nga ai fillori mesëm dhe universitar. Vlerësimi adekuat e rrit interesimin për mësim e përmirëson gjendjen dhe e rri cilësinë në arsim. Arsini i shëndoshë hap rrugën e zhvillimit të shoqërisë. Pa arsimin të shëndoshë nuk kemi as shoqëri të shëndoshë. Mirëpo, arsimi i shëndoshë varet nga mësimdhënësi dhe mësimnxënësi, të cilët janë ardhmëria e shoqërisë. Duhet pasur kujdes dhe të jepet maksimumi gjatë mësimdhënies dhe vlerësimit. Nxënësit janë ardhmëria e shoqërisë⁶⁸.

Së këndejmi, mund të pohojmë pa hezitim se notimi i nxënësve është një proces i ndërlikuar dhe se studimet përkatëse duhet të jenë shumëdimensionale, me qëllim që të arrijmë ta vlerësojmë sa më objektivisht mënyrën e notimit të nxënësve, i cili gjithsesi se ka nevojë të ndryshojë dhe të çlirohet nga ndikimi i subjektivizmave.

⁶⁷ USAID – Macedonia “Raporti ndërmjet vlerësimit, mësimnxënies dhe mësimdhënies”

⁶⁸ Kellog, 1999

Përfundimet

1. Gjatë vlerësimit dhe notimit të nxënësit duhet përdoren metoda më ndryshe prej kësaj që është standarde.
2. Nxënësi të përcillet gjatë gjithë procesit mësimor për çdo orë, e jo vetëm gjatë kohës së notimit.
3. Nxënësi të bindet në atë që ai duhet të mësojë për të fituar njohuri, e jo notë.
4. Notimin nxënësi ta kuptojë nga mësimdhënësi si notë, e jo si numër.
5. Nxënësin ta tërheqë mësimi, e jo nota.
6. Vlerësimi adekuat do ta motivojë nxënësin që të mësojë për njohuri, e jo për notë.
7. Vlerësimi joadekuat nxënësin do ta demotivojë dhe ai do të angazhohet që të marrë notë sa më lehtë dhe sa më notë të lartë, pa njohuri.

LITERATURA:

1. USAID Macedonia „Raporti ndërmjet vlerësimit, mësimxënies dhe mësimdhënies”
2. Publikimi „Brenda në kutinë e kuqe“ – Blek dhe Vilijam
3. USAID „Udhëzime për vlerësim në shkolla fillore(21.02.2008)”
4. „Rregullorja e shkollës së mesëm Sami Frashëri– Kumanovë”
5. UNICEF „Doracaku për arsimtarët”
6. Minir Ademi, Arsini në Kumanovë e rrethinë (1945–1995),Kumanovë, 2012
7. Metush Sulejmani, Sociologjia e arsimit, Shkup, 2015
8. Stojko Nikolovski–Stojanoviç “ШКОЛСТВО ВО КУМАНОВО И КУМАНОВСКО”, Kumanovë, 2001.

ISAMET BAKIU

ITSHKSH – Shkup

RËNDËSIA E ARSIMIT NË NDËRTIMIN E DEMOKRACISË NË MAQEDONINË E VERIUT – SFIDAT NGA PIKËPAMJA E MËSUESIT

Abstrakt

Ndërtimi i emocioneve është i lidhur ngushtë me njerëzit që jetojnë në një vend të caktuar. Demokracia është "sundimi i demosit" përmes përfaqësuesve të zgjedhur nga "*demos*"-i, i cili ka kuptimin e "*popullit*". Ata që kanë të drejtën e votës kanë fuqinë për të ndryshuar udhëheqësinë e tyre politike.

"*O mbretërit duhet të bëhen filozofë ose filozofët të bëhen mbretër*" thotë Platoni në veprën e tij Republika⁶⁹. Njohuritë e fituara në shkolla jo gjithmonë i përgatisin njerëzit për të sunduar/udhëhequr. Ndonjëherë ose shumicën e kohës njerëzit përgatiten për të shërbyer. Në një vend të vogël si Maqedonia e Veriut, kemi një demokraci e cila zbaton një pushtet–ndarje në baza etnike si një formë e menaxhimit të konfliktit të vitit 2001. Njëra ndër të drejtat elementare është edhe e drejta për arsimim në gjuhën amtare. Njohja e së drejtës për arsim në nivelin universitar qetësoi tensionet ndëretnike dhe hapi rrugën për ndërtimin e demokracisë koncesuale. Por jo të gjitha problemet u zgjodhën menjëherë. Një raport

⁶⁹ Platoni, Libri VI, Republika

i NORDEM (04/2005 nga Ronny Myhrvold) jep sqarime interesante lidhur me raportet ndëretnike pas Marrëveshjes Kornizë të Ohrit⁷⁰.

Pavarësisht rrethanave politike, avancimit të të drejtave të etniteteve jo maqedonase, sistemi arsimor në Maqedoninë e Veriut përballet me shumë vështirësi dhe sfida. Mos funksionimi i sistemit ligjor, problemet me sundimin e ligjit gjithashtu dëshmojnë se sistemi arsimor ka keqedukuar profesionistët. Në vend të ndërtimit të institucioneve demokratike, zbatojnë kapjen e institucioneve dhe shtetit si dhe shfrytëzim për nevoja të oligarkisë. Sa është i rëndësishëm arsimi për të pasur një demokraci të konsoliduar? A është udhëheqësia politike produkt i votës së masave të keqedukuara? Këto janë pyetje që kërkojnë hulumtim më të thellë empirik.

Fjalët kyqe; demokracia, arsimi alternativ, sfidat , llogaridhënia, transferimi i njohurive, reforma, etj

Hyrje

Nivelet e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesme janë jetike për edukimin e gjeneratave të reja. Sfidat që konsiderohen si çështje kryesore strategjike do të shpjegohen shkurtimisht përmes reflektimit mbi sistemet e tjera ekzistuese të arsimit në botë dhe pengesat me të CILAT ballafaqohen mësuesit gjatë punës së tyre. Në parim, për shkak të numrit të madh të nxënësve mësuesit nuk u

⁷⁰ Myhrvold Ronnz, *The Former Republic of Macedonia – Education as Political Phenomenon*,

<https://www.jus.uio.no/smr/english/about/programmes/nordem/publications/2005/0405.pdf>

kushtojnë të njëjtën kohë dhe vëmendje të gjithë nxënësve në mënyrë të barabartë, kjo varësisht nëse nxënësi ndjek shkollim publik apo privat. Në të shumtën e rasteve në shkollat publike mësimdhënësit nuk marrin trajnim për punë përgjatë gjithë vitit shkollor ose e bëjnë atë formalisht brenda një dite nga agjenci të angazhuara nga qeveria, që përsërisin vit pas viti ligjërata të shabllonizuara.


Një problem tjetër është se kurrikulat (planprogramet) janë jashtëzakonisht shumë teorike të ngarkuara me të dhëna dhe faktografi, për të cilat mbase nxënësit nuk do të kenë asnjëherë nevojë në jetën e tyre, pas përfundimit të shkollimit.

Marrëdhëniet mësues–nxënës–prindër nuk janë duke funksionuar siç duhet. Stërngarkimit të mësuesve/arsimtarëve me punë administrative në disa raste u shtohen edhe angazhimet dhe aktivitetet partiake sidomos gjatë fushatave para zgjedhore, por edhe jashtë tyre. Ka edhe presione tjera që bëhen gjatë vendit të punës e me çka shkelen të drejtat elementare të garantuara me konventa ndërkombëtare. Një vend që nuk ka shoqëri civile të hapur dhe të pandikuar nuk mund të paraqesë demokraci të konsoliduar. Shoqata dhe organizatat jo qeveritare që mbrojnë të drejtat e fëmijëve mund të luajnë rol të rëndësishëm duke alarmuar dhe propozuar ndryshime.

Gjithçka – produkt i arsimit

Në një shoqëri të ndarë thellë dhe ku demokracia zhvillohet në dy kampe jo të barabarta, kërkohet një studim, i cili vëren dhe mat nivelin e diskriminimit etnik në sistemin e alokimit të mjeteve në fushën e arsimit, por edhe të hetohet dhe shihet menaxhimi i mjeteve të alokuara. Shkelja e të drejtave të njeriut dëmton

njëkohësisht edhe procesin e konsolidimit të demokracisë si dhe procesin e integritetit. Keq menaxhimi, abuzimi, mit–marrja dhe korrupsioni nga njerëz që janë produkt i këtij sistemi edukativ – arsimor, dëshmon se ka vakum moral dhe etik në menxhimin e resurseve publike ⁷¹. Ndoshta duhet marrë mësim nga sistemi edukativ – arsimor i Japonisë, ku në arsimin fillor rëndësi të veçantë ka mësimi i vlerat morale, ku nxënësit mësohen të jenë të ndershëm, të sjellshëm, të pastër, të sigurtë etj.⁷²



Dokumenti Plani Strategjik i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës i Republikës së Maqedonisë së Veriut 2017–2020⁷³ paraqet shumë

⁷¹ Abdul. A & Memedi. D, *White Collar Crime in Republic of Macedonia in the Period 2008-2017 (From the Prism of Sociological Explanations)* http://journals.euser.org/files/articles/ejss_v1_i3_18/Abduli.pdf (Mars 2020)

⁷² Takashi Naito, *Moral Education in Japanese Public Schools*, Moral Education Forum, Volume 15, Number 2 1990. https://www.researchgate.net/profile/Takashi_Naito/publication/235968778_Moral_education_in_Japanese_public_schools/links/0912f513d8f14402a1000000.pdf

⁷³ Plani Strategjik i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës i Republikës së Maqedonisë së Veriut http://www.mon.gov.mk/images/documents/Strateshki_plan_MON/Strateski_plan_2018-2020_12.01.20181.pdf

sfida ose çështje strategjike të hasura në nivelin fillor apo të mesëm, të cilat janë parakusht për një reformë të mirëfilltë arsimore. Por, pavarësisht asaj se Plani në fjalë është mirë i detajuar dhe premtues, duket se ka shumë për t'u bërë në mënyrë që nxënësit t'i ndjejnë ato ndryshime në jetën e tyre shkollore, nga dita në ditë. “Implementimi i metodologjisë së re në Maqedoninë e Veriut sot është një reformë që fillon nga lartë poshtë (a top-down reform) dhe aspiratat e qeverisë dhe strategjive jo gjithmonë përmbushin nevojat e shkollës dhe kushtet e të mësimdhënies dhe mësimnxënies që shpesh karakterizohen me mungesë të hapësirës edukative, numrit të madh të studentëve në grupet klasore, mungesë të literaturës referuese, mungesë të resurseve për mësimdhënie dhe teknologjisë edukative për të zbatuar inovacione në mësimdhënie. Si rezultat i këtyre brengave organizative dhe financiare, shumë mësimdhënës tregojnë rezistencë të fuqishme ndaj çfarëdo reforme në arsim në Maqedoni”⁷⁴. Kjo dallon nga vendi në vend si dhe nga shkolla në shkollë por ende ekziston nevoja për një fillim të ri që e vë arsimin si përparësi të parë.

Arsyet e edukimit dhe arsimimit – Fokusimi tek nxënësit dhe studentët

"Nëse doni të shkatërroni një komb të tërë, atëherë së pari duhet të shkatërroni strukturën e tij familjare, së dyti arsimin e tij dhe së treti do të pakësoni modelet dhe referencat e rëndësishme të tyre ", thotë një proverb oriental.

⁷⁴ Miovska-Spaseva, S. (2016). *The educational theory of John Dewey and its influence on educational policy and practice in Macedonia*. Espacio, Tiempo y Educación, 3(2), 207-224. doi: <https://www.espaciotiempoyeducacion.com/ojs/index.php/ete/article/view/107> (Mars 2020)

Që ta shkatërrosh familjen, zhvleftëso rolin e nënës që ajo të ndjehet e turpëruar që është amvise. Që ta shkatërrosh arsimin, nuk duhet ti japësh rëndësi mësuesit dhe duhet t'ia ulësh pozitën në shoqëri, që nxënësit ta përbuzin. Që të ulësh rolin e modelit, duhet të zhvleftësosh të diturit, të dyshosh te ta derisa askush nuk i dëgjon dhe nuk i ndjek.

Arsimi i fëmijëve fillon para se të lind. Është kaq e rëndësishme që nëna të jetë e arsimuar dhe edukuar mirë për mënyrën se si do ta rrisë fëmijën e saj. Edukimi është një udhëtim i gjatë dhe me shumë sfida, që vijnë dhe shkojnë. Sillemi në një spirale të jetës që s'ka fund.

Në një demokraci të konsoliduar gjithë njerëzit duhet të gëzojnë të gjitha të drejtat në mënyrë të barabartë. Të drejtat e fëmijëve janë të një rëndësie të veçantë⁷⁵. Qeveritë janë të detyruara të sigurojnë të gjitha kushtet e nevojshme dhe kuadrin ligjor për zbatimin dhe promovimin e të drejtave të njeriut.

John Dewey⁷⁶ shpjegon shumë mirë konceptin kronologjik të arsimit në demokraci, që nga koha e Platonit tek individualistët e shekullit XVIII, idealistët e shekullit XIX etj. Ai e shef arsimimin si një nevojë për jetë. Reprodukimi i qenieve të gjalla imponon edukimin për të bartur në kujtesën brez pas brezi trashëgiminë aq të rëndësishme për të mbetur gjallë lloji. Jeta vetë është një proces i ribërjes së vetes përmes veprimeve në mjedis. Komunikimi është ngushtë i ndërlidhur me arsimimin dhe është thelbësor në trasmetimin e njohurive dhe dijeve. “Jo vetëm që jeta sociale kërkon

⁷⁵Konventa për të drejtat e fëmijëve <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/crc.aspx>

⁷⁶ John Dewey, babai i Demokracisë dhe edukimit, filozof amerikan dhe edukator i cili i dha botës në shekullin e XX teorinë e arsimit që shkrepiti me një lëvizje të dimenzioneve ndërkombëtare.

mësimdhënie dhe studim, për të mbetur përgjithmonë, por vetë procesi i jetës në bashkësi edukon.

Ai e zmadhon dhe e ndriçon përvojën; e stimulon dhe e pasuron imagjinatën; krijon përgjegjësi për të qenë të saktë dhe u jep gjallëri qëndrimeve dhe mendimeve, ” thotë Djui⁷⁷. Për të edukimi formal e ka vendin e vet në shoqëritë e civilizuar. “ Pa edukim formal, nuk është i mundur transmetimi i gjitha resurseve dhe të arriturave të një shoqërie komplekse”⁷⁸. Prandaj, sipas Djuit duhet kërkuar një balans mes arsimimit formal dhe joformal.

Selman Khan ka bërë një projekt të jashtëzakonshëm, një sistem të tërë edukimi onlajn deri në arsimin e lartë. Qëllimi fillestar ka qenë që nxënësit që nuk kanë qenë në shkollë për shkaqe shëndetësore të mund të ndjekin mësimet e humbura. Kjo shkollë virtuale është e pazëvendësueshëm, sidomos në kohë krizash, pandemishë e katas-trofash natyrore. Por edhe në kohëra krejt normale jep mundësi arsimimi dhe edukimi falas onlajn. Por, a sjell kënaqësi ky lloj edukimi tek fëmijët, a i bën ata më të lumtur në krahasim me arsimimin formal? Mjafton të njihet gjuha angleze dhe të përfitohet nga ky program. A mund të prodhohet një aplikacion i këtillë në shqip ose maqedonisht? Arsimimi i gjeneratave në kohë normale kërkon reformim dhe përmirësim të vazhdueshëm.

Mësimdhënia dhe trajnimi i përhershëm në vendin e punës

Ajo që është shumë me rëndësi në reformat në arsim, padyshim se është procesi i përmirësimit të vazhdueshëm. Mësuesi, ka përgje-

⁷⁷ Dewey, John. *Democracy and Education*. The Macmillan Company. Copyright renewed 1944

⁷⁸ Po aty

gjësinë e tij në raport me nxënësit. Kjo përgjegjësi mund të krahasohet me kujdesin e mjekut për pacientët e tyre. Nëse mjeku është përgjegjës për shëndetin ose jetën e njeriut, mësuesi nga ana tjetër është përgjegjës për shëndetin, por edhe për zhvillimin mendor.

Në Finlandë, mësuesit janë lartë të ranguar në shoqëri, aty ku janë avokatët, mjekët, inxhinierët etj. Të ardhurat e tyre janë mjaft të larta që i bën ta konsiderojnë vendin e punës si një vend ku ata mund të bëjnë një karrierë të jetës⁷⁹. Kjo për fat të keq nuk është rasti në vendin tonë.

Çështja tjetër është mentaliteti, qëndrimi i njerëzve drejt sundimit të ligjit, të drejtave të njeriut dhe të demokracisë në përgjithësi. Njerëzve duhet t'u mësohen këto vlera vazhdimisht dhe duhet të promovohen si vlera universale që do të kontribuojnë në ndryshimin e status quos në shoqëri⁸⁰. Në shoqëritë ku këto vlera nuk promovohen dhe nuk mësohen në sistemin edukativ dhe arsimor natyrisht se do të shkelen dhe nuk do respektohen.

⁷⁹ The Finland phenomenon-The Best Education system (documentary) Në 2011, Bob Campton punues i filmave dokumentarë dhe një hulumtues i Harvardit Dr. Tony Wagner e hulumtuan sistemin shkollor finlandez dhe funksionimin e saj të shkëlqyeshëm. Rezultati atij kërkimi ishte filmi dokumentar "Fenomeni finlandez: Brenda sistemit më befasues shkollor në botë" (The Finland Phenomenon: Inside the World's Most Surprising School System") <https://www.youtube.com/watch?v=8jJONUXGsNo> (Mars 2020)

⁸⁰Deklarata Universale e Drejtave të Njeriut <https://www.un.org/en/universal-declaration-human-rights/>



Sistemet e certifikimit dhe vlerësimit ndërkombëtar mund të qartësojë konkurrencën ligjore në mesin e dijetarëve dhe studiuesve edhe në nivel lokal. Ajo gjithashtu mund të rregullojë konkurrencën midis institucioneve private të arsimit dhe të parandalojë qëllimet e mundshme të biznesit si ofertat dhe manipulimet e ndryshme për interesa personale ose influencave dhe presioneve politike. Por institucionet arsimore publike kanë përgjegjësi më të madhe në përgatitjen e gjeneratave. Globalizimi dhe edukimi online përmes internetit ose pajisjeve digjitale bën një konkurrencë në vete ndaj arsimimit formal, por a është kjo që i jep kënaqësi nxënësit, e bën atë të lumtur, e bën nxënësin të qeshet më shumë, të kënaqet duke mësuar dhe duke luajtur? Cili vend ka sistem më të mire në botë dhe a mund ne t'i ndjekim këto rrjedha? Kjo na bën të mundur që të përcaktojmë një vizion se ku duhet të jetë arsimiti në vendin tonë. Duhet të ndjekim modelin e suksesit.

Në botë shumë kompani kanë punësuar kuadro me edukim informal që kanë mësuar shkathhtësi dhe zeje jashtë institucionit shkollë. Ata, madje në shumë raste janë të pazëvendësueshëm. Një balans mes arsimit joformal dhe formal duhet të ekzistojë.

Edukimit si biznes dhe edukimi si mision

Sistemet e certifikimit dhe vlerësimit ndërkombëtar mund të qartësojnë dhe rregullojnë konkurrencën ligjore në mesin e universiteteve si dhe mes dijetarëve dhe studiuesve në vendin tonë. Standardizimi i shkollimit sipëror duke marrë për bazë standardet evropiane që dalin si rrjedhojë e internacionalizmit⁸¹, gjithashtu mund të rregullojnë konkurrencën midis institucioneve private të arsimit dhe të parandalojë qëllimet e mundshme të biznesit, si ofertat dhe manipulimet e ndryshme për interesa personale ose ndikimet dhe shtypjet politike. Pse nxënësit/studentët të mos kenë qasje të barabartë dhe përse nuk u kushtohet koha dhe kujdesi i barabartë? Ata, gjithashtu kanë të drejtë të kenë mësimdhënësit më me përvojë dhe të certifikuar të përzgjedhur përmes institucionit të konkursit. Por, a ndodh kjo tek ne? Kush është arsimtari që punësohet dhe kush vendos për këtë? Jo në të gjitha rastet, por dukuria e punësimeve politike në RMV është tani më një e fshehtë publike. Ky lloj mësuesi, çfarë bën ose çfarë mund të bëjë?

Në raportin e Komisionit Evropian për Maqedoninë për vitin 2019, në kaptinën 26 në faqen 85 ku flitet lidhur me edukimin dhe kulturën thuhet “Cilësia e arsimit është për tu brengosur në të gjitha nivelet dhe sistemi mbetet pre e ndikimeve politike dhe korrupsionit”⁸².

Në vendin tonë, por edhe në rajon përveç orarit të plotë në shkollë, mësimdhënësi shqyrton mundësinë e angazhimit në një

⁸¹ Hans de Wit, *Internationalisation of Higher Education in Europe and its assessments trends and issues*, NVAO Nederlands-Vlaamse Accreditatieorganisatie, Den Hag, December, 2010

⁸² Raporti i Komisionit Evropian për 2019 faqe 85, <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-north-macedonia-report.pdf>

punë të dytë (kamarier, shofer taksie apo ndonjë punë bujqësore) për të siguruar mirëqenien e familjes së tij, meqë vetëm paga e mësimit nuk mjafton për të siguruar një jetë me standarde të mira jetese. Prandaj, kjo nuk u jep mësuesve ti përkushtohen profesionit, të merren me kërkime mbi metodat e avancuara të mësimit ose të ndjekin rrjedhat ndërkombëtare në arsim. Një trajnim prej disa orësh në vit nuk ka fare kuptim, sidomos kur bëhet sa për sy e faqe dhe shpesh herë nga njerëz pa përvojë dhe jocompetent. Jo vetëm që mësuesi, arsimtari apo profesori duhet të ketë motivacionin e duhur për punë të zellshme, por ai duhet të ketë një arsimim të lartë dhe të ketë zhvilluar një hulumtim të vlerësuar në fushën e edukimit. Sigurisht, problemi kryesor dhe thelbësor është sektori i burimeve njerëzore.

Le të mësojmë nga mësimet e John Dewey

Pse fëmijët mos të kenë qasje të barabartë? A është më mirë të krijohen mundësi të barabarta nga një edukim publik i reformuar? Ajo duhet të parandalojë arsimin nga të qenit vetëm një biznes me të vetmin qëllim përfundim sepse rrezikon edhe demokracinë në vend pasi ajo u jep më shumë hapësirë kuazi-intelektualëve dhe shpërfill intelektualët e vërtetë dhe profesionistët në një shoqëri. Kjo me të vërtetë e dëmton demokracinë dhe vë në pikëpyetje piramidën e vlerave, sepse nga ky sistem edukativ- arsimor dalin gjykatësit, prokurorët, mjekët, inxhinierët dhe policët e korruptuar.

Sigurisht, të jetosh në kohën e internetit është një avantazh. Ekzistenca e shumë vendeve arsimore dhe shkollave virtuale, bibliotekave on-line dhe aplikacioneve të tjera janë me të vërtetë

duke e lehtësuar jetën e nxënësve. Khan Academy⁸³, Coursera⁸⁴ ose universitete tjera virtuale janë në dispozicion. Mjafton vetëm të kemi mësues të durueshëm që të mund t'i udhëzojnë dhe shpijnë drejt dijeve dhe njohurive për të cilat ka nevojë tregu i punës.

Fëmijët nuk parapëlqejnë vetëm të punojnë gjithë kohës ose ata s'pëlqejnë testimin me zgjidhje të shumëfishta ose detyra që krijojnë shumë stres për ta. Shkollat duhet të jenë vende gëzimi për nxënësit. Kënaqësia në të mësuarit me të vërtetë ndihmon që truri të funksionojë në mirë dhe të zgjerojë diapazonin e nxënësve. Puna kryesore e mësuesit është të motivojë nxënësin, por edhe ata si mësues duhet të motivohen gjithashtu. Arsimi duhet të mos jetë kryekëput biznesi i përfitimit, por detyrë humane dhe me përgjegjësi.

Punëtoritë e përhershme, të vazhdueshme dhe trajnimet në vend të punës, si dhe prania në orë, vëzhgimi i mbikëqyrur i studentëve para diplomimit që ndjekin mësimet në varësi të fushës së tyre të studimit nëpër klasa të shkollave të ndryshme mund të kontribuojnë në përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Shkolla duhet të jetë një vend pune, në të cilin mësuesi është i motivuar, i kënaqur dhe i lumtur, por nga ana tjetër edhe nxënësit/studentët të jenë të lumtur dhe të motivuar. Bashkëpunimi, ndershmëria dhe disiplina në vendin e punës janë parakushte për të krijuar besim mes prindërve, nxënësve dhe mësuesve. Gjobat, penalizimet e arsimtarëve nuk zgjidhin probleme në arsim, por një sistem si proces përmirësimi që do të sjellë ndryshime në një afat të gjatë e ngrit cilësinë në arsim. Pika kryesore është që mësuesi t'u mësojë fëmijëve se si të përdorin njohuritë e fituara në jetën reale.

Article I. ⁸³Khan Academy | Free Online Courses, Lessons & Practice
www.khanacademy.org

⁸⁴ Coursera <https://www.coursera.org/>

Ne nuk duhet të kërkojmë nga ata të mësojnë përmendësh. Të gjitha që i mësojnë përmendësh do t'i harrojnë shpejt. Le t'i mësojmë se si të jenë të aftë dhe si t'i zgjidhin problemet. "Njeriu mendon vetëm kur përballet me probleme," thotë John Dewey. "Nëse ne i trajnojmë fëmijët tanë të marrin urdhra, të bëjnë gjëra vetëm thjeshtë sepse u është kërkuar të bëjnë, dhe dështojmë tu japim besimin të veprojnë dhe të mendojnë për vetveten, atëherë ne vendosim një pengesë të pakapërcyeshme në rrugën e tejkalimit të mangësive aktuale të sistemit tone të themelimit të së vërtetës së idealeve demokratike ... Fëmijëve në shkolla duhet lejuar liri ashtu që ata të dijnë çdo të thotë përdorimi i saj kur ata të bëhen organ kontrollues, dhe ata duhet lejuar zhvillojnë cilësi aktive në marrjen e iniciativave, pavarësi, dhe begati resurcesh, para se të zhduken keqpërdorimet dhe dështimet e demokracisë (Dewey & Dewey, 1915, p. 304)"⁸⁵

Të gjitha lëndët duhet të mësohen duke përdorur studime të rastit që sjellin njohuri, gëzim dhe argëtim duke e angazhuar nxënësin të zbërthejë dhe zgjidh detyra, të punojë në ekip ta përjetojë procesin edukativ me shpirt. Minimizimi i punëve administrative i jep më shumë kohë mësuesit të kujdeset për secilin nxënës veç e veç.

Përfundimet

1. Arsimi ka një ndikim të rëndësishëm sepse përgatit gjeneratat që do të jenë në gjendje të vazhdojnë me zhvillimin e demokracisë në vend. Në të njëjtën kohë kur vendi i është bashkuar NATO-s dhe kur synon tregun e gjerë të punës në shtete e e BE-

⁸⁵ Miovska-Spaseva, S. (2016). The educational theory of John Dewey and its influence on educational policy and practice in Macedonia. *Espacio, Tiempo y Educación*, 3(2), 207-224. doi: <http://dx.doi.org/10.14516/ete.2016.003.002.009>

së, reformat duhet të marrin në konsideratë kërkesat e tregut në bashkimin e ardhshëm të shteteve jo vetëm tregun vendor.

2. Institucionet parashkollore, fillore dhe të mesme janë pjesët më të rëndësishme në krijimin e fuqisë punëtore të orientuar nga tregu dhe reformat duhet të mbulojnë në thelb çdo çështje strategjike dhe të vendosin plane afatgjate për reforma dhe zhvillim.

3. Arsimi profesional, si për shembull arsini në sektorin e ndërtimit duhet t'i përgatitë nxënësit apo studentët për tregun e punës në vend, rajon dhe më gjerë.

4. Vendosija e standardeve për përgatitjen e mësuesve në universitete dhe kapaciteteve intelektuale hap mundësinë edhe për ata të ndjekin trendet bashkëkohore të arsimit dhe mësimdhënies. Kështu ekuivalentimi në profesion si në cilësi ashtu edhe në aspektin administrativ me shtetet e BE-së do të jetë një përparësi për punësim në një treg shumë më të gjerë sesa është ai vendor.

5. Një arsim efikas dhe i reformuar do prodhojë edhe votuesin kritik, më i vetëdijshëm dhe më vizionar për zhvillimin e shoqërisë dhe demokracisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

6. Shqetësuese është jo vetëm braktisja e trurit, por edhe zbrazja e shkollave nga nxënësit për shkak të emigrimit në perëndim, si pasojë e uljes së standartit jetësor dhe dëshirës për një jetë më të mirë dhe më cilësore.

LITERATURA:

Dewey, J. (1916/1985). *Demokracia dhe Edukimi*. Indiana; Southern Illinois UP.

Armend Tahirsylaj , *Autonomia e mësimdhënësve dhe ndryshimi i përgjegjësisë dhe shoqata me performancën e nxënësve në Didaktik dhe traditat e kurrikulit* ©

2018 Autori (t). Publikuar nga Informa UK Limited, duke tregtuar si Taylor & Francis Group. Botuar në internet: 16 tetor 2018.

Miovska–Spaseva, S. (2016). The educational theory of John Dewey and its influence on educational policy and practice in Macedonia. *Espacio, Tiempo y Educación*, 3(2), 207–224. doi: <http://dx.doi.org/10.14516/ete.2016.003.002.009>

Hans de Wit, *Internationalisation of Higher Education in Europe and its assesments trends and issues*, NVAO Nederlands–Vlaamse Accreditatieorganisatie, Den Hag, December, 2010

Abduli. A & Memedi. D, *White Collar Crime in Republic of Macedonia in the Period 2008–2017 (From the Prism of Sociological Explanations)* http://journals.euser.org/files/articles/ejss_v1_i3_18/Abduli.pdf

Takashi Naito, *Moral Education in Japanese Public Schools*, Moral Education Forum, Volume 15, Number 2 1990. https://www.researchgate.net/profile/Takashi_Naito/publication/235968778_Moral_education_in_Japanese_public_schools/links/0912f513d8f14402a1000000.pdf

Ashton, David dhe Francis Green (1996) *Edukimi, Trajnimi dhe Ekonomia Globale*, (Cheltenham, Edward Elgar).

Sisk, Timothy D. *Ndarja e pushtetit dhe ndërmjetësimi në konfliktin etnik*. Nju Jork: Korporata Carnegie e New York, 1996

Bieber, Florian. *"Institucionet pas konfliktit në shoqëritë etnike të ndara. Nga ndarja e pushtetit në demokraci."* Londër: Shtypi i Universitetit McGill–Mbretëresh , 2005

Platoni, Republika, nga përkthimi Alan Bloom http://www.inp.uw.edu.pl/mdsie/Political_Thought/Plato–Republic.pdf

Plani Strategjik i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës i Republikës së Maqedonisë http://www.mon.gov.mk/images/documents/Strateshki_plan_MON/Strateski_plan_2018–2020_12.01.20181.pdf

OECD: <http://www.oecd.org/education/>

HASAN JASHARI

Universiteti i Evropës Juglindore

E ARDHMJA E ARSIMIT TË LARTË NË KUSHTE TË GLOBALIZIMIT

Abstrakt

Ne vazhdimisht në agjendën e veprimeve tona mendojmë për të nesërmen. Këtë e bëjnë edhe kompanitë dhe institucionet e ndryshme. Por pyetja është se sa universitetet tona janë të preokupuara me të ardhmen e arsimit të lartë dhe me fatin, përgatitjen për punë dhe jetë, të gjeneratave të reja?

Koha në të cilën jetojmë, ndryshimet e shpejta teknologjike, prodhimet e reja na vendosin para dilemave të mëdha rreth asaj se çfarë na pret në të ardhmen? A është ajo 5G apo 6G apo robotizimi i operacioneve punuese? Përshtypja që fitohet nuk është një *panta rei* e Heraklitit dhe shembulli me rrjedhën e ujit, por se kemi të bëjmë me një zhvillim marramendës të teknologjisë që e vendos universitetin si institucion para sfidave të mëdha. Pyetja e radhës është se sa universitetet i prijnë me ide, projekte dhe inovacione këtij trendi të progresit të shoqërisë njerëzore? Pra, në kushte të globalizimit po vërehet “Fuqia gjithë më e madhe e organizmave që të krijojnë të ardhmen”... (Dennet, D., 2006, 134)

Sot globalizimi po e ndryshon me të shpejt botën. Arsini i lartë është bërë i kapshëm për të gjithë. A hapet rruga për një arsim të lartë gjithë e më tepër transnacional dhe në disa gjuhë më të

folshme në botë? Ose si duhet ne të reagojmë në kushte kur Bill Gates investon 40 miliardë dollar në inzhineringun gjenetik, ose a duhet të jetë inteligjenca artificiale një ndër shtyllat kryesore të imagjinatës të arsimit të lartë në të ardhmen? Sigurisht se makinat dhe veglat e punës, robotët do të jenë faktorët kyç të historisë dhe gjeografisë të shoqërisë 4,0 e ndoshta të asaj 5,0 – më vonë. Por Microsoft nuk duhet të ngel i vetëm në këto nisma dhe procese. Universitetet duhet të jenë në krah të nismave që inteligjenca të depërton në çdo prodhim të ri në çdo zhvillim të kapaciteteve njerëzore. E gjithë kjo do të ketë impakte të mëdha në jetën sociale të njerëzimit.

Në Maqedoninë Veriore imponohen pyetjet si vijojnë: A thua ka shumë universitete? A mund të ekzistojnë në të ardhmen 4 universitetet shqiptare? A do të kenë ata zhvillim të qëndrueshëm kur nataliteti shënon rrënje, të rinjtë ikin jashtë?

Me anë të shqyrtimit të literaturës, grumbullimit të të dhënave nëpërmjet anketës dhe teknikave të tjera do të japim një pasqyre të trendeve bashkëkohore të zhvillimeve në arsimin e lartë dhe të ardhmen e jetës universitare.

Fjalët kyçe: arsimi, universiteti, e ardhmja, studentët, shoqëria digjitale

Hyrje

Arsimi i lartë nuk është si arsimi fillorë dhe ai i mesëm. Ai duhet t'i kënaq disa standarde të veçanta të cilat janë të vërtetuara në marrëveshje dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare. Insistimi për të qëndruar te kualiteti inicohet dhe përkrahet nga

shtetet e zhvilluara të Evropës perëndimore dhe SHBA. Kualiteti i arsimit të lartë ka rëndësi njëkohësisht edhe në kualitetin e kuadrit që përgatitet për nevojat e shërbimeve publike dhe shoqërore, pra ndërmarrjeve, spitaleve, shkollave, institucioneve për punë hulumtuese—shkencore, ushtrisë, policisë, fermave të ndryshme dhe shërbimeve të tjera. Ata shërbime kërkojnë njerëz të aftë, specialistë të zotët që të kryejnë punë të ndërlikuara ku duhen dije dhe aftësi drejtimi, udhëheqje e menaxhimi. Zhvillimi i revolucionit 4,0 nuk është i mundur pa udhëheqje nga më të mirët, më të përgatiturit dhe më të informuarit.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut në përgatitjen e ligjeve të arsimit të lartë, me qëllim që të përfshihen të gjithë sfidat e reja dhe të domosdoshme, që do të mundësonin etablimin e një sistemi evropian të arsimit, janë të kyçur shumë konsultantë eminent evropian të fushës së legjislacionit dhe ekspertë të sigurimit të kualitetit në mësimdhënie dhe mësimnxënie.

Ligjërata on-line

Paraqitja i pandemisë Kovid-19 në fillim të vitit 2020 ishte një revolucion i vërtetë në sferën e kyçjes së internetit në mësim. Për një kohë të shkurtër u ngritën nëpër shkolla dhe filluan në funksionojnë platformat si: google classroome, zoom, google meet, microsoft time, skype etj. Deri atëherë vetëm shkruheshin libra, përgatiteshin teza, mbaheshin ligjërata por krejt kjo ishte vetëm për të treguar se ne jemi në trend dhe dimë ta përdorim teknologjinë bashkëkohore në jetën shkollore. Por këta ishin fraza boshe. Izolimi i njerëzve në shtëpi, si rrjedhim i pandemisë, aktivizoi këta teknologji dhe mësimdhënia dhe mësimnxënia pati vetëm disa javë vështirësi dhe më pastaj, ai filloi të funksionojë sepse infrastruktura

ishite aty: kompjuterët, telefonat celularë, laptopat, ipadët, etj. Pra mësimi on-line është tani këtu dhe në gjithë botën, diku më pak e diku më shumë.



Rruga drejt suksesit, piktura simbolizon: shkallet për tu ngjitur nëpërmjet librave por edhe përmes e-mailëve, celularëve dhe laptopëve si mjete të domosdoshme të arsimit bashkëkohor. Source: www.gogle.com

Çmimi i shërbimeve arsimore në të ardhmen

Për studentët pyetja thelbësore, përveç sigurimit të kualitetit, është edhe çmimi i shërbimeve që u ofrohen atyre. Treguesit statistikorë tregojnë se janë billion dollarë borxhe të studentëve të cilët studiojnë në universitetet amerikane. E njëjta gjë është edhe me studentët që studiojnë në Evropën perëndimore dhe Ballkanin perëndimor. Borxhet janë një ngarkesë e madhe për gjenerata të tëra amerikanësh të rinj, familjet e tëra vuajnë, me dekada, nga borxhet dhe ngarkesa e buxhetit familjar. Një numër i konsiderueshëm i studentëve i braktis studimet ose gjatë kohës së studimeve për shkaqe financiare. Borxhet tregojnë se arsini i lartë është i shtrenjtë dhe në të ardhmen duhet bërë diçka në këtë

drejtim. Zgjidhja e këtyre borxheve, shumica e njohësve të arsimit, e gjejnë në një Universitet falas të së ardhmes. Kjo do të lehtësonte jetën e shumë të rinjve të cilët në momentin kur duhet të krijojnë familje, të rrisin fëmijë, të sistemohen në pikëpamje të strehimit, ata janë në borxhe që në fillimin e jetës së tyre të pavarur nga prindërit dhe krijimit të familjes së re nukleare.

Në vijim do të japim një pasqyrë të pagesave për regjistrim në njërin nga Universitetet më të njohur në botë atë të Harvardit. Kostoja totale e ndjekjes së Kolegjit Harvard – përfshirë shkollimin, tarifat, dhomën dhe bordin – do të rritet me 3 për qind. Sipas njoftimit që bëri Kolegji Harvard, për vitin akademik 2019–2020 kjo kosto do të shkojë në 69,607 dollarë amerikan.

Rritja në fjalë shënon shumë prej 2,027 \$ më tepër se sa kostoja e njëjtë e shkollimit për vitit shkollor 2018–2019 e cila ishte 67,580 dollarë. Kostoja mesatare e frekuentimit për një universitet në një universitet katër vjeçar privat amerikan për vitin shkollor 2018–2019 është 46,680 dollarë (*Camille G. Caldera dhe Sahar M. Mohammadzadeh, 2019, faqe 2. Burimi: <https://www.thecrimson.com/article/2019/3/29/2019-20-tuition-rise/>*

Revolucioni në arsimin e lartë dhe dilemat

Pyetja tjetër e radhës është se çfarë ndryshimesh të tjera mund të ndodhin në arsimin e lartë?

Gjatë pesë viteve të ardhshme, autorë të ndryshëm shohin një ndryshim që do të ndodh, ku studentët e mundshëm do të peshojnë dilemën a në fakultete apo të hollat e shumta për studime t'i investojnë në biznes, pra kthimet nga investimet. Pra, studentët e ardhshëm apo të rinjtë më tepër perspektivën e tyre ta kërkojnë në

investime. Kjo do të jetë ngjashëm me mënyrën se si njerëzit bëjnë një llogari si në restorante, udhëtime etj. I njëjti kujdes, pra, do të zbatohet për blerjet e shërbimeve të studimit në universitet. Ose, dilema është se a do të përcaktohen studentët që të harxhojnë për kolegji 100.000 \$ në vit, të vendosen jashtë vendlindjes në qytete të shtrenjta apo do të përcaktohen që këto para t'i investojë në një biznes të vetin e në vend të borxheve të krijojnë përfitime? Pra, studentët e së ardhmes do të jenë blerës më të kujdesshëm.

Sa i përket institucioneve kryesore amerikane të cilat kanë më shumë kurse dhe studentë që i ndjekin mësimet on-line, në krye është Southern New Hampshire University (UT) me 121 437 studentë, i 6-shti është University of Maryland – University College (MD) me 54 428 studentë, dhe i fundit është Ivy Tech University College me 36 640 studentë⁸⁶.

Inteligjenca artificiale, robotizimi

Nëse i referohemi Simson (Simonson, M., 2019, faqe 1) Automatizimi dhe robotizimi i operacioneve punuese gjithsesi se do të udhëhiqen edhe nga mësimi në distancë. Matematikani Alan Turing ndryshoi historinë për herë të dytë me një pyetje të thjeshtë: *A mund të mendojnë makinat?* Pra *menaxhmentit shkencor* të Frederick Tayllor, që bazohej në njeriun si menaxher që duhet ta nxisë produktivitetin e kapitalizmit industrial, tani i bashkohen makinat që “ dinë të mendojnë” gjithashtu.

Libri i Turing-ut "Makinëritë e llogaritjes dhe inteligjencës" (1950), vendosi qëllimin dhe vizionin themelor të inteligjencës artificiale (<https://www.builtin.com/artificial-intelligence>)

⁸⁶ <https://www.statista.com/statistics/944274/us-distance-learning-institutions-by-enrollment-students/>

Si funksionon inteligjenca artificiale

Inteligjenca artificiale (AI) bën të mundur që makinat të mësojnë nga përvoja, të përshtaten në inputet e reja dhe të kryejnë detyra të ngjashme me njerëzit. Shumica e shembujve të inteligjencës (AI) për të cilët dëgjoni sot – nga kompjuterët që luajnë shah, dyqanet pa asnjë shitës por vetëm me makina deri tek veturat që drejtojnë vetveten – mbështeten shumë në mësimin e thellë dhe përpunimin e gjuhës natyrore. Duke përdorur këto teknologji, kompjuterët mund të aftësohen për të realizuar detyra specifike duke përpunuar sasi të mëdha të të dhënave dhe duke njohur modele në të dhëna. Zaten, nëse i referohemi autorëve Pajaziti dhe Jashari “Koncepti i shoqërisë së informacionit është një term sociologjik, postmodern dhe futurologjik, sipas të cilit faktori kryesor i zhvillimit të shoqërisë është përdorimi i informacionit tekniko–shkencor dhe, gjithashtu informacioneve tjera brenda kornizave të së ashtuquajturit "sektori i katërt" i ekonomisë. Teoricienët si U. Beck, A. Giddens dhe M. Castells pranojnë se, që nga viti 1970 transferimi nga shoqëri industriale në një shoqëri informacioni është bërë në nivel global”. (Pajaziti, A., Jashari,H.,2012, faqe 24) https://www.sas.com/en_us/insights/analytics

Mësimi në distancë


Përmes mëimit në distancë, më shpejt dhe me një kosto më të ulët do të mbarten praktikat më të mira perëndimore në mësimnxënie. Me një kosto më të ulët do të mund të bëhet transferimi i dijes dhe ajo do të shpërndahet në të gjithë vendet e botës. Teknologjia e mundëson një qasje të tillë. Pra të supozojmë se një profesor i Oxfordit që të angazhohet të mbajë mësim në një vend të Ballkanit perëndimor do të duhej të ketë një rrogë prej 10 000 paund. Asnjë

universitetet shtetëror apo privat nuk mund të angazhon dikë për një të tillë. E shumta, ai mund të qëndron për një javë me ndonjë program të Erasmus+ (projektin evropian për mobilitet në arsimin e lartë për Ballkanin perëndimor), por edhe kjo radhë ndodh sepse profesorët rëndomë kërkojnë vende atraktive turistike sikurse janë universitetet në Pragë, Varshavë, Dubrovnik, Zadër, Stamboll, Budapest, Krakov etj. Kështu që mundësia më e mirë mbetet mësimi në distancë, me ndihmën e internetit, i cili i tejkalon shumë barrierat dhe, çfarë është gjithashtu e rëndësishme i vendosë para kushteve përafërsisht të barabarta të gjithë pjesëmarrësit në arsimin e lartë.

Në praktik kjo është e realizueshme. Universiteti i Oxfordit, për shembull mund të organizon një kurs të përbashkët on-line me Universitetin e Evropës Juglindore në Maqedoninë e Veriut ose dhe me një universitet tjetër në Kenia. Kështu mund të zhvillohen kurse, programe akademike bile edhe studime të cilat mbarojnë me diplomë të përbashkët. Zaten në Programet e punës të Konferencës të Universiteteve Evropiane kësaj çështje i kushtohet një kujdes i veçantë.

Më poshtë po japim të dhënat për shkallën e përfshirjes në mësimin e hapur apo mësimin në distancë për të rritur, për shtetet si vijojnë⁸⁷:

⁸⁷ https://www.researchgate.net/figure/Participation-rates-in-Open-or-distance-learning-by-country-Percentage-of-adults_fig25_32075655 & https://enqa.eu/wp-content/uploads/2015/12/E-learning-in-the-European-Higher-Education-Area_Gaebel.pdf



Nga grafikoni më lartë mund të vërejmë se në botë prinë Korea e Jugut, një shtet ku arsini për fëmijët, është tërëditor por ku është e zhvilluar edhe e ashtuquajtura *Mama school*, ku nënat kanë mision që të punojnë me fëmijët e tyre që të ndihmojnë fëmijët në mësimnxënie. Pastaj vinë shtete si Spanja, SHBA-të, Polonia e Suedia (kjo e fundit prijnë në mesin e shteteve të Evropës perëndimore). Më pak e përfshirë është Franca, Republika Slovake, Belgjika, Çekia etj.

Studentët tani janë rritur në një mjedis dixhital

Nga teksti më lartë, mund të duken disa gjëra si nebuloze. Por kjo varet nga njerëzit dhe vendi dhe nga rrethanat shoqërore në të cilat është zhvilluar apo jo digjitalizimi i shërbimeve të ndryshme. Sipas autores Ballantine (Ballantine,J., 2017,faqe 7) ”. Arsimi ka ndryshuar në mënyrë të shpejtë dhe kjo nuk është lehtë që të pasqyrohet këtu”. Por gjithsesi se gjeneratat që vijnë janë disi të digjitalizuara para ardhjes në bankat e shkollës. Ata, janë rritur në një mjedis dixhital. Ndryshimet që po e kaplojnë arsimin e lartë në SHBA dhe në shtetet e Evropës perëndimore gradualisht do të mbarten edhe në Ballkanin perëndimor dhe në Maqedoninë e Veriut. Pyetja është përse? Përgjigjja duhet të kërkohet te faktet se të gjitha ndryshimet që bëhen në Evropën perëndimore barten në Ballkanin perëndimor, dhe se arsimi i lartë në Ballkanin perëndimor është i strukturuar në baza perëndimore, duke filluar nga kurset mësimore, librat, planet mësimore, projektet e përbashkëta evropiane dhe amerikane me universitetet vendase etj.

Thënia filozofike antike greke: *o njeri njihë veten*, thjesht do të përshtatej në rastin tonë si imperativ i kohës: *o njeri edukohu për shoqërinë digjitale dhe për profesionet e reja* (Jashari, H.2005, faqe 10).

Kështu që është shumë e pritshme që në të ardhmen të ketë një varshmëri dhe një bashkëpunim të rritur në mes universiteteve të Evropës perëndimore dhe universiteteve në Ballkanin perëndimor që do të përfshijnë kurse të përbashkëta në 2–3 grupe të vendosura në vende të ndryshme të rruzullit tokësor. Arsimin i drejtuar nga interneti dhe orientim i studimit i lidhur me industrinë dhe

komunitetin janë vetëm disa nga mënyrat sesi kolegji mund të ndryshojë në të ardhmen.

Si përdoret edukimi on-line?

Dallojmë disa forma dhe fusha përdorimi:

- Duke zëvendësuar ligjëratat përmes regjistrimeve – ose moduleve në internet, modulet e vetë studimit të drejtuar – duke përdorur klasë për bashkëveprimin;
- Në internet: grupe studimi të bashkëmohatarëve që zëvendësojnë kurset tradicionale me kurset në internet
- Kurse për bashkim (disiplina të rralla)
- Përdorimi i MOOC (Massive Open Online Course)
- Tërheqjen e studentëve të rinj (falas për të provuar)
- Zëvendësimin e mësimit në kampus
- Laboratorë virtualë – projekte kërkimore studentore...
- Debate në largësi

https://enqa.eu/wp-content/uploads/2015/12/E-learning-in-the-European-Higher-Education-Area_Gaebel.pdf

Vlera e hulumtimit

Pothuajse i gjithë diskutimi lidhur me arsimin e lartë ka tendencë të mbështetet në vlerën e hulumtimit shkencor. Universitetet e mëdha publike dhe ato më të vegjël privat duhet të jenë në të ardhmen më tepër universitete kërkimore. Hulumtimi dhe edukimi janë produkte të përbashkëta. Dhe ne kurrë nuk duhet ta humbim vëmendjen për këtë. Komuniteti dhe industria duhet t'i rrisë pritjet

e veta por edhe bashkëpunimin në arsimin e lartë dhe bërthama hulumtuese në ta. Teknologjitë e reja dhe prodhimet të cilat dalin prej tyre duhet të kenë vulën e hulumtimit shkencor të përbashkët në mes universiteteve dhe industrisë. Kompanitë duhet lidhur me dijen.

Ne jetojmë në një botë në të cilën kapitali i vetëm i vërtetë është kapitali njerëzor.

E ardhmja e arsimit në Ballkanin perëndimor dhe në Maqedoninë e Veriut

Hapja e bisedimeve edhe me Shqipërinë dhe me Maqedoninë për integrim në Unionin Evropian do të nxit edhe ndryshime të mëdha në arsim. Së pari në aspektin legjislativ e pastaj edhe me ndryshimin e qasjes që do të ketë elita politike ndaj arsimit të lartë, ndaj shkollës dhe standardit studentor në përgjithësi. Gjithsesi, se çështja e sigurimit të kualitetit në arsimin e lartë do të theksohet si problem madhor. Bashkëpunimi ndërfaqinësor dhe partneriteti në programe studimore dhe projekte arsimore shkencore do të jenë çështje e prioritare të së ardhmes.

Sa u përket universiteteve në gjuhën shqipe në Maqedoni pyetja thelbësore është se sa ata kanë siguruar kualitet në punën e tyre dhe se a mund të flasim për sigurim kualiteti kur një parti politike përkrah një universitet, që nuk ka asnjë të punësuar me orar të plotë. Atje nuk mund të depërton mekanizmi i kontrollit shoqëror – inspektorët e arsimit. (*Меѓународниот универзитет во Струга работи како пералница за дипломи, констатираат просветните инспектори. 7 јуни, 2018. Галена Николовска – Ризвановиќ*)

Cilësia e pamjaftueshme e disa fakulteteve dhe universiteteve është e shoqëruar nga një sistem jo plotësisht funksional për akreditim dhe vlerësim të universiteteve, disa programe studimi dhe lëndësh nuk përputhen me nevojat e tregut të punës; ende shfaqen fenomene të tilla si plagjiaturë në veprat e shkruara të studentëve dhe mësuesve, sistemi për trajnimin praktik të studentëve është i papërshtatshëm (*Strategjia e arsimit për periudhën 2018–2025 faqe 49*)

Karakteristike për tre universitetet e tjera është keq menaxhimi, moszbatimi i ligjeve, sundim primitiv i strukturave menaxheriale mbi klasën akademike, etj. Pyetja që pason është se çfarë në atë ardhmen? Kur të rinjtë ikin jashtë, kur bie numri i lindjeve, a mund të kenë zhvillim të qëndrueshëm katër universitete shqiptare? Sigurisht se jo.

Përfundimet

1. Në të ardhmen ndryshimet në arsim do t'i prijnë idesë të progresit njerëzor, perspektivave qytetare. Ata do të hulumtojnë *marrëdhëniet shkak– pasojë* të dukurive të ndryshme në natyrë dhe shoqëri.
2. Arsimimi në të ardhmen do të jetë masiv dhe ajo që në vitin 2020 numri i njerëzve me arsim të lartë në vendet anëtare të Unionit Evropian është 48 për qind e popullsisë, sigurisht se në të ardhmen ajo përqindje do të rritet në vazhdimësi.
3. Hulumtimi shkencor dhe ngritja e vazhdueshme e kualitetit të punës në Universitete, rangimi ndërkombëtar i tyre do të jenë obligim i përhershëm i politikave arsimore dhe pjesëmarrësve në arsimin e lartë.
4. 5G dhe inteligjenca artificiale do të bëhen realitet.

LITERATURA:

Pajaziti, A., Jashari H.,– Higher education in the Republic of Macedonia: The challenges and the perspectives of the information society and the Bologna Process, Social studies / Studime sociale, Vol. 6, No. 1, 2012

Strategjia për arsim për vitin 2018–2025 dhe Plani i Veprimit, Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2018

Dennet, D. „Видови умови”, Магop, Скопје, 2006

Ballantine, Jane “Sociology of education”, Reutledge, Taylor&Francis Goupe, NY, London, 2017

Jashari H. 2005, Sociologjia e arsimit, Interlingua , Shkup, 2005

Burim elektronike:

https://enqa.eu/wp-content/uploads/2015/12/E-learning-in-the-European-Higher-Education-Area_Gaebel.pdf, 2015

<https://www.statista.com/statistics/944274/us-distance-learning-institutions-by-enrollment-students/> 2019

Camille G. Caldera dhe Sahar M. Mohammadzadeh, <https://www.thecrimson.com/a> Source: www.google.com, 2019

What is artificial intelligence?; <https://builtin.com/artificial-intelligence>

Artificial Intelligence. What it is and why it matters; https://www.sas.com/en_

European Union, Europe 2020: http://ec.europa.eu/europe2020/index_en.htm 3
Bologna Process, Ministerial Conferences (documen: <http://www.ehea.info/article/details.aspx?ArticleId=43> 4 UNESCO, Muscat Agreement: <http://unesdoc.unesco.org/images/0022/002281/228122e.pdf>, 2020

Макфакс, “Меѓународниот универзитет во Струга работи како пералница за дипломи, констатираат просветните инспектори” – Ризвановиќ Галена Николовска, 7 јуни 2018 (https://www.researchgate.net/figure/Participation-rates-in-Open-or-distance-learning-by-country-Percentage-of-adults_fig25_320756550, 2018)

LAURA PAPANIKU BEJTULLAU

ITSHKSH –Shkup

VIZIONI I ELITAVE PËR ARSIMIN DHE POZITA E MËSIMDHËNËSVE NË PERIUDHA TË NDRYSHME

Abstrakt

Nga pasja ose mungesa e vizioneve për arsimin është e përcaktuar e tashmja dhe e ardhmja e çdo shoqërie, ashtu sikundër vizionet nuk mund të lindin vetvetiu pa ekzistuar paraprakisht elitat e saj. Kjo marrëdhënie është e provuar edhe në historinë e zhvillimit të shkollave shqipe e, për rrjedhojë kemi ngritje dhe rënie të mëdha: nga universitete të para mesjetare të shekullit XIV (Universiteti i Durrësit) në errësirën e mesjetës; nga iluminizëm avangard të shekullit XVIII (Akademia e Voskopojës) në mungesë drastike të shkollimit elementar; nga platforma progresiste të shekullit XIX (“*Shqipëria çka qenë, çfarë është dhe çdo të bëhet*” e Sami Frashërit) në analfabetizëm të skajshëm; nga reforma revolucionare të shekullit XX deri në shkapërderdhje dhe rrënim të sistemit arsimor, aktualisht. Nisur nga kjo, është me mjaft interes të shqyrtohet raporti që kanë ndërtuar elitat viza-vijë nevojave dhe kërkesave arsimore të shoqërisë shqiptare, në periudha të ndryshme të historisë, me qëllim që të ndjekim përvojat pozitive si dhe të shmangim dështimet e së kaluarës.

Shqiptarët, që sot duken pa ndonjë vizion të qartë dhe për më tepër pa vizione origjinale të cilat do të buronin nga nevojat reale të shoqërisë, kanë se çfarë të mësojnë nga e kaluara e tyre. Sot janë padyshim ligjet, strategjitë, platformat, statutet dhe dokumente të ngjashme (të hartuara nga ana e ministrive të arsimit, universiteteve dhe akademive) pikënisja nga duhet lexuar shkalla e zhvillimit si dhe rrugët nga e kanë orientuar të ardhmen institucionet kompetente për krijimin e politikave arsimore. Tani e disa dekada rezultatet janë dëshpëruese, ndërsa në sfond nuk duket asnjë vizion premtues për ndryshimin e situatës.

Fjalët kyçe: Vizioni për arsimin, misioni i shkollave, elitat, universitete, politika arsimore, ligje, strategji, etj.

Hyrje

Në bazamentin e të gjitha lidhjeve mes nevojave dhe kërkesave që ka shoqëria për zhvillim dhe përparim – nga njëra anë dhe të krijimit të mundësve për realizimin e të njëjtave – nga ana tjetër, qëndrojnë elitat⁸⁸. Duke qenë promotorë të zhvillimit, respektivisht të nxitjes së ideve dhe modeleve përparimtare ato kanë një rol të pazëvendësueshëm në përcaktimin e *Vizionit* dhe *Misionit* që duhet të ketë një segment i caktuar i shoqërisë, në rastin konkret sfera e arsimit.

Se çfarë Vizioni dhe Misioni që i është caktuar sot arsimit në shoqërinë shqiptare, është çështje të cilën duhet kërkuar nëpër strategjitë, platformat, ligjet, statutet dhe dokumente të ngjashme të

⁸⁸ Elit/ë-a, d.m.th pjesa më e mirë e më e zgjedhur e një tërësie, Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1980, fq 425

universiteteve dhe ministrive të arsimit, meqë këta janë institucione të cilat krijojnë politika arsimore dhe, si të tilla kanë zëvendësuar plotësisht rolin e elitave edhe ashtu të munguara në mesin tonë.

E tashmja pa vizione origjinale në arsim

Të analizuar, nga prizma e vetë deklarimit, institucionet shqiptare qofshin ato në Shqipëri, Kosovë e Maqedoninë e Veriut kanë një shmangie të dukshme nga vija kombëtar e krijimit të politikave dhe një sforcim në orientimin drejt standardeve evropiane, gjë që flet për mungesën e vizionit origjinal të orientimeve arsimore si dhe për përfshirjen (thuajse çdo herë të vonuar) nëpër platformat ndërkombëtare, kryesisht evropiane pa i përshtatur ato me kushtet dhe rrethanat tona. Pjesa dërmuese e këtyre institucione jo vetëm që nuk kanë vizionet dhe misionet e veta origjinale, por ndodh të jenë edhe fare pa to.



Nga tri uebfaqet e marra në shqyrtim të ministrive të arsimit në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut⁸⁹, vetëm kjo e fundit ka të deklaruar Vizionin dhe Misionin e saj edhe atë përmes përmbajtjeve klishe të publikuara 6 vite më parë⁹⁰. Në ndërkohë, janë ndërruar pesë ministra dhe tre qeveri, ndërsa tekstet e Vizionit dhe Misionit kanë mbetur të njëjta. Por, pavarësisht kësaj, çështja që na intereson është mungesa e vizionit të qartë edhe në ato që shkruhen në uebfaqet e ministrive. Për vizionin është shkruar (citat: *t'i promovojë vlerat dhe bazat kualitative të arsimit dhe shkencës si çelës për përmirësimin e kualitetit të jetës në mbarë shoqërinë*), kurse për Misionin (citat: *ta zhvillojë arsimin... arrijtjet shkencore dhe risitë përmes aplikimit të parimeve të kualitetit, ekonomizimit, përgjegjësisë qytetare dhe lidhshmërisë me tregun e punës. Me aplikimin e këtyre parimeve do të mundësohet edhe pjesëmarrje e barabartë e Republikës së Maqedonisë në proceset integruese Evropiane arsimore, ekonomike dhe politike*). Pra, sikurse mund të vërehet pjesë e misionit është bërë ajo që realisht duhet të jetë objektiv, sikurse është rasti me fjalinë e fundit të lartë cituar “Me aplikimin e këtyre parimeve do të mundësohet edhe pjesëmarrje e barabartë.....”

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës (MASHTI) njëjtë sikurse Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë (MASR) nuk e kanë të shënuar as formalisht në uebfaqet e tyre Vizionin dhe Misionin që kanë. Te MASHTI⁹¹, të njëjtat mezi gjenden të nënvizuara brenda ndonjë dokumenti, sikurse është “Plani strategjik

⁸⁹ <https://mon.gov.mk>

⁹⁰ Misioni dhe Vizioni i MASH të RMV është publikuar në datën 24 korrik 2014 (I akcepueshëm në vebin e MASH-it në dt.20.01 2020)

⁹¹ <https://masht.rks-gov.net/detyrat-dhe-personeli-i-divizionit>

i arsimit në Kosovë 2017–2021”, i publikuar në korrik të 2016–ës. Vizioni i këtij plani është: *Kosova, shoqëri konkurrenente e dijes, e bazuar në vlerat evropiane, me mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët për t’i kontribuar zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror*, kurse Misioni është: *Zhvillimi i sistemit arsimor të bazuar në cilësi, në qasje gjithëpërfshirëse dhe në llogaridhënie, që mundëson formimin e individëve në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare*⁹². Institucionin numër një të arsimit në Shqipëri, Ministrisë të Arsimit Sportit dhe Rinisë⁹³ i mungon deklarimi i Vizioni dhe Misionit. Aty – këtu gjen ndonjë definicion, si për shembull te “Dokumenti i Strategjisë së Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014 – 2020”, ku thuhet se Vizioni i kësaj Strategjie i “*frymëzuar nga objektivi i përgjithshëm i “Europa 2020” për realizimin e një rritjeje kombëtare të shpejtë dhe të qëndrueshme*”, është “*Sistem arsimor që ka në qendër nxënësin, mbështet zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe i shërben konsolidimit të shoqërisë demokratike*”⁹⁴.

Jo vetëm në faqet zyrtare të internetit por edhe në Ligjet e hartuara nga të tre ministrinë, ka paqartësi sa i takon përcaktimit sidomos të vizioneve. Në RMV me asnjërin Ligji nuk përcaktohet se cili është Vizioni i tyre. Ligji i ri i arsimit fillor⁹⁵ ashtu sikurse edhe Ligji i përparshëm i arsimit fillor⁹⁶, përcaktojnë vetëm rolin dhe detyrat,

⁹² PLANI STRATEGJIK I ARSIMIT NË KOSOVË 2017-2021, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Prishtinë, korrik 2016

⁹³ <https://mars.gov.al>

⁹⁴ Dokumenti i Strategjisë së Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020, Tiranë, 2014

⁹⁵ Закон за основното образование, Службен весник на РСМ, бр. 161 од 5.8.2019 година

⁹⁶ Ligj për arsimin fillor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 103/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014 dhe 135/2014

pra ato që mund të llogariten si mision dhe objektiva. Ligji për arsim të mesëm⁹⁷ është ende më i pa definuar në këtë aspekt, kurse nuk bëjnë diferencën e konsiderueshme as Ligji për arsim të lartë. Në maj të vitit 2018 në RMV u soll Ligji i ri për arsim të lartë, por që njëlloj si Ligji paraprak (i cili në periudhën e viteve 2008 – 2018 ishte ndryshuar dhe plotësuar 14 herë⁹⁸), nuk e përcaktoi as vizionin dhe as misionin e lëndës që synojnë të rregullojnë. Te Ligji i ri, te pjesa *parimet themelore* me nenet numër 3 caktohen *Veprintaria e arsimit të lartë* (në 10 pika) ndërsa në nenin numër 4 *Karakterii i veprintarisë*. Me Ligjin e vjetër te pjesa *Dispozitat kryesore* neni 3 përcakton *Rolin dhe detyrat e institucioneve të arsimit të lartë*, kurse neni 4 *Qëllimet*.

Të integruar ndërkombëtarisht e të dezintegruar kombëtarisht

Fatkeqësisht, nuk janë më të kthjellëta në këtë drejtim as universitetet e të tria shteteve, ku shpesh herë ngatërrojnë vizioni me misionin apo misionin me objektivat. Në webfaqen e Universitetit të Tetovës, Vizioni dhe Misioni nuk gjenden si rubrika të posaçme, por si pjesë e dokumenteve të vlerësimit⁹⁹, ku thuhet se *Vizioni i Universitetit të Tetovës është që të jetësojë idealet kombëtare dhe vlerat bashkëkohore në arsim, shkencë dhe kulturë me qëllim*

⁹⁷ Закон за средното образование КОНСОЛИДИРАН ТЕКСТ („Службен весник на Република Македонија“ бр. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/2017 и 64/108

⁹⁸ Ligj për arsim të lartë Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 35/2008; 103/2008; 26/2009; 83/2009; 99/2009; 115/2010; 17/2011; 51/2011; 123/2012; 15/2013; 24/2013; 41/2014; 116/2014 dhe 130/2014

⁹⁹ Raport i vitit 2017 për Vetevaluimin e Universitetit të Tetovës gjatë viteve akademike 2013/14, 2014/15, 2015/16

*zhvillimin dhe përparimin e gjeneratave të ardhshme, ndërsa Misioni i Universitetit është të krijojë dhe të avancojë të mësuarit, shkathhtësitë, njohuritë, kompetencat akademike dhe profesionale, që do të jenë avancuese të ndryshimeve në shoqëri, në rrafshin kombëtar dhe ndërkombëtar. Këtu janë nënvizuar edhe 7 Qëllimet e UT-ës, mesin e të cilave edhe “Kultivimi i vlerave etike, barazisë, integritetit, tolerancës dhe përgjegjësisë sociale, me qëllim të formimit të studentëve si qytetarë, pjesëmarrës aktivë në shoqëri multikulturore”¹⁰⁰. Universiteti i Evropës Juglindore ka përcaktuar vetëm Misionin në 10 pika, në Statutin në fuqi¹⁰¹. “*Të kontribuojë për arsimin e lartë në gjuhën shqipe*, thuhet në pikën 6, neni 5 i Statutit, ndërsa pikat tjera kanë të bëjnë me objektiva si: *studime me perspektivë ndërkombëtare, veprimtari mësimore hulumtuese, mbrojtje të autonomisë universitare dhe lirive akademike, bashkëpunim, mirëkuptim ndëretnik, qytetarë të përgjegjshëm*. Këto objektiva të përgjithshme i gjen edhe te UT-ja si dhe te Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup, që është universiteti më ri në gjuhën shqipe në RMV. Me nenet 1, 2 dhe 3 të Statutit të UNT-së, i miratuar më 27 mars 2019¹⁰² tregohet *Pozita, Titulli dhe Lënda* kurse neni 22 përcakton *Veprimtarinë*, pa as asgjë të veçantë (originale) por me fjali të përgjithshme që burojnë nga Ligji për arsim të lartë, që gjithashtu është pa Vizion dhe Mision të qartë.*

¹⁰⁰ Po aty, fq. 4

¹⁰¹ Statuti I UEJL, 15 mars 2019 (I akceptueshem në uebfaqen e Universitetit më 8 shkurt 2020)

¹⁰² Gazeta Zyrtare e RMV-së, numër 64, data: 28.03. 2019

Mësimdhënësit e pa vlerësuar as formalisht

Cilësia është kryefjala e të gjitha strategjive, platformave, ligjeve dhe dokumentet tjera që hartojnë ministritë e arsimit, por rezultatet flasin për të kundërtën. Dijet e nxënësve tanë dëshpëruese. Testimet PISA tregojnë për nivele të larta të analfabetëve funksional¹⁰³. Niveli i universiteteve tona është gjithashtu për keqardhje, në ranglistat botërore dhe evropiane. Kjo sigurisht është një çështje që kërkon trajtim më të gjerë studimi, por edhe tregues i drejtpërdrejtë i pasojave që ka sjellë mungesa e gjatë e *vizioneve arsimore* si dhe mos përcaktimi i *misioneve*, prej të cilave varet karakteri që do të kenë institucionet arsimore.

Në mungesë të përcaktimeve të qarta të *Vizionit & Misionit* (që dëshirojmë ti japim arsimit) nuk do të bëjmë tjetër përveçse të endemi në atë që quhet *hapësira evropiane e arsimit* pa pasur koordinatat gjegjëse të nevojave dhe kërkesave tona, ose do të vazhdojmë të lëvizim nëpër korridore të gabuara dhe që nuk janë të aspak të përshtatshme për neve, sikurse është rasti me programet dhe librat e Kembrixhit të cilat nuk përkrijnë me kushtet e shkollave tona.

¹⁰³ “Shqetësim i posaçëm në Maqedoninë në Veriut është përmasa e madhe dhe në rritje e sipër e nxënësve, të cilët nuk përvetësojnë shkathtësi themelore për matematikë dhe lexim. Maqedonia e Veriut ka një pjesë të madhe të nxënësve (52.2%), të cilët kanë dështuar në demonstrimin e aftësisë themelore (niveli 2) të të tre fushave: shkencë, matematikë dhe lexim. Sidomos në rastin e leximit, më shumë se tre nga pesë persona të moshës 15 vjeçare nuk kanë aftësi themelore për lexim (70.7%) siç vërteton matja e PISA-s. Në shtetet e OECD-së kjo mesatare është 20%, 50% në Shqipëri dhe 42% në Mal të Zi”, Rishikimi i OECD-së mbi evaluimin dhe notimin në Republikën e Maqedonisë së Veriut : vlerësimi dhe rekomandimi. – Shkup, UNICEF, 2019

Nga aspekti struktural, e përbashkëta e sistemeve tona shkollore është renditja e tipareve: edukim, arsimi dhe aftësimi¹⁰⁴. Mes shumë pikave tjera të përbashkëta, Maqedonia e Veriut, Shqipëria dhe Kosova kanë edhe përcaktimin se *sistemi arsimor para universitar ka në qendër nxënësin*¹⁰⁵, *kurse sistemi i arsimit të lartë ka në qendër studentin*. Bie në sy mungesa e trajtimit me respekt të mësimdhënësve. Është e pamundur të gjenden formulime që të lavdërojnë apo që flasin me pietet për punën e mësuesit, profesorit, pedagogut universitar... Më tepër se sa e rastësishme, kjo duhet të jetë refleksion i koshiencave dhe subkoshiencave kolektive për humbjen e respektit dhe vlerës që kishte dikur profesioni i mësuesisë.

Në vitin 1830 presidenti i 16-të i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Abraham Lincoln, do ti shkruan mësuesit të të birit një letër mjaft domethënëse. Duke njohur vlerën e nxënies së dijeve dhe rolin e pa zëvendësueshëm të mësuesit në këtë proces, me shumë mirësjellje ai i kërkon mësuesit të jetë jo vetëm human (citat: *do të doja ta trajtonit butësisht*) jo vetëm edukator (citat: *ta merrnit përdore e t'i mësoni gjëra që do t'i duhen t'i dijë*) jo vetëm arsimtar (citat: *mësojeni nëse mundeni të zbulojë nurekullinë e leximit të librave*) jo vetëm mentor (citat: *sesi të shesë talentin dhe zgjuarsinë e tij tek ofertuesi më i lartë*), jo vetëm psikolog (citat: *mësojeni se të derdhësh lot nuk është aspak turp*), por edhe filozof e udhëheqës shpirtëror (citat: *Mësojeni atë të ketë besim sublim te vetvetja, sepse atëherë ai do të ketë gjithmonë besim sublim në njerëzimin dhe në Zotin*)¹⁰⁶.

¹⁰⁴ Ligj për arsim fillor në Republikë ne Maqedonisë së Veriut, 2019

¹⁰⁵ Dokumenti i Strategjisë së Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020, Tiranë, 2014

¹⁰⁶ Revista “Mësuesi”, nr.7, 2015, fq 18

Jo më pak i rëndësishëm ishte profesioni i mësuesve edhe për elitat shqiptare. “Pritmi i Shqipërisë varet nga puna e mësuesve” thoshte në vitin 1922 Mit’hat Frashëri¹⁰⁷ duke u kërkuar atyre *të nxisin dhe përhapin ndjenjën e përgjegjësisë kombëtare*, ndërsa ideologu tjetër i “Neo shqiptarizms”, Branko Merxhani kur flet për personalitetin e mësuesit, në vitin 1929 kërkonte që ai të jetë *në radhë të parë njeri i mirë e punëtor, brenda së cilit zien tronditja e mendimit, shqetësimi i provës, vullneti i mirë, dashuria dhe shpresa*¹⁰⁸ (pra të jetë i kompletuar në aspektin human e intelektual duke qenë në krye të detyrës, kërkuës dhe sfidues) Si letra e A. Lincolnit, ashtu edhe fjalimi i M. Frashërit e mendimet e B. Merxhanit, në mënyrë shumë të qartë japin mesazhin se: fati dhe personaliteti i fëmijëve (me këtë edhe i njerëzimit) është në dorën e mësuesit.



¹⁰⁷ Fjala e M. Frashërit në tubimin për krijimin e Lidhjes së Mësuesve të Prefekturës së Durrësit, botuar në revistën “Arsimtari” të vitit 1922

¹⁰⁸ Revista Demokratia, 7 shtator, 1929


Degradimi moral i profesionit të mësimdhënësit në Maqedoninë e Veriut kulmoi në vitin shkollor 2012/2013 kur Ministria e Arsimit dhe Shkencës sajoi të ashtuquajturin *vlerësim ekstern i nxënësve*. Sipas atij vlerësimi (pa asnjë standard dhe kriter shkencor), nënçmimi shkoi deri aty sa pasi publikoheshin rezultate e testimit të nxënësve dhe krahasoheshin me notat që u ishin shënuar nga mësimdhënësit, emrat e këtyre të fundit filluan të afishohen nëpër muret e shkollave si mësues të pa aftë!!! (Rëndomë ishin emra e atyre që ose kishin orientime të kundërta politike me partitë në pushtet ose ishin të pa mbrojtur politikisht. Listat përpiloheshin nga drejtorët, të cilët emërohen në këto poste nga politika).

Shembulli i vizionarëve nga Mesjeta deri te Rilindja Kombëtare

Shqiptarët që sot duken pa asnjë Vizion të qartë sa i takon çështjes së arsimit, kanë se çfarë të mësojnë nga e kaluara e tyre. Që në mesjetë shkollimi e kishte *një mision të caktuar* dhe kjo lidhej kryesisht me humanizmin, pra angazhimin e njerëzve të shkolluar të asaj kohe për ti përhapur dijet dhe për ti vënë ato në shërbim të ngritjes shpirtërore e kulturore të njerëzve. Në preokupimin e personaliteteve të shquar të shekullit XVII (Pjetër Bogdani, Gjon Nikollë Kazazit, Pjetër Mazrekut e para tyre edhe xhaxhai i P.B, Andrea Bogdani) mbështetej vizioni se vetëm me arsim populli mund të dilte nga errësira si dhe të krijoheshin kushte për zbutjen e mjerimit dhe varfërisë së skajshme ku i kishte degdisur Perandoria e Bizantit.

Akademia e Re e Voskopojës (shekulli XVIII) u bë e famshme për shkak të mësuesve të saj vizionar (Theodor Kavalioti, Dhanil Voskopopjari, Dhaskal Todhërin, Eugen Vullagarisi) të cilët

Vizionit për arsimin i kishin shtuar tanimë një tipar të ri: atë të shkencës krahas tiparit të shkollimit si mjet për përhapjen e dijeve – i cili kishte dominuar vizionet e elitave paraprake. Këtu studioheshin dhe përhapeshin idetë pedagogjike dhe filozofike të Xhon Lokut, përpiloheshin fjalorë, tekste shkollore si: Llogjika, Metafizika, Fizika, Gramatika, e të ngjashme edhe atë jo vetëm në gjuhën greke por edhe për nxënësit shqiptar, vllëh e bullgarë.



Edhe pse shkollat që vijuan të hapen në periudhën e shekujve XVIII dhe XIX ishin kryesisht në gjuhën turke, greke dhe sllave dhe në shumicën e tyre dominonte fryma e mësimin fetar, përsëri është e pavend të thuhet se nuk janë të rëndësishme për historinë e arsimit shqip. E para: aty jepnin mësim shumë shqiptarë dhe është e logjikshme që me nxënësit shqiptarë do të komunikonin në gjuhën amtare; e dyta: duke mësuar për lavdinë dhe përparimin e popujve tjerë forcuan ndjenjat e atdhedashurisë dhe e treta: duke qenë vetë të arsimuar dhe duke njohur peshën e shkollimit u angazhuan dhe

punuan për hapjen e shkollave shqipe pasi në *Vizionin e iluministëve* (pra kemi mbërritur në një stad tjetër të zhvillimit të mendimit mbi shkollën shqipe) dhe e forcuar ende më tepër në *Vizionin e rilindësve* tanë shkolla ishte mekanizmi përmes së cilit do të ndikohej në ngritjen e vetëdijes kombëtare, ruajtjes së kulturës dhe gjuhës shqipe.

Po të kemi parasysh veprën jetësore të Naum Veqilharxhit (Parathënien e Evëtarit (1844), Eniciklikën dërguar ortodoksëve shqiptar (1845) dhe letrën polemizuese me të nipin) apo edhe veprën jetësore të Hasan Tasinit (rektorit të parë të Universitetit të Stambollit) nuk është aspak e vështirë të konstatohet se sa rol dhe kontribut të madh kanë dhënë ata në përgatitjen e Rilindjes sonë kombëtare, përmes ndikimit të drejtpërdrejtë të tyre në krijimin e elitave të që do të pasojnë.... Në faqet e revistës “Mësuesi” të datës 7 gusht 1979 gjendet edhe ky shpjegim për Hoxhë Tahsinin “Në shtëpinë e tij, merrnin mësim të rregullta universitare, çdo pasdite....pothuaj të gjithë udhëheqësit e Rilindjes Kombëtare që banon në Stamboll, si: Sami Frashëri, Jani Vreto, Ismail Qemali, Pashko Vasa, e të tjerë“. Sipas nxënësit të tij, Sami Frashërit, Hoxhë Tahsini “*ishte një nga njerëzit më të mëdhenj, të cilët rrallë e me vështirësi i lindën shekujt*”.

Në angazhimin e vazhdueshëm të elitave për hapjen e shkollave shqipe, dominon ideja e ruajtjes së identitetit kombëtar mbi bazën e të cilës gjejmë njëri pas tjetrit *vizionet e hapjes së shkollave dhe arsimimit të popullatës si mjet për ruajtjen e gjuhës dhe kulturës*. Si në asnjë fazë tjetër të zhvillimit të historisë sonë, në periudhën nga ½ e dytë e shekulli XIX deri në ½ e parë të shekullit XX (përfaqësuar nga vëllezërit Frashëri e me pas Mid’hat e Mehdi Frashëri, Gjerasim, Sevasti e Parashqevi Qiriaz, Seid Najdeni, Josif Bageri,

Branko Merxhani, Aleksandër Xhuvani, Gjergj Fishtës, Shtjefën Gjeqovi, etj.) Vizioni i elitave për arsimin është i lidhur ngushtësisht me qenien kombëtare. Kjo shihet në të gjitha dokumentet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878 – 1881), në mënyrën e funksionimit të shkollave të para laike shqipe, në dokumentet dhe programet e Kongresit të Manastirit (1908), Kongresit të Elbasanit (1909), platformës arsimore të ministrit Ernes Koliqi, i cili në periudhën e viteve 1941–1943 dërgoi në Kosovë dhe Maqedoni rreth 250 mësues¹⁰⁹. Edhe pse ministër i një qeverie që ishte bërë palë me fashizmin, *Koliqi erdhi në këtë post si një intelektual i formuar në shkollat e perëndimit, për të sjellë në Shqipëri frymën e oksidentit modern dhe për të bashkuar kauzën e tij të shqiptarizmit me bashkëpunorë si Mit’had Frashërin, Anton Harapin, Nush Topallin, Gjergj Fishtën, Luigj e Karl Gurakuqin, Aleksandër Xhvanin, Lasgush Poradecin. Pa një elitë si kjo, nuk mund të kishim platforma kombëtare në arsim¹¹⁰, kulturë e letërsi.*

¹⁰⁹ Në Kosovë dhe në vise të tjera shqiptare në Maqedoni dhe Mal të Zi në vitin 1943 punonin 511 shkolla fillore shqipe me 19 121 nxënës, 487 mësues, prej tyre 78 mësuese.

¹¹⁰ “Rexhep Krasniqi shkruen kështu për këto zhvillime: “Kur u emnuesh Drejtues i Shkollës Shqipe në Prishtinë, Prof Koliqi (Ministër i Arsimit n’at kohë) ndër të tjera udhëzime, shquejti tri pika me randësi të posaçme: 1) Ministria e Arësimit ven bujarisht në dispozicion mjete financiare dhe material të ndryshëm për ekuipazhin e shkollës dhe të Internatit si dhe për ushqim e veshëmbathje të studentave bursistë; 2) Mësimi i gjuhës shqipe do të kishte prioritetin mbi të gjitha landët e tjera, mundësisht, me nga dy orë të përditshme për të gjitha klasat, dhe po për këtë qëllim ai porositi që 3) studentat e kësaj shkolle nuk do të kishin nevojë të marrin pjesë në organizimin e rinisë fashiste, siç ishte gjendja në Shqipin e vjetër”, Mbi qëndrimin atdhetar e Politik të Ernest Koliqit, prof.dr. Romeo Gurakuqi

Masiviteti dhe shkatërrimi

Pas Luftës së Dytë Botërore, në hapësirat tona nisi edukimi i masave sipas *parimeve revolucionare marksiste*. Bie në sy angazhimi i shteteve socialiste për: a) çrrënjosjen e analfabetizmit¹¹¹, b) arsimimin sa më të shpejtë të popullit përmes kurseve, hapjes së shkollave katërvjeçare, shtatëvjeçare dhe profesionale, c) shkollim pa pagesë dhe ç) shkollim në gjuhën amtare. Por shumë shpejt do të lindin problemet me shkollimin e pakicave, sikurse ishte në Maqedoni, ai i mungesës së kuadrit dhe hapësirave për shkollat shtatëvjeçare me mësim në gjuhën shqipe. U shfaqën pabarazitë e para arsimore (mungesa e shkollave) për ti hapur rrugë shkollave të përziera dhe, pas vitit 1981 edhe formimit të paraleleve të përziera (ku mësimi zhvillohej në gjuhë maqedonase). Ajo që kërkohet të arrihej përmes shkollës ishte asimilimi dhe pengimi i zhvillimit kombëtar të shqiptarëve, që në këtë kohë ishte bërë mision i agjendave politike të ish-Jugosllavisë, respektivisht ish-RSM-së.

Politika e diskriminimit kulmoi me burgosjen, diferencimin dhe largimin nga puna dhe shteti të mësimdhënësve, mbylljen e shkollave të mesme, moslejimin e universiteteve në gjuhën shqipe, pastërmin e teksteve shkollore nga përmbajtje të cilat u kujtojnë shqiptarëve të kaluarën e lavdishme¹¹². Ende më e egër ishte fushata kundër arsimit shqip, në Kosovë ku pas *suprimit të statusit të*

¹¹¹ V.I.Leni duke i kushtuar rëndësi të madhe përhapjes së arsimimit në mesin e punëtorëve mes tjerash shkuan “Në vendin e analfabetëve është e pamundshme të ndërtohet shoqëria komuniste”, në veprën “Polnoe Sobr.Soc”v.41,fq.315, citat “Zhvillimi i shkollës fillore në RM 1945-1975”, Dr. Avzi Mustafa, Logos-A, 1998

¹¹² Problemet e teksteve shkollore, fatkeqësisht nuk kanë arritur të tejkalohen as sot e kësaj dite. Ende ka tekste shkollore nga lëndët e historisë, gjeografisë apo shoqërisë, ku jo vetëm se fyhen rëndë shqiptarët por plasohen edhe shumë të pavërteta dhe gafa shkencore

*autonomisë*¹¹³, amfiteatrot dhe laboratorët e universiteteve u zëvendësuan me dhomat e shtëpive private. Në rrethana të këtilla (më iniciativë të intelektualëve dhe politikanëve shqiptarëve dhe i pa pranuar nga shteti) u themelua edhe Universiteti i Tetovës (1994), ndërsa në Shqipëri kishte stagnuar përparimi në të gjitha aspektet.

Kështu, ndërrimi i sistemeve nga monizëm në pluralizëm i gjeti shqiptarët me sistem të rrënuar arsimit dhe të limituar sa i takon krijimit të kapaciteteve dhe kuadrove që do të bartnin kauzat për zhvillimin e mëtejshëm të kombit. Rrugët e zhvillimit (nga Rilindja kombëtare dhe lëvizjet tjera liberal – demokratike që pasuan me formimin e shtetit shqiptar dhe pas saj), ishin ndërprerë dhunshëm për gati se një gjysmë shekulli. Tani ishte shumë e vështirë të gjendet rruga e duhur, aq më tepër kur në periudhën prej më tepër se tre dekadave, vendi i mësimdhënësve në shoqëri do të jetë në pozita jashtëzakonisht të palakmueshme si në aspektin e vlerës morale ashtu edhe të pozitës materiale¹¹⁴.

Përfundimet

1. Misioni i shkollave ndryshon varësisht konteksteve kohore dhe rrethanave politike
2. Vetëm elitat kulturore dhe politike të një populli (shoqërie) mund të ndërtojnë programe dhe platforma vizionare arsimore

¹¹³ 28 mars 1989

¹¹⁴ Ndarja duhet bërë në vitin shkollor 2018/2019 për dy arsye: e para, sepse po në vitin 2018 nisi rritja e rrogave për të punësuarit në arsim – që aktualisht janë për rreth 21 për qind më të larta sesa rrogat e para dy vite dhe e dyta, sepse në vitin 2019 u nxor Ligji për mësimdhënës dhe bashkëpunëtor profesional në shkolla fillore dhe të mesme (i cili është shumë më i avancuar se ligjet paraprake sa i takon caktimit të formave për karrierë profesionale. Në vitin 2018 u hoq gjithashtu Vlerësimi eksetrn, që ishte një goditje shumë e rëndë për mësimdhënësit

3. Nuk mund të bëhet ndarje ”e prerë” e *Misionit* të shkollës si vend për edukimin?; për arsimimin?; për emancipimin?; apo për aftësimin e masave? Por, nuk është krejt e pamundur të konstatohet se *Vizionin* për arsimin e kanë dominuar herë disa komponentë e herë komponentë të tjerë.

4. Nga sa konstatohet më lartë, arsimi për shqiptarët është herë *më shumë*:

a). misionare kishtarë (shekulli XIV kur në Durrës vepronte Universiteti i parë mesjetar i Ballkanit¹¹⁵)

b). aftësuese – profesionale (XV – XVI) mbështetur në iniciativa private për tregtarë dhe zejtarë¹¹⁶;

c). morale – fetare dhe sociale (XVII – XVIII) por edhe filozofike¹¹⁷;

¹¹⁵ Në atë kohë Durrësi ishte qendër arkipeshkopale shumë e rëndësishme dhe drejtohej nga Karl Topia. Universiteti mesjetar i Durrësit ishte universitet teologjik (Studium Generale). E themeluan dhe e drejtuan autoritetet e urdhrat dominikan të qytetit për çka flet edhe e dhëna se “ligjëratat janë mbajtur në Pallatin e Kuvendit dominikan të Durrësit”. Njëri ndër personalitetet më të njohura i cili doli nga dyert e këtij universiteti ka qenë Gjon Durrsaku (John of Dyrrachium) i cili më 14 qershor të vitit 1396 caktohet rektor i Universitetit të Zarës (Universitas Jadertina, citat nga Hajrullah Koliqi: Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar, Universiteti i Prishtinës & Libri shkollor, Prishtinë, 2002, fq. 53, https://sq.wikipedia.org/wiki/Universiteti_Mesjetar_i_Durr%C3%ABsit

¹¹⁶ Në kohën e zhvillimit të qyteteve të mëdha tregtare ku jetonin shqiptarë, Tivari, Ulqini, Kotori, Dubrovniku, jo vetëm që janë të mirënjohura aktivitete e priftërinjve françeskan që merreshin me shkollimin e shqiptarëve, por sikurse do të vëreje me shumë të drejtë edhe akademik Idriz Ajeti, në mesjetë ka pasur mësuës privatë, më së shumti në qyteza dhe tregje. Mësimi që zhvillonin ata kishte më tepër karakter laik, profanë dhe përdorej për qëllime praktike . Në këto qytete djemtë e qytetarëve mësonin aritmetikë, shkrim, mbajtjen e librave të llogarisë në italishtet, hartim obligacionesh në italishtet në të cilën shquhej sidomos shkolla gramatikore-retorike e Dubrovnikut në shekullin XIV. Pos kësaj në shembullin e atyre italiane ka punuar shkolla gramatikore në Kotor, cituar J.Rexhepagiq, “Zhvillimi.....”, Prishtinë. 1968

ç). kombëtare dhe unifikuese (XIX – ½ e parë e shekullit XX) e hapur drejt perëndimit dhe shkollës amerikane;

d). revolucionare e marksiste – leniniste (½ e dytë të shekullit XX) e orientuar drejt lindjes dhe shumë larg nevojave reale të shqiptarëve dhe

dh). integruese (prej viteve '90-ta të shekullit XX) dhe në kërkim të hapësirave evropiane duke u ballafaquar me proceset e globalizimit

LITERATURA:

Frashëri Mid'hat, “Elita Shqiptare”, përgatitur nga Uran Butka, Plejad 2008

Kulla Ndrizim, “Antologji e mendimit shqiptar 1870–1945”, Plejad, Tiranë, 2003

Lita Qerim, “Tokat e liruar 1941–1944”, përmbledhje dokumentesh, vëllimi IV, Logos–A, 2016

Mustafa Avzi, “Zhvillimi i shkollës fillore në RM 1945–1975”, Logos–A, 1998

Rexhepagiq Jashar, “Zhvillimi i arsimit dhe i sistemit shkollor të kombësisë shqiptare në territorin e Jugosllavisë së sotme deri në vitin 1918”, Enti i teksteve dhe mjeteve shkollore të KAK, Prishtinë, 1968

Закон за основното образование, Службен весник на РСМ, бр. 161 од 5.8.2019 година

Ligj për arsimin fillor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 103/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014 dhe 135/2014

Закон за средното образование, консолидиран текст („Службен весник на Република Македонија“ бр. 44/1995, 24/1996, 67/2017 и 64/108

Ligj për arsim të lartë Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 35/2008; 116/2014 dhe 130/2014

¹¹⁷ Akademia e Re e Voskopojës

Raport i vitit 2017 për Vetevaluimin e Universitetit të Tetovës gjatë viteve akademike 2013/14, 2014/15, 2015/16

Dokumenti i Strategjisë së Zhvillimit të Arsimit Para universitar 2014–2020, Tiranë, 2014

Plani strategjik i arsimit në Kosovë 2017–2021, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Prishtinë, korrik 2016

Dokumenti i Strategjisë së Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014–2020, Tiranë, 2014

Revistat “Mësuesi”, nr.7, 2015, fq 18, Revista “Arsimtari” të vitit 1922, Revista Demokratia, 7 shtator, 1929

<https://www.shqiperia.com/Mbi-qendrimin-atdhetar-e-politik-te-Ernest-Koliqit.2720/>

https://sq.wikipedia.org/wiki/Universiteti_Mesjetar_i_Durr%C3%ABsit

TRIBUNA SHKENCORE PËRMES
FOTOGRAFIVE



Hapja e Tribunës shkencore



Momente nga pjesa solemne e Tribunës



Momente nga pjesa solemne e Tribunës



Momente nga pjesa solemne e Tribunës



Momente nga pjesa solemne e Tribunës



Momente gjatë kafë – pauzës



*Panelistët e pjesës së parë – nga e majta në të djathtë: prof.dr. Avzi Mustafa,
prof. dr. Xheladin Murati dhe doc.dr. Demsuh Bajrami*



*Panelistët e pjesës së dytë – nga e majta në të djathtë: prof.dr Abdurauf Pruthi,
prof.dr. Hasan Jashari dhe prof.dr. Ajten Hajdari – Qamili*



Momente nga pjesa e debatit rreth kumtesave të Tribunës – drejtori i ITSHKSH-së, dr. Skender Asani



Nga pjesa e debatit rreth kumtesave të Tribunës shkencore –profesori i gjinnazit “Zef Lush Marku”, Naser Mifari



Nga pjesa e debatit rreth kumtesave të tribunës shkencore – prof.dr. Naim Halimi



Nga pjesa e debatit të Tribunës shkencore



Fotografi e përbashkët me pjesëmarrësit e Tribunës shkencore “Gjendja e arsimit në vend, sfidat dhe perspektivat” (nga e majta në të djathtë – reshti lart: prof.dr. Lulzim Mehmedi, prof.dr.Xheladin Murati, doc.dr. Minir Ademi, prof.dr.Tahir Zajazi, doc.dr.Avni Avdiu, mr.Laura Papraniku Bejtullau, prof.dr.Abdurauf Pruthi, prof.dr.Ajten Hajdari – Qanili, prof.dr.Avzi Musta; nga e majta në të djathtë – reshti poshtë: prof.dr.Hasan Jashari, kryetari i LASH-it Nuhi Dardhishta, drejtori i TSHKSH-së dr.Skender Hasani, doc.dr. Demush Bajrami, mr. Isamet Bakiu dhe profesori i Gjinnazit “Zef Lush Marku” në Shkup, Naser Miftari)

BOTUES:
INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

SCUPI, vëllimi 30 – 2020

Kryeredaktor: Mr. Laura Papraniku Bejtullau

Përgjegjës i botimit: Dr. Sevdail Demiri

Redaktor teknik: Naser Fera

Shtypi: Focus Print – Shkup

Rr. Pellagonia 3 – Shkup

Tirazhi: 500 copë

*Ky edicion i SCUPI-t botohet me vendimin e Këshillit të
ITSHKSH-Shkup, nr. 0201-95/4, të datës 19.02.2020, si pjesë e
programit të punës së Institutit për vitin 2020.*

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

37(497.7)(062)

GJENDJA e arsimit në vend - sfidat dhe perspektivat : (tribunë
shkencore - 07.03.2020, Shkup) / [kryeredaktor Laura Papraniku Bejtullau].

- Shkup : Instituti i trashëgimisë shpirtërore e kulturore të
shqiptarëve, 2020. - 216 стр. : илустр. ; 21 см.
- (Biblioteka Scupi ; v 30)

Фусноти кон текстот. - Библиографија кон трудовите

ISBN 978-608-4897-15-6

а) Образование -- Македонија -- Собири

COBISS.MK-ID 5187814